



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.200 Akti

Nr.284 Vendimi
Tiranë, më 3.8.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, z. Elka Ermenkova, në datën 29.7.2020, ora 13:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Hysen Saliko**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b të Kushtetutës dhe nenet A, D, DH, Ç, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Hysen Saliko, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Saliko, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 17.9.2018, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Z. Hysen Saliko, bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit duke u shortuar në datën 17.9.2018, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Genta Tafa (Bungo), Etleda Çiftja dhe Suela Zhegu.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39, të ligjit nr. 84/2016 dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si KLGJ), sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016
4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 1, datë 19.9.2018, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues, komisioneren Genta Tafa (Bungo). Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, në datën 18.6.2020, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Hysen Saliko, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52, të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.
6. Në datën 23.06.2020, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 7.7.2020; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

¹ E-mail, datë 23.6.2020, ora 16:21, “Komisioni – Rezultatet paraprake të hetimit administrativ”.

7. Në vendimin nr. 3, datë 21.7.2020, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Hysen Saliko, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u njoftua përmes postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 29.7.2020, ora 13:30, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, Tiranë.

8. Në vendimin nr. 4, datë 21.7.2020, trupi gjykues vendosi: (1) të pranojë kërkesën e subjektit për marrjen/administrimin e provave të depozituara me prapësimet e rezultateve të hetimit sipas pikave 4, 10, 11, 12, 13, 15, 16 dhe 17; (2) të refuzojë kërkesat e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e ekspertimit grafik dhe ekspertimit agro-financiar, pasi mjeti provues është tërësisht i papërshtatshëm, sipas parashikimeve të germës “c”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016; (3) të refuzojë marrjen e provave, për këqyrjen në vend të parkut të bletëve dhe të apartamentit në Tiranë, pasi mjeti provues është tërësisht i papërshtatshëm, sipas parashikimeve të germës “c”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016; (4) të refuzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për thirrjen e dëshmitarëve, pasi mjeti provues është tërësisht i papërshtatshëm, sipas parashikimeve të germës “c”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

9. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Hysen Saliko, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 21.7.2020. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 29.7.2020, ora 13:30, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.

11. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove, apo për shpjegime.

12. Z. Hysen Saliko shprehu qëndrimin e tij pasi dëgjoi relacionin, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht dhe me përfaqësues ligjor, si dhe shprehu opinionin e tij pozitiv në lidhje me procedurën e hetimit të kryer nga Komisioni në procesin e rivlerësimit.

14. Në seancën dëgjimore të datës 29.7.2020, subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Saliko, kërkoi konfirmimin në detyrë.

15. Në përfundim të seancës së datës 29.7.2020, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin Hysen Saliko dhe shpalli vendimin për procesin e rivlerësimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Saliko, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, z.

Hysen Saliko, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

17. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e tij; (iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi përkatës i vlerësimit profesional, i cili përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pasi përfundon shqyrtimi i dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe përzgjedhja e pesë dokumenteve sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

18. Referuar vendimit nr. 2/2017², të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

V. RIVLERËSIMI I PASURISË

V/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-ja

19. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Hysen Saliko, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

² Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

20. Subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2003 – 2016 dhe referuar ligjit nr. 84/2016 ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor për të justifikuar pasuritë*
- *ka mosdeklarime në deklaratat e interesave private ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë.*

V/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (e) deklaratimet në seancë dëgjimore.

22. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar në pikën 5, të nenit 33, ligjit nr. 84/2016.

V/3. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Shtëpi banimi në fshatin Q, Njësia Administrative Mollas, Bashkia Kolonjë

1.1 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtëpi banimi³ në fshatin Q, Njësia Administrative Mollas, Bashkia Kolonjë. Shtëpi me dy kate e përbërë nga 4 dhoma, dy korridore e anekse, me sip. 100 m², në secilin kat, si dhe aneks ngjitur kësaj banese. Shtëpia ndodhet mbi një sipërfaqe trualli prej 350 m². Si burim krijimi subjekti ka deklaruar se kjo shtëpi është trashëguar nga babai. Vlera e pasurisë: e padeklaruar, pasi shtëpia rezulton e pavlerësuar. Pjesa takuese: 50 % në bashkëpronësi me nënën.

³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (Aneks nr. 4/1)

- kthim informacioni nga ZVRPP-ja Kolonjë, datë 18.10.2016, sipas te cilit sqarohet se z. k. ***, që ka fshatin Q në Kolonjë, nuk është futur në sistem (nuk është kryer regjistrimi fillestar) dhe, si e tillë nuk mund të japin informacion.

- katër foto të shtëpisë dhe pamjet e saj nga jashtë.

1.2 Në deklaratën e vitit 2003 në ILDKPKI, DPF, subjekti ka deklaruar pasurinë si shtëpi banimi, 2-katëshe, e përbërë nga 4 dhoma, 2 korridore dhe aneks dhe mënyra e fitimit e trashëguar nga babai.

1.3 Subjekti ka shpjeguar për këtë pasuri se është banesë e ndërtuar para viteve 1970, trashëguar nga babai dhe ende e paregjistruar në ZVRPP-në Kolonjë, pasi ndodhet në proces regjistrimi (zonë e pamanaxhuar). Është e pavlerësuar. Pjesa takuese së bashku me nënën, secili me 50 %.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

1.4 ZVRPP-ja Kolonjë⁴, informon se shtetasit Hysen.T.Saliko, M. H. S, L. Xh. S, etj., rezultojnë se janë nga fshati Q, fshat i cili nuk është hedhur ende në sistem dhe, për rrjedhojë, nuk ka informacion. Në sistemin hipotekor nuk kanë të regjistruar pasuri të paluajtshme.

1.5 OSHEE⁵-ja, informon se në emër të shtetasit Hysen Saliko, referuar sistemit të faturimit identifikohet një abonent me nr. kontrate KR*F****, në instancën e Korçës, me kabinë në adresën Q, Njësia Administrative Mollas, Bashkia Kolonjë.

1.6 Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është trashëguar nga babai. Subjekti⁶ ka shpjeguar se nga babai ka të trashëguar një shtëpi banimi dy-katëshe me mur guri, me katër dhoma, dy korridore dhe aneks ngjitur banesës. Kjo pasuri është deklaruar si e ndërtuar para viteve 1970. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratimet periodike vjetore rikonstruksione të kryera për këtë pasuri. Nga fotot e depozituara nga subjekti rezulton se në këtë objekt janë bërë rikonstruksione të pjesshme, si dhe referuar fotove rezulton dhe një objekt njëkatësh ngjitur me banesën dykatëshe.

1.7 Subjekti është pyetur në lidhje me punime konstruksioni në shtëpinë në fshatin Q, në pyetësin e datës 19.11.2019. Subjekti ka shpjeguar se: *“Në këtë banesë kemi kryer vetëm punime rikonstruksioni. Së pari rikonstruktimi më i madh është bërë gjatë riparimit të dëmtimeve të shkaktuara prej tërmetit të vitit 1987. Punimet janë kryer prej babait tim T. S dhe dy miqve të tij dhe si kosto punimesh ka qenë vetëm pagesa e llamarinës dhe e gozhdëve (nuk jam në gjendje të përcaktoj vlerën e saj). Këto janë përballuar me të ardhurat e familjes, pensionin e babait dhe të ardhurat që siguroheshin nga blegtoria, bletaria dhe bujqësia. Njëherazi dhe të ardhurat që përfutuam nga shpërbërja e ish kooperativës bujqësore (bashkëngjitur edhe të ardhurat e babait nga pensioni i pleqërisë). Po kështu, si burim të ardhurash ka shërbyer dhe dëmshpërblimi që ka marrë babai, si vëllai i të pushkatuarit pa gjyq (të ndjerit R. I. S). Në vitin 2008 është kryer rikonstruksioni i dyerve të jashtme të banesës dhe të dritareve të saj, si dhe rikonstruksion të korridorit dhe dhomës nga krahu i majtë, duke bërë dhe tualete brenda korridorit shumën totale prej 100.000 lekësh. Po kështu kemi kryer rikonstruksion të mureve rrethues dhe suvatim të tyre dhe të tre faqeve të aneksit në vitin 2017 në vlerën 30.000 lekë. Sqaroj se po në këtë vit kemi kryer dhe rikonstruksion të dritareve dhe derës së jashtme të aneksit, si dhe lysterje në shumën 25.000 lekë. Nënvizoj faktin se të gjitha punimet janë kryer nga kunetërit e mi pa shpërblim, duke i ndihmuar motra, djemtë dhe kushërinjtë e mi. Në vitin 2018 janë bërë meremetime të ndryshme si lysterje të faqes së jashtme të aneksit dhe të ballkonit të banesës, në vlerën 10.000 lekë. Ndryshuar dera dhe dritarja e këtij aneksi në vlerën 30.000 lekë. Ndërkohë që janë blerë dhe disa pajisje*

⁴ Me shkresën nr. **** prot., datë 11.3.2019.

⁵ Me shkresën nr. **** prot., datë 22.2.2019.

⁶ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 17.2.2020.

gjatë këtij viti. Gjithsesi, në këtë aneks ka kryer punime edhe motra ime, e cila e përdor gjatë muajve të verës për shkak se merret me punë bujqësie (përveç tokës së saj motra që nga viti 2008 e në vazhdim përdor të gjithë tokën e familjes pa shpërblim). Gjithashtu gjatë viteve 2010 – 2016 prej nënës janë kryer shërbime të domosdoshme që mund kapin vlerën 3.000 deri në 5.000 lekë në vit. Të gjitha këto punime janë kryer nga kursimet e nënës dhe nga shitja e produkteve të fshatit”.

1.8 Subjekti është pyetur dhe për shpenzimet e mobilimit të saj, i cili në përgjigjet e pyetësorit të datës 23.10.2018, ka shpjeguar: “Ndër vite është arreduar edhe banesa që kanë në fshatin Q Kolonjë, vlera e arredimit të së cilës nuk mund të përcaktohet, pasi 2 dhoma gjumi janë blerë para viteve 1990 dhe përdoren aktualisht. Ndërkohë që mobilitet e tjera janë shumica nga ato që kam ndërruar nga banesat që kam përdorur si më sipër”.

1.9 Subjekti ka saktësuar shpenzimet⁷ për rikonstruksion të shtëpisë dhe shpenzime mobilimi në shumën totale prej 358.000 lekësh për periudhën 2003 – 2016. Këto shuma janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

1.10 Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me mungesën e dokumentacionit ligjor justifikues për të vërtetuar pronësinë e kësaj shtëpie.

1.11 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: [...] Në lidhje me këtë pasuri prej Komisionit pas verifikimit të kryer, është konkluduar se: “Nga hetimi i kryer, vërehet se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë shtëpi e trashëguar nga babai, ndodhur në Q të Kolonjës dhe ka mungesë dokumentacioni ligjor për të vërtetuar pronësinë e kësaj banese”.

1.12 Ky konstatim është i saktë për sa i përket pjesës së parë. Ndërkohë që në lidhje me dokumentacionin ligjor subjekti sqaron se ashtu sikundër ka dhënë edhe shpjegimet në përgjigje të pyetësorit pronat e fshatit Q nuk janë regjistruar dhe për pasojë nuk mund të paraqesë asnjë dokument pronësie. Për këtë, subjekti ka depozituar në Komision edhe vërtetimin negativ nga ZVRPP-ja Kolonjë, ku konfirmohet fakti se z. k. ***, që ka fshatin Q në Kolonjë, nuk është futur në sistem (nuk është kryer regjistrimi fillestar). Po kështu, ka paraqitur edhe vërtetimin negativ nr. *** prot., datë 18.2.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Kolonjë, me anë të të cilit konfirmohet e njëjta gjë.

1.13 Subjekti ka nënvizuar faktin që mosregjistrimi i pronës nuk ka ardhur për fajin e familjes, njëherazi edhe të subjektit, por të shtetit. Gjithsesi, nuk është regjistrimi i pronës që të bën pronar, pasi pronësia është një gjendje fakti. Kjo banesë së bashku me anekset i përket familjes së tij (babit) për të cilën bashkëngjitur edhe dëshminë e trashëgimisë⁸ nr. *** rep., nr. **** kol., datë 25.6.2020, lëshuar nga Noterja F.L.

1.14 Sipas nenit 331 të Kodit Civil me çeljen e trashëgimisë, pra, me ndarjen nga jeta të babait të subjektit, trashëgimtarëve, u ka kaluar edhe posedimi mbi pasurinë trashëgimore, pa qenë nevoja të kishin në dorësinë e sendit. Subjektit, posedimi i sendit, i ka kaluar “*ipso jure*”, në gjendjen që

⁷ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 17.2.2020.

⁸Për më tepër shihni dëshminë e trashëgimisë nr. ****, datë 25.6.2020, të lëshuar nga Notere F. L, të cilën do ta gjeni bashkëngjitur këtij material.

ishite lënë nga trashëgimlënësi dhe për veprimet e kryera nga trashëgimlënësi, në lidhje me shpenzimet e kryera prej tij për rikonstrukcionin e banesës në vitin 1987, apo veprime të tjera të kryera deri në ndarjen e tij nga jeta, nuk ka qenë përgjegjësi e trashëgimtarit evidentimi dhe ruajtja e dokumentacionit përkatës. Trashëgimtari fiton pronësinë dhe posedimin e sendit me çeljen e trashëgimisë, bashkë me posedimin fiton me trashëgimi dhe detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë, detyrime që ekzistojnë në momentin e çeljes së trashëgimisë. Duke qenë se trashëgimia është veprim juridik i njëanshëm, i cili shërben si titull për fitimin e pronësisë, trashëgimtari është në mirëbesim në lidhje me gjendjen e sendit të fituar nëpërmjet trashëgimisë, pasi nuk ka shprehur vullnet në lidhje me këtë veprim juridik.

1.15 Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

1.16 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

1.17 Dëshmia e trashëgimisë e paraqitur nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, provon kush janë trashëgimtarët ligjorë të subjektit të rivlerësimit, por nuk vërteton faktin nëse i ndjeri, babai i subjektit, e ka pasur këtë shtëpi në pronësi apo jo.

1.18 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk vërtetoi se me një dokumentin zyrtar, të lëshuar nga organet e pushtetit vendor që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991, duke përcaktuar sipërfaqen e ndërtimit dhe të truallit funksional të kësaj ndërtese, dokument i cili mund të shërbente dhe për regjistrimin fillestar të pronës, i cili mund të ishte kërkuar nga subjekti i rivlerësimit që nga vitit 2012, kohë kur hyri në fuqi vendimi i këshillit të ministrave nr. 608, datë 5.9.2012, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”.

1.19 Si rrjedhojë e mungesës së këtij dokumentacioni, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion zyrtar provues, qoftë dhe nga institucione të tjera, që të provonte pronësinë mbi këtë shtëpi banimi.

1.20 Si konkluzion, në lidhje me këtë pasuri, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion që justifikon vërtetësinë e deklaratimeve të tij në lidhje me faktin se kjo shtëpi ka qenë në pronësi të babait të tij. Pronësia mbi këtë shtëpi ngelet vetëm në nivel deklarativ nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 33, pika 5, gërma “a” e ligjit nr. 84/2016.

2. Tokë bujqësore⁹ me sip. 34.150 m², ndodhur në fshatin Q, Kolonjë

⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (Aneks nr. 4/2)

- Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 13.4.1994, në emër të shtetasit T. S, i cili ka përfituar gjithsej 34.150 m², në fshatin Q, Kolonjë. ZQRPP, me shkresën nr. **** prot., datë 14.8.2017, bashkëngjiti përgjigjen e ZVRPP-së Kolonjë, e cila nuk konfirmon pasuri të regjistruara në emër të subjektit ose personave të lidhur. (Aneks nr. 27);

2.1 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se zotëron tokë bujqësore¹⁰ me sip. 34.150 m², përfituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, ku përcaktohet 350 m² truall + 31.000 m² toke “arë” dhe 2.800 m² “pemëtore”, e pasqyruar në AMTP-në nr. ***, datë 13.4.1994, në emër të babait të subjektit T. S (nga kjo sipërfaqe 2.150 m² i përket motrës së martuar të subjektit, znj. M.S (M). Pjesa takuese: 25 % në bashkëpronësi me familjen. Burimi i krijimit: përfitim nga ligji 7501, datë 19.7.1991, i ndryshuar (me AMTP-në nr. ***, datë 13.4.1994).

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

2.2 ZVRPP-ja Kolonjë¹¹, ka informuar se shtetasit Hysen T. Saliko, M. H. S, L.Xh. S, etj., rezultojnë se janë nga fshati Q, fshat i cili nuk është hedhur ende në sistem dhe për rrjedhojë nuk ka informacion. Në sistemin hipotekor nuk kanë të regjistruar pasuritë e paluajshme.

2.3 Komisioni i është drejtuar me shkresë ASHK-së, Zyrës Qendrore, duke i shpjeguar gjithë situatën e pronave të subjektit në fshatin Q, të Kolonjës, si dhe ka kërkuar informacion se përse kjo zonë është ende e paregjistruar.

2.4 ASHK-ja Kolonjë¹², informon se mbështetur në kërkesën e subjektit Hysen Saliko ka bërë kërkesë drejtuar Zyrës Vendore të ASHK-së Kolonjë, e cila ka lëshuar vërtetim nr. *** prot., datë 17.4. 2020, në të cilën vërtetohet se gjendet e depozituar pranë Zyrës Vendore ASHK Kolonjë AMTP-në nr. ****, datë 13.4.1994, në emër të T.I.S dhe se AMTP-të e fshatit Q nuk janë të shoqëruara nga formulari 6 (gjashtë) dhe nuk janë të regjistruara për arsye se nuk ka përfunduar azhurnimi dhe regjistrimi fillestar për z. k. ****, Q.

2.5 Në DPV-në e vitit 2003 (DPV e parë) subjekti ka deklaruar – tokë bujqësore 32 dynymë – sipas të cilës zotëron 25%, në fshatin Q – Kolonjë, fituar me ligjin 7501, datë 19.7.1991.

2.6 Subjekti, pasi është pyetur nga Komisioni, ka depozituar¹³ certifikatën familjare të muajit gusht 1991. Nga akti rezulton se z. T.S, ka qenë kryefamiljar i familjes përbërë nga 7 anëtarë, bashkëshortja e tij, 2 vajza, djali (subjektit), nusja e djalit dhe nipi.

2.7 Në lidhje me pasurinë përfituar me AMTP-në e sipërcituar, subjekti ka deklaruar se është përfitues në masën 25 %. Për këtë arsye subjektit iu kërkuar të japë shpjegime në lidhje me masën 25 % të tokës se përfituar me ligjin nr. 7501, kur familja bujqësore përbëhej nga 7 anëtarë.

2.8 Subjekti, gjatë hetimit administrativ, ka shpjeguar¹⁴ se: *“Në deklaratën *Vetting* shprehet se përfiton 25 %, i referohej përfitimit të të ardhurave nga toka bujqësore. Kjo për faktin se që nga viti 2003 kur kemi bërë deklarimin e parë dhe deri më tash, pas vdekjes së babait në familje kemi mbetur 4 persona që kemi përfituar tokë bujqësore, konkretisht M, H, L dhe I.S. Megjithatë*

• ZQRPP-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2017, bashkëngjiti përgjigjen e ZVRPP-së Kolonjë, e cila nuk konfirmon pasuri të regjistruara në emër të subjektit ose personave të lidhur (Aneks nr. 27).

¹⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën: (Aneks nr. 4/2)

• Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 13.4.1994, në emër të shtetasit T. S, i cili ka përfituar gjithsej 34.150 m², në fshatin Q, Kolonjë. ZQRPP-ja me shkresën nr. **** prot., datë 14.8.2017, bashkëngjiti përgjigjen e ZVRPP-së Kolonjë, e cila nuk konfirmon pasuri të regjistruara në emër të subjektit ose personave të lidhur (Aneks nr. 27);

• ZQRPP-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2017, bashkëngjiti përgjigjen e ZVRPP-së Kolonjë e cila nuk konfirmon pasuri të regjistruara në emër të subjektit ose personave të lidhur (Aneks nr. 27).

¹¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2019.

¹² Me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2020.

¹³ Me përgjigjet e pyetësorit të datës 4.2.2020.

¹⁴ Në përgjigjet e pyetësorit, datë 30.4.2020.

për këtë fakt në çdo deklarin që kam bërë kam përdorur shprehjen me “familjen”. Është e vërtetë se në datën 1.8.1991 në përbërje të familjes ne kemi qenë shtatë anëtarë, ku në përbërje përfshihen edhe 2 motrat S dhe M, por motra ime S është martuar faktikisht në 8.9.1991 dhe ligjërisht në datën 7.5.1992. Nisur nga mungesa e formularit nr. 6, nuk kam qenë në dijeni nëse kishte përfitur apo jo tokë bujqësore. Megjithatë ajo që në momentin e martesës de-fakto ka hequr dorë nga pasuria, dhe për këtë fakt ajo për asnjë moment nuk ka poseduar, përdorur apo gëzuar frutat e tokës bujqësore. Kjo dorëheqje është konfirmuar edhe pas vdekjes së babait ku ajo dhe motrat e tjera (A dhe P) nuk kanë kërkuar të përfitojnë nga trashëgimia e babait të tyre (Atit tim T). Ndërsa për motrën tjetër M. S, e kam deklaruar që është përfituese e tokës bujqësore. Gjithsesi posedimi dhe gëzimi është gjendje fakti, prona posedohet dhe gëzohet prej familjes time me 4 persona. Ndërsa motrës M S (M) që në momentin e martesës i kemi lënë në përdorim 2,15 dynym tokë bujqësore (ngastrën më të mirë) dhe 2,8 dynym pemëtoren (me arra) gjithësej 4,95 dynym fakt të cilën e kam deklaruar dhe në deklaratën Vetting. Po kështu, sikurse kam sqaruar edhe në pyetjet e mëparshme nga viti 2008 e në vazhdim kësaj të fundit ja kemi lënë në përdorim pa shpërblim gati të gjithë sipërfaqen e tokës (përfshijto pemëtoren dhe një dynymë tokë që përdor nëna për perime). Po kështu ju bëj me dije se babai im T. S (zotëruesi i AMTP) në momentin e ndarjes së Tokës ka qenë pensionist (dalë në pension si ish punonjës në punë shteti) dhe ka përfitur vetëm 1 dynym tokë. Me vdekjen e tij kjo pjesë trashëgohet në mënyrë të barabartë nga të gjithë trashëgimtarët e tij. Ndërsa pjesën tjetër e kemi përfitur ne pjesëtarët e tjerë të familjes. Sigurisht, pjesët takuese për secilin bashkëpronar do të përcaktohen vetëm pasi prona të regjistrohet.”

2.9 Komisioni i ka kërkuar informacion subjektit nëse ka bërë ndonjë aplikim për regjistrimin e pasurive të trashëguar nga babait. Subjekti¹⁵ ka shpjeguar se: “... nga babai kemi trashëguar një shtëpi banimi dykatëshe me mur guri, me katër dhoma, dy korridore dhe aneks ngjitur banesës. Po kështu së bashku me familjen, babai im ka përfitur sipas AMTP-së nr. ***, datë 13.4.1994: tokë bujqësore 32 dynym dhe 2.8 dynym pemëtore. Po kështu, sipas kësaj AMTP-së kemi dhe 350 m² truall. Toka është përfitur sipas ligjit 7501, datë 19.7.1991. Në lidhje me këto prona, nuk kemi dokumentacion tjetër përveç AMTP, pasi sikundër kam sqaruar edhe më pare, tokat dhe banesat e fshatit tonë janë ende të pa regjistruara”.

2.10 Subjekti ka depozituar dokumentacion ligjor justifikues për të mbështetur deklarinimet e tij gjatë hetimit¹⁶.

2.11 Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me mungesën e dokumentacionit ligjor justifikues për të vërtetuar pronësinë mbi këtë tokë, pjesën takuese dhe aktin e trashëgimisë.

2.12 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: [...] *Ju me të drejtë keni konstatuar mungesën e dëshmisë së trashëgimisë të cilën po e bashkëngjiti në fund të këtyre shpjegimeve. Dëshminë e trashëgimisë nuk e kam çelur në kohë pasi nuk më është dashur. Për ndonjë nevojë të ngutshme kam përdorur dëshminë e trashëgimisë së të ndjerit*

¹⁵ Në përgjigjet e pyetësorit, datë 17.2.2020.

¹⁶ Vërtetimin negativ të lëshuar nga ZVRPP-ja Kolonjë, duke shpjeguar se meqenëse tokat e fshatit Q-Kolonjë nuk është bërë regjistrimi i pronave, nuk kemi pasur asnjë mundësi për të aplikuar për regjistrim; vërtetimin negativ nr. ** prot., datë 18.2.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Kolonjë.

*xhaxhait tim, të lëshuar me vendimin nr. ***, datë 31.7.1995, të Gjykatës së Rrethit Kolonjë¹⁷, ku në vend të babait tim kanë hyrë me zëvendësim trashëgimtarët e tij M. S, Hysen Saliko dhe M. S (pasi motrat e mia A, V dhe S.S kanë hequr dorë nga trashëgimia në momentin e lëshimit të kësaj dëshmie, dorëheqje që është bërë në momentin e lëshimit të saj para gjykatës). Po sipas dëshmisë së trashëgimisë së lëshuar nga Notere F. L me nr. *** rep., nr. *** kol.,¹⁸ datë 25.6.2020, si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të babait tim është bashkëshortja e tij (nëna e subjektit) M. S dhe 2 fëmijët e tij Hysen Saliko dhe M.M (S), të cilët trashëgojnë nga 1/3 pjesë të pasurisë së tij.*

*Për rrjedhojë, si përfitues të tokës bujqësore pas dorëheqjes nga pasuria edhe të motrës S.B (S) në familje ishim 4 persona, konkretisht nëna M, subjekti Hysen, bashkëshortja e subjektit L, dhe djali i subjektit I (që janë përfitues të tokës sipas ligjit 7501). Ndërsa motrës M sikundër do të ndalemi më poshtë ja kemi veçuar me marrëveshje vullnetare pjesën e saj të tokës. Ashtu sikundër kemi sqaruar edhe në përgjigjen e dhënë për pyetësonin e nisur me e-mail e datës 17.2.2020, por edhe sikundër kam shpjeguar edhe në pyetësorët e mëparshëm, nga babai kemi trashëguar një shtëpi banimi dykatëshe me mur guri, me katër dhoma, dy korridore dhe ankese ngjitur banesës. Po kështu së bashku me familjen, babai im ka përfitur sipas AMTP-së nr. ***, datë 13.4.1994: tokë bujqësore 31 dynym dhe 2.8 dynym pemëtore. Po kështu sipas kësaj AMTP-së kemi dhe 350 m² truall. Toka është përfitur sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për Tokën”, ku edhe babai ka përfitur tokë. Me vdekjen e tij kjo pjesë trashëgohet në mënyrë të barabartë nga të gjithë trashëgimtarët e tij. Ndërsa pjesën tjetër e kemi përfitur ne pjesëtarët e tjerë të familjes.*

*Sikurse kam sqaruar edhe në përgjigjet e dhëna në korrespondencën e mëparshme, AMTP nr. ***, datë 13.4.1994, në emër të babait tim T. I.S, ashtu sikundër edhe të gjitha AMTP-të e fshatit Q, Kolonjë, nuk është regjistruar pranë kadastrës së qarkut. Nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore e ASHK-Korçë, Zyra Vendore e ASHK- Kolonjë (dhe më parë ZVRPP Kolonjë) na është konfirmuar se pasuritë e paluajtshme të fshatit Q nuk janë regjistruar për shkak se nuk është menaxhuar kjo zonë kadastrale. Pranë kësaj zyre ndodhet vetëm një kopje origjinale e AMTP-së nr. ***, datë 13.4.1994, në emër T. I. S, shkresë të cilën jua kam vënë në dispozicion. Nënvizoj faktin se mosregjistrimi edhe i tokës, ashtu si ai i banesës ka ardhur për faj të shtetit.*

Po kështu, është e vërtetë se në deklaratën Vetting unë jam shprehur se përfitoj 25 % të kësaj toke. Në këtë rast nuk e kam patur fjalën për pjesën e pronës, pasi për secilin anëtar të familjes bujqësore është përcaktuar pjesa përkatëse, por e kam patur fjalën për përfitimin e të ardhurave nga Toka Bujqësore. Kjo për faktin se që nga viti 2003 kur kemi bërë deklarinimin e parë dhe deri më tash, pas vdekjes së babait ne në familje kemi mbetur 4 persona që kemi përfitur tokë bujqësore, konkretisht M, H, L dhe I. S. Megjithatë sikurse kam sqaruar edhe më parë për këtë fakt në çdo deklarinim që kam bërë kam përdorur shprehjen me “familjen”.

Gjithashtu, është e vërtetë se në datën 1.8.1991 në përbërje të familjes ne kemi qenë shtatë anëtarë, ku në përbërje përfshihen edhe 2 motrat e mia S dhe M. Motra S që në momentin e martesës de facto ka hequr dorë nga pasuria, dhe për këtë fakt ajo për asnjë moment nuk ka poseduar, përdorur apo gëzuar frutat e tokës bujqësore. Kjo dorëheqje është konfirmuar edhe pas vdekjes së babait ku

¹⁷Për më tepër shihni vendimin nr. ***, datë 31.7.1995, të Gjykatës së Rrethit Kolonjë të cilën do ta gjeni bashkëngjitur këtij material.

¹⁸Për më tepër shihni dëshminë e trashëgimisë nr. ***, datë 25.6.2020, të lëshuar nga Notere F.L, të cilën do ta gjeni bashkëngjitur këtij material.

*ajo dhe motrat e tjera (A dhe P) nuk kanë kërkuar të përfitojnë nga trashëgimia e babait të tyre (babanë tim T). Pra, motra ime S edhe pse ka përfitur tokë bujqësore ka hequr dorë edhe prej saj. Fakti që të tre motrat kanë hequr dorë nga pasuria që trashëgojnë nga ati i tyre është konfirmuar edhe me deklaratat noteriale (shih deklaratat noteriale me: nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.5.2020, të lëshuar nga A.R (S)¹⁹; nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.5.2020, të lëshuar nga V.L (S)²⁰; dhe nr. *** rep, nr. *** kol., datë 14.5.2020, të lëshuar nga S. B (S)²¹, të cilat kërkoj që të merren si provë e që do t'ia bashkëngjis këtij materiali. Po kështu, në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.5.2020, të lëshuar nga S. B (S) provohet edhe fakti që ajo ka hequr dorë edhe nga toka që ka përfituruar me ligjin nr. 7501. Rezulton nëpërmjet kësaj deklarate noteriale se motra ime nuk ka pasur asnjë pretendim në lidhje me këtë pronë. Nëse ajo do të kishte patur pretendime në referim të nenit 227 të Kodit Civil²² do t'i kishte kërkuar të drejtat e saj (çka nuk ka ndodhur për 29 vjet). Heqja dorë e saj në bazë të nenit 193/c të Kodit Civil²³, aktualisht nuk mund të regjistrohet për dy arsye. Së pari, për faktin se prona nuk është regjistruar ende. Së dyti, dëshmia e trashëgimisë së babait është çelur në datën 25.06.2020 dhe për t'u hequr dorë nga trashëgimia duhet që heqja dorë të bëhet në momentin e çeljes së kësaj dëshmie (neni 333 i Kodit Civil²⁴) sikundër është bërë në fakt. Ndërkohë që sikundër përmendëm më sipër, fakti që tre motrat A, P dhe S kanë hequr dorë nga trashëgimia është provuar edhe me dëshminë e trashëgimisë së të ndjerit R. S²⁵.*

Ndërsa motra tjetër M.S, sikundër e kam deklaruar edhe më parë është përfituese e tokës bujqësore. Menjëherë pas martesës motrës M. S (M) ne i kemi lënë në përdorim 2 dynym tokë bujqësore (ngastrën më të mirë) dhe 2,8 dynym pemëtoren (me arra) Gjithsej 4,8 dynym fakt të cilën e kam deklaruar dhe në deklaratën e Vetting. Po kështu sikurse kam sqaruar edhe në pyetjet e mëparshme nga viti 2008 e në vazhdim kësaj të fundit ja kemi lënë në përdorim pa shpërblim gati të gjithë sipërfaqen e Tokës (përfashto pemëtoren me mollë dhe një dynym tokë që përdor nëna për perime). Të gjitha të ardhurat e siguruara prej përdorimit të tokës bujqësore i janë lënë kësaj motre²⁶, e cila në sezonet e punëve të bletëve ndihmon edhe nënën e bashkëshorten time.

Gjithsesi, posedimi dhe gëzimi është gjendje fakti, prona posedohet dhe gëzohet prej familjes time me 4 persona me përfashtim të asaj që posedohet e gëzohet nga motra M.M. Sigurisht, pjesët takuese për secilin bashkëpronar do të përcaktohen vetëm pasi prona të regjistrohet. Në momentin e regjistrimit të pronës do të regjistrohet edhe deklarata noteriale për heqjen dorë nga kjo pasuri. Ju bëjmë me dije se në lidhje me këto prona, nuk kemi dokumentacion tjetër përveç AMTP-së, pasi sikundër kam sqaruar edhe më parë tokat dhe banesat e fshatit tonë janë ende të pa regjistruara. Për këtë ju kemi vënë në dispozicion edhe vërtetimin negativ të lëshuar nga ZVRPP-ja Kolonjë.

¹⁹Për më tepër shihni deklaratën noteriale nr. ****, datë 12.5.2020, të cilën do ta gjeni bashkëngjitur këtij materiali.

²⁰Për më tepër shihni deklaratën noteriale nr. ****, datë 12.5.2020, të cilën do ta gjeni bashkëngjitur këtij materiali.

²¹Për më tepër shihni deklaratën noteriale nr. ****, datë 14.5.2020, të cilën do ta gjeni bashkëngjitur këtij materiali.

²²Çdo anëtar i familjes bujqësore mund të kërkojë pjesën e vet në pasurinë e familjes bujqësore.

²³Duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme:....c) aktet me të cilat hiqet dorë nga të drejta pasurore të mësipërme;

²⁴Heqja dorë nga trashëgimia duhet të bëhet me deklaratë shkruar, që regjistrohet te noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, ose me deklaratë noteriale të redaktuar nga noteri. Heqja dorë mund të bëhet edhe me anë të një përfaqësuesi të pajisur me prokurë të posaçme. Pas regjistrimit të heqjes dorë nga trashëgimia, noteri kryesisht lëshon një dëshmi të re trashëgimie, ku pasqyrohet ndryshimi në rrethin e trashëgimtarëve, si dhe pjesët e tyre takuese, të cilën ia dërgon personit që ka kërkuar lëshimin e dëshmisë fillestare të trashëgimisë.

²⁵Për më tepër shihni vendimin nr. ***, datë 31.7.1995, të Gjykatës së Rrethit Kolonjë, të cilën do ta gjeni bashkëngjitur këtij materiali.

²⁶Për më tepër shihni deklaratën noteriale nr. ****, datë 30.6.2020, të cilën do ta gjeni bashkëngjitur këtij materiali.

*Duke qenë se për tokat e fshatit Q, Kolonjë nuk është bërë regjistrimi i pronave, nuk kemi patur asnjë mundësi për të aplikuar për regjistrim. Ndërkohë që bashkëngjitur këtij materiali, përveç dokumenteve që ju kam nisur edhe më parë do të gjeni edhe vërtetimin negativ nr. *** prot., datë 18.2.2020²⁷, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Kolonjë.”*

Arsyetimi ligjor në lidhje me proovat dhe ligjin e zbatueshëm

2.13 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

2.14 Deklarimi i subjekti se sipërfaqja prej 32 dynym është trashëgimi nga babai, me burim krijimi përfitimin si anëtarë të familjes bujqësore sipas ligjit 7501, datë 19.7.1991, “Për Tokën”, i ndryshuar, nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin, për këto arsye:

2.15 Bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore paraqitet si bashkëpronësi në tërësi dhe për sa kohë nuk është bërë pjesëtimi sipas nenit 207 të Kodit Civil, ndaj saj zbatohen rregullat e përgjithshme dhe të posaçme të Kodit Civil për kryerjen e veprimeve juridike në tërësi apo dhe disponimit mbi to në veçanti.

2.16 Sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, ligjvënësi e njohu bashkëpronësinë mbi tokën bujqësore për të gjithë ata anëtarë të familjeve shqiptare që banonin dhe jetonin në fshat apo në ferma bujqësore, por që ishin në përbërje të familjes bujqësore. Personat që kishin lindur para datës 1.8.1991, kishin të drejtë të përfitonin nga dispozitat e ligjit, për t’u bërë bashkëpronarë të tokës bujqësore, e që do të përfitonin pas shpërbërjes së kooperativave dhe fermave bujqësore. Numri i anëtarëve të gjallë të familjeve bujqësore dhe, rrjedhimisht, numri i personave që do të ishin bashkëpronarë mbi tokën bujqësore, ishte një numër i përcaktuar me miratimin e ligjit “Për tokën” dhe VKM-në nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”²⁸. Në analizë literale të këtyre normave, konstatohet se natyra e bashkëpronësisë së familjes bujqësore në këtë rast, referuar edhe nenit 222 të Kodit Civil të vitit 1994, nuk mund të ndryshojë siç pretendon subjekti që ka në përdorim për qëllimet e tij të pothuajse të gjithë sipërfaqen e përfituar me anë të AMTP-së. Bashkëpronësia në tërësi e familjes bujqësore, për sa kohë nuk është pjesëtuar sipas rregullave të nenit 207 të Kodit Civil, secili prej tyre tërheq të drejta dhe detyrime ndaj asaj pasurie.

2.17 Familja bujqësore e subjekti e cila ka përfituar 32 dynym për efekt të ligjit është përfaqësuar në aktin e marrjes së tokës në pronësi nga kryetari i familjes/z. T. S, sipas parashikimeve të nenit 227 të Kodit Civil.

²⁷Për më tepër shihni vërtetimin negativ nr. *** prot., datë 18.2.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Kolonjë.

²⁸ Referuar ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për Tokën”, i ndryshuar, dhe akteve në zbatim të tij, konkretisht: Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriterin e ndarjes së tokës bujqësore”, pika 2, parashikohet se: “ *Në të gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje, sipas numrit të frymëve, të gjendjes civile në datën 1 Gusht 1991*”. Më tej, po në të njëjtin vendim parashikohet se: “ [...] *në numrin e frymëve të familjes anëtarë të kooperativës bujqësore.... do të përjashtohen anëtarët e familjes që në momentin e ndarjes së tokës janë në marrëdhënie pune të përhershme në sektorin shtetëror ose privat [...]*”.

2.18 Duke qenë se numri i frymëve të gjendjes civile të datës 1.8.1991 ka qenë 7 anëtarë, ata kanë përfituar përpjesëtimisht në mënyrë të barabartë 32 dynym tokë bujqësore sipas ligjit nr. 7501, ndërkohë që babai i subjektit të rivlerësimit/z. T. S (zotëruesi i AMTP) në momentin e ndarjes së tokës ka qenë pensionist dhe ka përfituar vetëm 1 dynym tokë. Në të njëjtat kushte si babai i tij/z. T.S ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit, pasi po t'i referohemi datës 13.4.1994 të AMTP-së me nr. ***, dhe datës së fillimit të punës si ndihmë gjyqtar më 1.12.1993, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë në marrëdhënie pune të përhershme shtetërore, për këtë arsye i takonte jo më tepër se 1 dynym tokë, sipas VKM-së nr. 255, datë 2.8.1991, pika 2, sipërtrajtuar.

2.19 Subjekti i rivlerësimit konsiderohet si një nga bashkëpronaret midis 7 anëtarëve të familjes bujqësore, referuar ligjit 7501, datë 19.7.1991, i ndryshuar dhe neni 222 e vijues i Kodit Civil, ku përcaktohet se: *“Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore, u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore.”*. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë zotërimin e 32 dynymëve, përfituar nga familja e subjektit si anëtarë të familjes bujqësore. Më tej, edhe sikur ta marrim të mirëqenë faktin se subjekti ka marrë pjesë si anëtar i familjes bujqësore, referuar ligjit 7501, datë 19.7.1991, i ndryshuar, i takonte vetëm 1/7 pjesë e anëtarëve të familjes bujqësore në momentin e ndarjes së tokës.

2.20 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se përfituesit e 32 dynymëve tokë bujqësore në vitin 1994, sipas ligjit 7501, respektivisht motrat e subjektit kanë hequr dorë nga kjo e drejtë, nuk qëndron, pasi subjekti nuk paraqiti dokumentacion ligjor justifikues se kjo pronë e përfituar nga e gjithë familja bujqësore, kishte qenë vetëm në zotërim të tij. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me pjesën e tij takuese.

2.21 Rrjedhimisht edhe të ardhurat e përfituara nga prodhimet bujqësore konsiderohen si të ardhura familjare, respektivisht në 1/7 pjesë.

2.22 Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm dhe nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues se toka bujqësore dhe pemëtaria me sipërfaqe prej 32 dynym i përkiste vetëm subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, edhe të ardhurat e përfituara prej fryteve të kësaj prone.

2.23 Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion që justifikon vërtetësinë e deklarimeve të tij në lidhje me posedimin e 32 dynym tokë bujqësore dhe për rrjedhojë për të ardhurat e përfituara nga frutet e kësaj toke, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 3 e nenit D të Aneksit të kushtetutës dhe neni 33, pika 5, gërma “a” e ligjit nr. 84/2016.

3. Të ardhurat nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria mbi tokën bujqësore që trajtuam në pikën 2 më lart

Duke qenë se pasuritë, likuiditetet *cash* dhe bankë, si dhe pasuri të tjera të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit kanë si burim krijimi, kryesisht të ardhurat nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria, para se të trajtohen këto pasuri, Komisioni vlerëson se duhet të analizohen të ardhurat nga këto aktivitete për vitet 1993 – 2015, si vijon:

3.1 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën prej 15.532.000 lekësh të ardhura nga ferma bujqësore, pemëtorja dhe bletaria në pronësi të familjes që ndodhet në fshatin Q, Njësia Administrative M, Bashkia Kolonjë për periudhën 1992 – 2016 (tokë bujqësore 29 dynym, 2.8 dynym pemëtoresh dhe nga mbarështimi i 40-60 koshere bletë nga viti 1992 e në vazhdim). Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për këto të ardhura në deklaratën *Vetting* të vitit 2017.

3.2 Gjatë hetimit administrativ kryesisht ka deklaruar se për të ardhurat e siguruar nga ferma bujqësore, pemëtaria dhe bletaria e familjes për vitet 1994 – 2016, ka siguruar të ardhura nga toka bujqësore e ndodhur në fshatin Q, Njësia Administrative Mollas, Bashkia Kolonjë, tokë në sasinë prej 29 dynym tokë arë dhe pemëtari 2.8 dynym. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe familja ka mbarështuar çdo vit: për vitin 1992 pesë koshere bletë; për vitet 93-95, 20 koshere bletë; për vitet 1996-1998 ka mbarështuar 30 koshere; dhe nga viti 1999 e në vazhdim nga 40-60 koshere bletë. Aktualisht ka në mbarështim 45 koshere/bletë. Në vitin 1996 ka shitur të gjithë blegtorinë e përfituar nga shpërbërja e ish-kooperativës bujqësore dhe të shtuar në vite në vlerën 300.000 lekë. Në vitin 2010 familja ka shitur 25 koshere bletë në vlerën 450.000 lekë.

3.3 Për vitet 1993 – 2012 bashkëshortja e subjektit, znj. L. S ka qenë e vetëpunësuar në sektorin privat dhe për të gjithë periudhën janë paguar taksa për tokën dhe për banesën.

3.4 Në vitet 1996 – 2000 ka prodhuar, ndër të tjera, përveç perimeve dhe prodhimeve bujqësore edhe rreth 400-600 kg/mjaltë dhe 30-50 kv/mollë. Ndërkohë që nga viti 2001 dhe në vazhdim ka prodhuar 800-1000 kg/mjaltë dhe rreth 50-100 kv/mollë, sasi kjo e ndryshme në vite. Në vitet 2010 – 2016 ka siguruar nga 40-120 flakonë (një flakon ka 10 gram) me qumësht “*mëme*”. Gjatë gjithë kësaj periudhe ka prodhuar perime dhe fasule në sasi që variojnë 10-15 kv/viti dhe arra nga 50-100 kg/viti. Të gjitha prodhimet janë shitur te blerës të ndryshëm në sasi të vogla. Sasitë nuk janë evidentuar për shkak se gjatë kësaj periudhe nuk kërkohej dokumentimi apo shitja e mallit me faturë. Këto të ardhura janë deklaruar për të gjitha vitet e deklaramit. Në llogaritjet e mëposhtme janë përfshirë vetëm fitimet *neto* duke zbritur shpenzimet për punimet dhe shërbimet e kryera.

3.5 Sipas subjektit, ndërkohë që për vitin 2016 në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 10, datë 02.05.2015, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 19, datë 13.11.2014, dalë në zbatim të ligjit nr. 92/2014, “Për TVSH”, nëna e subjektit është pajisur me NIPT L****V “Bujk Privat” dhe për pasojë shumica e shitjeve të prodhimeve janë kryer me faturë tatimore (autofaturë të blerësit, të cilat i bashkëngjiten këtij sqarimi). Në të ardhurat e vitit 2016 nuk janë përfshirë të ardhurat nga shitjet e bëra në sasi të vogla në mjaltë dhe qumësht ble të subjektet private, pasi me këto të ardhura janë mbuluar shpenzimet për mirëmbajtjen, punimet dhe shërbimet e kryera për banesën në fshat, tokën, pemëtarinë dhe bletarinë, shumë kjo që shkon në rreth 500.000 lekë.

3.6 Gjatë hetimit administrativ, subjekti është pyetur nga Komisioni që të shpjegojë dhe të dokumentojë të ardhurat e krijuara nga bletaria për çdo vit që nga viti 1992 ku të specifikohen dhe dokumentohen: (i) shitjet në vlerë dhe në sasi të produkteve; (ii) çmimet e shitjes së produkteve; (iii) numri i koshereve të bletëve sipas viteve dhe kostot e blerjes së tyre; (iv) shpenzimet për rritjen/mjekimin/ruajtjen/vjeljen e tyre, etj.; (v) shpenzimet për ambalazhimin e produkteve; (vi) sasinë në litra e prodhuar për koshere/bletë në vit.

3.7 Në përgjigje të pyetjeve nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit, ka shpjeguar²⁹ se: “Në lidhje me sasinë dhe vlerën e shitjeve, subjekti ka hartuar një tabelë të detajuar (tabela nr. 1) ku ka specifikuar numrin e koshereve bazë në fillim të çdo viti, shtesat e krerëve të bletëve (në shtesa është përcaktuar numri pasi është bërë dhe zbritja e humbjeve të bëra gjatë dimrit). Si bazë për të shtuar tufën e bletëve ka shërbyer përfitimi nga shpërbërja e ish kooperativës bujqësore të dy krerëve bletë në vitin 1991. Më pas krerët janë shtuar sipas tabelës së sipërcituar. Në këtë tabelë do të gjeni të evidentuar dhe faktin se në vitin 2010 ka shitur 25 krerë bletë në shumën 450.000 lekë (bashkëngjitur do të gjeni dhe deklaratën e nënshkruar nga blerësit ditën e shitjes). Për ilustrim dhe të gjendjes së numrit të bletëve po ju nis një foto të printuar nga fotografimi ajror i bërë në kuadër të legalizimit në vitin 2007, ku duken qartë dhe kosheret e bletëve para dhe mbrapa shtëpisë. Për sa i përket kostos së blerjes së koshereve, sqarojmë se në lidhje me kosheren si send, kostoja e tyre për vitet e para 1992 deri në 1994 ka qenë deri 50 lekë. Më pas me kalimin e kohës çmimet janë rritur nga viti në vit. Por asnjëherë nuk e kanë kaluar vlerën e 1 litri mjalti deri në vitin 2003. Ju bëj me dije se për kosheret deri në vitin 2004 është paguar vetëm puna e marangozit pasi, montimin e tyre e kam bërë vetë me të afërmit. Pas 2007 kam blerë koshere të reja sipas nevojës, për të cilat kam dhënë sqarime të hollësishme në tabelën përkatëse. Konkretisht numrin më të madh të koshereve e kam bërë në vitin 1996 ku kam bërë 20 koshere të reja me 500 lekë secila që kapin vlerën 10.000 lekë. Në vitin 2007 kam bërë 28 koshere të reja me 2.000 lekë secila që kapin vlerën 56.000 lekë. Po kështu në vitin 2016 kam bërë 15 koshere të reja me 4.000 lekë secila të cilat kapin shumën 60.000 lekë dhe janë konsideruar si shpenzime dhe janë zbritur nga të ardhurat.

Shpenzimet e kryera për kosheret, mirëmbajtjen, mjekimin dhe ushqimin e tyre nuk janë përfshirë në të ardhurat neto të raportuara prej meje në deklaratën e Vetting dhe njëherazi në deklaratat periodike të dorëzuara në ILDKPKI. Në ato deklarata janë deklaruar vetëm të ardhura neto të përfituara, pasi janë zbritur shpenzimet e kryera dhe sasisë e përdorura për familjen. Sqaroj se në këto deklarata janë raportuar vetëm të ardhurat që kanë ngelur pa u konsumuar në fund të vitit. Ndërsa për sa i përket kostos së blerjes së krerëve të bletëve, për këtë nuk kemi kryer asnjë shpenzim, pasi shtimi i tyre është bërë në mënyrë natyrale (nëpërmjet rroitjes apo të ndarjes, ku një bletë bëhet në fillim të muajit maj sipas rastit në dy ose tre krerë).

Në lidhje me koston e mjekimit dhe të ushqimit, sqaroj se mjekimi ka variuar sipas indeksit të rritjes së çmimit. Vlera e tyre nuk e ka kaluar vlerën e 0.5 (0.666 kg) litri/mjaltë. Po kështu edhe kostoja për ushqimin e tyre gjatë periudhës së dimrit dhe pranverës, që nuk e kalon vlerën e 0,5 (0,666 kg) litri/mjaltë. Ndërkohë që shpenzime për shtimin dhe ruajtjen e tyre nuk kemi pasur, pasi nga viti 1992 deri në vitin 2012 me mbarështimin e tyre është marrë bashkëshortja dhe nëna ime. Po kështu, punët që kanë bëjnë me shtimin dhe mjekimin janë kryer prej meje dhe djalit tim. Ndërsa pas këtij viti me mbarështimin është marrë nëna dhe gjatë muajve të verës dhe unë së bashku me djalin e madh I. Edhe për vjeljen e tyre nuk kemi kryer shpenzime, pasi vjelja është bërë prej pjesëtarëve të familjes. Sqarojmë se vjelja kryhet gjatë pesëmbëdhjetëditëshit të parë të muajit korrik dhe dora e dytë nga mesi gushtit. Për sa i përket ambalazhimit, kostot kanë qenë të papërfillshme, pasi mjalti është shitur me shishe plastike 1/5 litra (të cilat marrin 2 kg mjaltë). Një shishe plastike ka konstatuar sipas viteve nga 1 deri në 5 lekë/copa.

²⁹ Me përgjigjet e pyetësorit të datës 19.11.2019.

Në lidhje me sasinë e prodhuar nga një krerë bletë varion sipas viteve, por që nuk ka qenë më pakët se 12 litra (ose 16 kg) dhe që varion deri në 18 litra (ose 24 kg). Sqarime të mëtejshme do i gjeni në tabelën nr. 1, bashkëngjitur këtij informacioni. Gjithashtu nga viti 2010 deri në vitin 2016 nga numri totali i bletëve në prodhim, 410 krerë janë përdorur për prodhim qumësht mëme. Nga çdo krerë kemi marrë nga 10 – 14 flakonë (10 gram/flakoni). Çdo flakon shitet 6.000 deri në 10.000 lekë (600-1.000 lekë grami). Edhe gjatë viteve 1994 deri në 2010 kemi përdorur për qumësht çdo vit dy krerë, nga të cilat kemi marrë nga 20 flakona, por që shumicën e kemi përdorur për nevojat e familjes dhe pjesën tjetër e kemi shitur dhe të ardhurat janë përdorur për mirëmbajtjen e banesës. Për vitet 2010 – 2016 shitjet janë të evidentuara në mandat arkëtimi të nënshkruar nga blerësit (fotokopje të të cilave do t'i gjeni bashkëngjitur).

Po kështu për vitin 2016 e në vazhdim shumicën e shitjeve të mjaltit e kemi bërë me autofaturë tatimore me TVSH të lëshuar nga blerësi (bashkëngjitur fotokopje të autofaturave). Sqarime të mëtejshme do i gjeni në tabelën nr.2 bashkëngjitur këtij informacioni. Dokumentacion ku të provohet se fitimet neto të deklaruara nga veprimtaria e bletarisë, janë paguar tatimet në kuptimin e pikës 3, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

*Në lidhje me këtë pyetje sqarojmë se nga ana jonë me daljen e ligjit për pagimin e taksave mbi 'Tokën bujqësore' në vitin 2004 dhe në vazhdim kemi paguar taksën e tokës në masën 2.366 lekë në vit dhe taksën e ndërtesës në shumën 250 lekë (bashkëngjitur keni vërtetimin nr. ***prot., datë 20.11.2019, të Njësisë Administrative M, Bashkia Kolonjë). Po kështu duke qenë se kemi jetuar në pjesën më të madhe në fshat, gjatë kësaj kohe bashkëshortja që është marrë dhe me kujdesin e punëve të fshatit ka paguar sigurimin e detyrueshëm si bujk privat nga viti 1993 deri në vitin 2012 (për më tepër shihni vërtetimin e DRSSH-së Ersekë me të cilin provohet kontributi i paguar për çdo vit që është pjesë e deklaratës Vetting). Bujku privat nuk ka pasur asnjë detyrim tjetër. I vetmi detyrim 'Bujkut Privat' i ka lindur me daljen e ligjit për pajisjen e tij me nipt privat, ligj i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2015 dhe që për ne është zbatuar në vitin 2016. Edhe në këtë rast bujku duhet të nënshkruaje vetëm autofaturën e lëshuar nga blerësi, autofaturë që nuk përmban asnjë taksë, përkundrazi avantazhon blerësin tatim-pagues me TVSH për të përfituar nga shteti rimbursimin e saj. Për më tepër që 'Bujku Privat' subvencionohet nga shteti për shumë lloj prodhimesh dhe veçanërisht për mbarëshkrimin e bletës."*

3.8 Kërkesës për informacion të detajuar në lidhje me të ardhurat e krijuara nga pemëtaria apo produkte të tjera bujqësore sipas viteve, shoqëruar me dokumentacion ku të provohet se janë paguar tatimet në kuptimin e pikës 3, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit i është përgjigjur se: *"Në lidhje me këtë pyetje sqaroj se që nga viti 1992 deri në vitin 2007 kemi shfrytëzuar të gjithë tokën bujqësore prej 2,9 ha. Ndërkohë që nga viti 2008 e në vazhdim këtë tokë e ka përdorur motra ime që jeton në Ersekë, dhe që aktualisht përdor dhe aneksin (ashefin) që kam bashkëngjitur shtëpisë dhe për të cilin është kujdesur dhe ka kryer edhe riparimet përkatëse. Nga ana jonë nga viti 2008 e në vazhdim janë përdorur vetëm 3-4 dy, për nevojat e veta, fasule, patate dhe perime. Nga kjo sipërfaqe kemi mbjellë çdo vit me kulturën e grurit 1,5 ha grurë dhe kemi marrë mesatarisht mbi 35 kv/ha. Pra, kemi marrë çdo vit mbi 50 kv grurë. Shpenzimet për një hektar grurë deri në magazinim llogariten deri në 6 kv/ha. Në shpenzimet nuk është llogaritur fara e cila është mbajtur nga prodhimi i mëparshëm. Shitjet janë*

bërë pa faturë te persona të tretë. Sqarime të mëtejshme do i gjeni në tabelën nr.3 bashkëngjitur këtij informacioni.”

“Po kështu - deklaroi subjekti më tej - kemi mbjellë çdo vit 5 dynym misër dhe 4 dynym jonxhë. Nga kjo sasi e mbjellë nuk kemi llogaritur të ardhura pasi këto i kemi përdorur për mbarështimin e blegtorisë (dhen dhe lopë). Deri në vitin 1996 kemi patur 20 dhen, tre lopë dhe një mushkë, të cilat i kemi përfutur nga shpërbërja e ish Kooperativës Bujqësore në vitin 1991. Në këtë vit (1996) kemi shitur 18 dhen ($18 \times 4.000 = 72.000$ lekë), 18 shqerra ($18 \times 3.000 - 54.000$ lekë), 1 lopë ($1 \times 40.000 = 40.000$ lekë), 2 viçe ($2 \times 20.000 = 40.000$ lekë) dhe një mushkë ($1 \times 50.000 = 50.000$), duke mbajtur vetëm 2 lopë, një viç, 2 dhen dhe dy shqerra (prej këtyre të fundit me përjashtim të dy lopëve, të tjerat i kemi konsumuar për vete). Gjithësej shuma e përfutur nga këto shitje kap vlerën 256.000 lekë. Gjithashtu nga viti 1992 deri në vitin 1995 kemi shitur për çdo vit nga 15 shqerra (4 vjet-60 shqerra) dhe 2 viça (4 vjet-8 viça) që kanë patur vlerën 167.000 lekë (shqerrat $15 \times 1.000 + 15 \times 1.500 + 15 \times 2.000 + 15 \times 2.500 = 105.000$ lekë dhe viçat $2 \times 3.000 + 2 \times 5.000 + 2 \times 10.000 + 2 \times 15.000 = 66.000$ lekë). Ndërkohë që për çdo vit 5 krerë dhen ose shqerra dhe një viç e kemi përdorur për mish për nevojat e familjes. Për nevojat e familjes kemi përdorur dhe prodhimet e 23-30 shpendëve (pulave) të mbarështuara në fshat.

Nënvizojmë faktin se shitjen e dy lopëve të fundit me gjithë mëshqerrë (viç) e kemi shitur në vitin 2007 kundrejt vlerës 220.000 lekë (ky fakt provohet dhe me deklaratën e nënshkruar dhe nga blerësi). Gjithashtu, kemi mbjellë për çdo vit 3 dynym fasule, 1 dynym patate dhe 1 dynym perime. Nga të cilat kemi prodhuar për çdo vit mbi 6 kv/fasule, mbi 15 kv/patate dhe rreth 15 kv/perime. Po kështu, në oborrin e shtëpisë kemi të mbjellë dhe rrush dhe kumbulla nga të cilat kemi siguruar mbi 50 litra/raki për çdo vit.

Për vitet 2010-2016 vazhdim sikundër theksuam edhe më sipër kemi përdorur vetëm 3-4 dy tokë, të cilat e kemi mbjellë me perime, patate dhe fasule të cilat i kemi konsumuar për nevojat e familjes. Përjashtojmë vitin 2016 që kemi shitur me autofaturë tatimore fasule, perime dhe patate në vlerën 514.500 lekë (bashkëngjitur faturat përkatëse për këtë vit). Në këto vite kemi marrë sasi të sipas tabelës nr. 4, nr. 5 dhe nr. 6 bashkëngjitur këtij informacioni. Në sipërfaqen e tokës së përfutur me ligjin 7501 kemi dhe 2,8 dy pemëtore e përbërë prej pemës arore e ‘arrës’ nga e cila marrim mesatarisht deri në 50 kg në vit, nga të cilat janë shitur mesatarisht 20-30 kg. Në vitin 2016 me faturë kemi shitur me autofaturë 50 kg në vlerën 36.000 lekë (bashkëngjitur fotokopje të faturës).

Në fund të vitit 1991 fillim të vitit 1992 kemi mbjellë rreth 400 drurë mollë duke krijuar një pemëtore. Kjo pemëtore ka hyrë në prodhim në vitin 1996 dhe që nga ky vit deri në vitin 2018 pemëtorja ka qenë e plotë. Nga këto në fund të vitit 2017 kemi shkukur rreth 180 drurë mollë, dhe aktualisht kemi rreth 220 drurë mollë. Mollët për vitet 1996-2009 janë shitur pa faturë, sipas kërkesave të personave të tretë (kryesisht te tregtarë nga Saranda, Gjirokastra dhe Tirana). Për vitet 2010-2015 shitjet janë bërë me fatura të thjeshta (mandate arkëtimi nënshkruar nga blerësit). Përjashtojmë vitin 2016 (dhe për vitet në vazhdim) që kemi shitur me autofaturë tatimore mollë në sasinë 9.330 kg, në vlerën 260.000 lekë. Në këto vite kemi marrë sasi të sipas tabelës nr. 7 bashkëngjitur këtij informacioni. Në lidhje me pagesën e tatimeve referojmë sqarimeve të dhëna më sipër në përgjigjen e nën pyetjes b”.

Sqarojmë se shitjet për periudhën para vitit 2010 janë bërë pa asnjë dokument për shkak se një gjë e tillë nuk është kërkuar dhe se ‘Bujku Privat’ nuk i është kërkuar për asnjë moment

dokumentimi i shitjeve dhe të ardhurave. Ndërsa nga viti 2010 e në vazhdim çdo shitje e kemi të dokumentuar. Ndërsa për shitjet e mollëve dokumentimin e kemi nga viti 2016 e në vazhdim me autofaturë tatimore. Ndërkohë që për shitjet e mjaltit për periudhën 1999 e në vazhdim kemi vetëm shënimet që kemi mbajtur për mbarështimin e bletëve ku kemi pasqyruar edhe shënimet që kemi mbajtur për të evidentuar mbarështimin e bletëve dhe njëherazi emrat e personave që kanë marrë të paktën mbi 3 bidonë (6 kg) mjaltë (nëse duhen unë ju paraqes edhe fotokopje të këtyre fletoreve).

Një informacion më të detajuar për të ardhurat totale për çdo vit dhe për të gjithë periudhën e deklarimit do i gjeni në tabelën nr.8 bashkëngjitur këtij informacioni. Është e vërtetë se në këtë tabelë, të ardhurat e siguruara janë më të larta nga ato të deklaruara ndër vite, por kjo ka ardhur se në ato deklarata kam dhënë të dhëna vetëm për shumat neto që kanë mbetur si fitim në fund të vitit, pasi janë zbritur produktet që janë përdorur për vete familjen. Nga prodhimet e deklaruara në këtë tabelë dhe në tabelat 1 deri në 7, një pjesë është përdorur për nevojat e familjes dhe për ndonjë dhuratë për të afërm dhe miq e shokë.

Nënvizoj faktin se të ardhurat neto të pasqyruara për çdo vit në kolonën e fundit nuk përputhen me ato që janë deklaruar në Deklaratat Periodike të Pasurisë (mospërputhje që shkon nga 50 deri në 200 mijë për çdo vit), për shkak se këtu në pjesën më të madhe janë përfshirë edhe të ardhurat që janë përdorur për nevojat e familjes ndër vite.”

3.9 Në tabelën vijuese pasqyrohen të ardhurat e krijuara nga aktiviteti bujqësor/bletaria, sipas deklarimeve te subjektit.

8

VITI	Grurë	Fasule	Perime	Patate	Arra	Mollë	Qumësht	Mjaltë	Nga shitja e blektorisë	Shitja e bleteve	Shuma totale
1992	20.000	8.000	1.500	2.000	1.000	-	-	3.800	21.000	-	57.300
1993	40.000	11.000	4.500	6.000	2.000	-	-	13.600	32.500	-	109.600
1994	60.000	20.000	4.500	6.000	3.000	-	-	21.600	50.000	-	165.100
1995	60.000	29.000	9.000	10.000	3.000	-	-	100.000	67.500	-	278.500
1996	80.000	38.000	9.000	10.000	3.000	30.000	-	82.000	256.000	-	508.000
1997	80.000	35.000	9.000	10.000	4.000	36.000	-	136.500	-	-	310.500
1998	80.000	34.000	15.000	20.000	4.000	44.000	-	118.000	-	-	315.000
1999	80.000	36.000	15.000	20.000	4.000	52.000	-	208.000	-	-	415.000
2000	90.000	40.000	15.000	20.000	4.000	68.000	-	226.000	-	-	463.000
2001	90.000	40.000	15.000	30.000	5.000	80.000	-	290.000	-	-	550.000
2002	90.000	40.000	15.000	30.000	5.000	130.000	-	340.000	-	-	650.000
2003	90.000	45.000	20.000	30.000	-	130.000	-	406.000	-	-	721.000
2004	100.000	45.000	20.000	30.000	-	130.000	-	462.800	-	-	787.800
2005	110.000	45.000	20.000	30.000	-	130.000	-	525.600	-	-	860.600
2006	110.000	45.000	20.000	30.000	-	130.000	-	586.200	-	-	921.200
2007	110.000	45.000	20.000	30.000	-	130.000	-	683.200	220.000	-	1.238.200
2008	-	-	-	-	-	154.000	-	790.000	-	-	944.000
2009	-	-	-	-	-	202.000	-	810.000	-	-	1.012.000
2010	-	-	-	-	-	200.000	760.000	590.000	-	450.000	2.000.000
2011	-	-	-	-	-	214.000	530.000	588.000	-	-	1.327.000
2012	-	-	-	-	-	238.000	552.000	582.000	-	-	1.372.000
2013	-	-	-	-	-	244.000	466.000	582.000	-	-	1.292.000
2014	-	-	-	-	-	250.000	506.000	630.000	-	-	1.386.000
2015	-	-	-	-	-	256.000	454.000	608.400	-	-	1.318.400
2016	-	180.000	262.500	72.000	36.000	260.000	170.000	834.540	-	-	1.815.040
Shuma	1.290.000	736.000	475.000	386.000	74.000	3.108.000	3.438.000	10.218.240	647.000	450.000	20.822.240

P.S. Nënvizoj faktin se të ardhurat neto të pasqyruara për çdo vit në kolonën e fundit nuk përputhen me ato që janë deklaruar në Deklaratat Periodike të Pasurisë (mospërputhje që shkon nga 50 deri në 200 mijë për çdo vit), për shkak se këtu në pjesën më të madhe janë përfshirë edhe të ardhurat që janë përdorur për nevojat e familjes ndër vite.

3.10 Subjekti, për të mbështetur në deklaratimet e tij si më lart, gjatë hetimit ka depozituar: vërtetim nr. *** prot., datë 20.11.2019, lëshuar nga Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative Mollas, që

vërtetohet se z. T. I.S, ish-banor i fshatit Q, në bazë të ligjit 7501/1991, ka përfituar sipërfaqen 33.800 m², tokë bujqësore dhe se janë paguar taksat e tokës dhe taksat e ndërtesës për vitet nga 2004 – 2019, pagesat janë shlyer nga M dhe Hysen Saliko; vërtetim (për të vetëpunësuar në bujqësi) nr. *** prot., datë 07.10.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, Agjencia Kolonjë, sipas të cilës vërtetohet se L. Xh. S ish-banore e komunës Mollas, figuron si e vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 1993, në regjistrin themeltar të të vetëpunësuarve në bujqësi me nr. *** dhe se ka paguar rregullisht kontributet për periudhën 1993 – 2012; ortofoto të pasurisë ndodhur në Q (shtëpisë, printim i datës 10.12.2019), ku duket se rreth shtëpisë ndodhen koshere me bletë; mandatpagesa për produktet e shitura, mjaltë, grurë, mollë, etj.; si dhe deklarata dore (subjekti ka depozituar një numër të konsiderueshëm të këtij dokumentacioni gjithsej 89 faqe).

Në lidhje me aktivitetin nga bletaria

3.11 Komisioni në kushtet e mungesës së të dhënave zyrtare mbi produktivitetin, kostot e shpenzimeve dhe fitimin që mund të gjenerohet nga bletaria, i është drejtuar Shoqatës së Bletërritësve të Shqipërisë, për të siguruar këto të dhëna.

3.12 Kjo shoqatë ka informuar mbi produktivitetin dhe fitimin që mund të gjenerohet nga bletaria, ku kryesisht përputhet me deklaratimet e subjektit. Komisioni, duke analizuar informacionin e dhënë nga subjekti, ka konkluduar se shpenzimet vjetore janë mesatarisht në masën 15 % e të ardhurave nga shitjet.

Në lidhje me punësimin e bashkëshortes së subjektit në sektorin privat

3.13 Komisioni e ka pyetur subjektin për të saktësuar se ndërkohë që bashkëshortja ka qenë e punësuar në sektorin privat, kush është marrë me punët e bujqësisë.

3.14 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar³⁰ se: *“Në lidhje me këtë pyetje ju sqaroj se, sikundër kam sqaruar hollësisht edhe në përgjigjet e dhëna për pyetëtorin e dërguar në mënyrë elektronike në datën 19.12.2019 për mbarështimin e bletëve kanë kontribuar të gjithë pjesëtarët e familjes. Kontributin më të madh e ka nëna dhe bashkëshortja. Pas muajit nëntor 2012 deri në datën 31.12.2016 përveç nënës, dhe familjes për muajt e verës, ndihmesë ka dhënë edhe motra ime M. T. M, banuese në Ersekë. Sikurse kam analizuar edhe në përgjigjen e pyetjes “8/b” të pyetëtorit të mësipërm, unë me familjen nga viti 1992 deri në vitin 2007 kam përdorur 29 dy tokë nga 32 dy që kemi në pronësi. Tre dynmë tokë janë përdorur nga motra (nënvizoj se edhe motra është përfituese e tokës bujqësore në AMTP). Ndërkohë që nga viti 2008 dhe në vazhdim e gjithë toka e familjes i është lënë në përdorim pa shpërblim motrës M, e cila ka përfituar të gjitha të ardhurat nga kjo tokë bujqësore.*

Duke qenë se gjatë kësaj periudhe ajo ka punuar tokën të gjithë tokën e familjes të lënë në përdorim dhe njëherazi ka qenë e papunë, gjatë muajve të verës për vitet 2013-2016 ka ndihmuar nënën për mbarështimin e bletëve dhe ka kryer punime për mollët. Gjithashtu jam i detyruar që t’ju sqaroj

³⁰ Në përgjigjet e pyetëtorit të datës 17.2.2020.

se kujdesi për bletët intensifikohet nga prill deri në fund të gusht. Gjatë kësaj periudhe çdo qershor bashkëshortja ka marrë leje të zakonshme, në korrik ka qenë të paktën njëri nga djemtë dhe gjatë gushtit kam qenë dhe unë personalisht. Për këtë periudhë edhe nëna vetë ka qenë në gjendje të mirë shëndetësore dhe e aftë për t'u marrë me përkujdesje të bletëve”.

3.15 Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me mungesën e dokumentacionit ligjor justifikues mbi të ardhurat e përfituara nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria për vitet 1992 – 2015 , të deklaruara në DPV-të dhe në deklaratën *Vetting*.

3.16 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: *“Në lidhje me të ardhurat e siguruara nga bujqësia dhe bletaria, kam pasur një korrespondencë të gjerë me Komisionin (subjekti i referohet shpjegimeve gjatë hetimit të cituara me lart) dhe kam dhënë një sërë shpjegimesh duke u përpjekur të jem para së gjithash tejet i sinqertë dhe sa më argumentues, njëherazi jam përpjekur të jem sa më i qartë dhe i kuptueshëm.*

Bashkëshortja dhe nëna si të vetëpunësuar kanë paguar rregullisht sigurimet dhe taksën e tokës (atë që kishin detyrim) dhe janë marrë me punë bujqësie deri në vitin 2007. Më pas janë marrë kryesisht me shërbimet ndaj pemëtarisë dhe kopshtit për produktet për konsum familjar. Sikundër theksova dhe më sipër, bletaria ka qenë dhe është një pasion i trashëguar nga babai dhe shumë fitimprurës. Mjalti është një produkt shumë i kërkuar në treg dhe shpesh herë nuk kam arritur të plotësoja kërkesat e miqve e kolegëve për këtë produkt. Këtë fakt të njohur mund tua provojnë mjaft kolegë të mi dhe miq, emrat e të cilëve po ua jap të cilët me kënaqësi vijnë të dëshmojnë këtë fakt. Arrat janë gjithashtu një frutë mjaft i kërkuar në treg dhe gjithashtu i kushtueshëm, i shtrenjtë në shitje. Shpenzimet për to janë të pakta ose minimale. Mollët kanë prodhim aq të lartë sa nuk arrijmë t'i shesim dhe i hanë dhe kafshët. Ju kam provuar që kam lindur dhe kam jetuar në fshatin Q, pa ndërprerje deri rreth vitit 2007. Edhe sot kam shumë lidhje të ngushta, pasi kam shtëpinë e trashëguar nga babai dhe nëna kryesisht jeton atje edhe sot pasi kujdeset sa mundet për kopshtin rreth shtëpisë dhe me bletët aq sa mundet. Ju kam provuar që nuk e kam braktisur vendlindjen time as sot që flasim pasi kam atje nënën, tokën, shtëpinë, pemët dhe si pjesë të familjes edhe bletët. Për këto kërkoj të thërrisni si dëshmitar jo vetëm kufitarët, por dhe banorë të tjerë të fshatit që t'ju dëshmojnë të gjithë sa unë kam deklaruar. Ju kam sjell vërtetime nga kryepleqtë e fshatit ndër vite. Kam deklaruar çdo vit të ardhurat e realizuara nga këto produkte bujqësore, pemëtari dhe bletari.

Si përfundim dua t'u shpjegoj se fakti që familja jonë ka siguruar këto të ardhura, konfirmohet dhe me të ardhurat në vazhdimësi pas vitit 2015. Në vitin 2016 me regjistrimin e nënës si “Bujk privat” dhe pajisjen e saj me NIPT, të ardhurat e siguruara janë në shumën 1.575.136 lekë. Ndërkohë që numri i bletëve ishte më i ulët se në vitin 2010 (kjo për shkak se në vitin 2010 për nevoja likuidimi të pagesës së banesës kam shitur 25 krerë bletë). Ndërsa në vitin 2017 kam siguruar të ardhura në shumën 1.435.220 lekë; në vitin 2018 të ardhura në shumën 1.515.000 lekë. Ndërkohë që, në vitin 2019 të ardhurat ishin në shumën totale 2.672.800 lekë (16.000 euro + 752.800 lekë). E përmenda këtë fakt se të ardhurat janë në rritje edhe pse moshë e nënës është më e madhe. Bashkëngjitur këtij materiali do të gjeni për ilustrim faturat tatimore të shitjes.

Në këto kushte, Komisioni duhet të mbajë parasysh edhe faktin se subjekti dhe personat e tjerë të lidhur gjenden për arsye të ekzistencës së disa rrethanave që e vendosin subjektin e rivlerësimit

në kushtet e pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: ‘Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme’, për shkak se: i) në kuptim të ligjit nr. 84/2016 nëna dhe bashkëshortja, përfshi edhe vetë subjektin, nuk kishin ndonjë detyrim ligjor të tregoheshin të kujdesshëm deri në nivelin e ruajtjes së dokumentacionit që provon ligjshmërinë e të ardhurave të tyre në atë kohë, përveç se, për sa ata kanë çmuar të nevojshme sipas kujdesit të çdo qytetari normal; (ii) koha e largët në të cilën janë krijuar këto të ardhura e bën të vështirë edhe vetë ruajtjen e dokumentacionit që mund të sillte edhe më tepër informacion në këtë drejtim, edhe për shkak të një logjike normale ligjore që duket se nuk merr përsipër të ruajë apo arkivojë dokumente të kësaj natyre për një periudhë kaq të gjatë kohe, madje as nga vetë institucionet shtetërore.”

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

3.17 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

3.18 Referuar pikës 4, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.”*

3.19 Pretendimi i subjektit se nuk ka pasur ku t’i deklarojë të ardhurat nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria, nuk qëndron pasi nëse i referohemi legjislacionit tatimor ndër vite, por kryesisht nga viti 2003 e në vazhdim, kohë kur subjekti ka pasur dhe detyrimin për të deklaruar sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ku në neni 4 parashikohet se: *“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale.”*

3.20 Nëse i referohemi legjislacionit mbi të ardhurat, ndër vite, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin e deklarimit të të ardhurave personale, si individ, që nga viti 1995, detyrim ky i përcaktuar nga ligji nr. 7786, datë 27.1.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar³¹, i cili përcakton si kategori të tatueshme të ardhurat nga qiratë e banesave, dyqaneve, magazinave, truallit dhe objekteve të tjera, si dhe të gjitha llojet e tjera të të ardhurave personale, cilido qoftë burimi i tyre.

³¹ Neni 2 i ligjit nr. 7897, datë 2.2.1995, për disa ndryshime në ligjin nr. 7786, datë 27.1.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, me ligjin nr. 7823, datë 18.5.1994.

3.21 Në vitin 1998, subjekti i rivlerësimit sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi te ardhurat”, i cili shfuqizoi ligjin nr. 7786, datë 27.1.1994, i ndryshuar, duke qenë se ka siguruar të ardhura të tjera përveç atyre nga paga, sipas ligjit konsiderohet person fizik, jotregtar sipas Kodit Civil dhe sipas nenit 4 të këtij ligji, burime të të ardhurave janë [...] germa “dh” të ardhurat nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme, aksesoret dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat nga të drejta të tjera, që rrjedhin nga pronësia mbi sendet e paluajtshme, në rast së këto sende ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3.22 Në vitin 2003, sipas ligjit nr. 9161, datë 18.12.2003, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, date 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë si të ardhura të tatueshme të ardhurat nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria, referuar këtij ligji, i cili shton në vitin 2003 si të ardhura të tatueshme, të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në nenin 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998³², të realizuara nga individë rezidente ose nga persona jorezidente, por me burim në Republikën e Shqipërisë.

3.23 Më tej në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte çdo të ardhur të përcaktuar në nenin 8 (sipas pikës 4.38 më lart), për të cilat nuk është mbajtur tatim në burim dhe duhet t'i deklaronte këto të ardhura në organin tatimor jo më vonë se 30 janari i vitit pasardhës. Gjithashtu, duke qenë se realizonte të ardhura, subjekti i rivlerësimit pavarësisht nëse këto të ardhura ishin tatuar apo janë ose jo të tatueshme, duhet të paraqiste në organin tatimor përkatës deklaratën tatimore integrale për të ardhurat personale, të realizuara nga çdo burim, jo më vonë se 28 shkurti i vitit pasardhës³³.

3.24 Referuar dispozitave ligjore më lart, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte këto të ardhura personale, që ka siguruar si individ ose person fizik jo tregtar dhe jo sikundër pretendon subjekti se të vetëpunësuarit në bujqësi nuk kanë pasur detyrimin të regjistroheshin si tregtarë dhe as të pajiseshin me leje të posaçme për shitjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale, që buronin nga shfrytëzimi i tokës bujqësore, të përfutur me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”. Mosdeklarimi i këtyre të ardhurave si individ/person fizik jotregtar, ka sjellë mospagimin detyrimeve tatimore për këto të ardhura sipas legjislacionit në fuqi në kohën në të cilën janë krijuar.

3.25 Pretendimi i subjektit, se të ardhurat që ka pasur nga bujqësia, vërtetohen edhe me pagesën kontributeve të sigurimeve shoqërore për periudhën 1993 – 2012, të bashkëshortes si e vetëpunësuar në bujqësi, sipas dokumenteve të depozituara në Komision dhe njëherazi dhe së fundmi³⁴, nuk qëndron, pasi subjekti nuk paraqiti prova për të provuar të ardhura nga bujqësia .

³² Referuar nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

³³ Ligj nr. 9326, datë 6.12.2004, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.199, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar shtohet neni 13 i cili parashikon se: “**Neni 13 Deklarimi** 1. Çdo individ, që realizon të ardhura nga çdo burim, i përcaktuar në nenin 8, për të cilat nuk është mbajtur tatim në burim, në zbatim të dispozitave të tjera të këtij ligji, duhet t'i deklarojë këto të ardhura në organin tatimor jo më vonë se 30 janari i vitit pasardhës. 2. Tatimpaguesi, sipas pikës 1 të këtij neni, bën pagesën e detyrimit në bankë me dokumentin e pagesës së lëshuar nga organi tatimor. 3. Në përputhje me fazat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni, çdo individ, që realizon të ardhura, pavarësisht nëse këto të ardhura janë tatuar apo janë ose jo të tatueshme, duhet të paraqesë në organin tatimor përkatës deklaratën tatimore integrale për të ardhurat personale, të realizuara nga çdo burim, jo më vonë se 28 shkurti i vitit pasardhës. Modeli i deklaratës integrale të të ardhurave personale do të përcaktohet në një udhëzim të posaçëm të ministrit të Financave.

³⁴ Shkresë kthim-përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.6.2020, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë; shkresës kthim-përgjigjeje nr. **** prot., datë 3.7.2020, të ISSH-së Tiranë (Drejtoria e e Kontributeve); vërtetim nr. *** prot., datë 20.11.2019, vërtetimet datës 26.2.2020 dhe 30.6.2020 të Njesisë Administrative M, Bashkia Kolonjë.

Për më tepër kontributet për sigurimet shoqërore të paguara për efekt pensioni, nuk janë provë që tregojnë se personi ka punuar në bujqësi, por janë për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë³⁵, që në mënyrë vullnetare mund të paguheshin në çdo kohë nga individët që ishin të interesuar të merrnin pension pleqërie kur nuk plotësonin vitet e punës.³⁶

3.26 Në lidhje me deklaratimet e të ardhurave nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria në deklaratimet periodike vjetore në ILDKPKI, Komisioni vlerëson se fakti që këto të ardhura janë deklaruar në DPV-të nuk vërteton nëse këto të ardhura janë të ligjshme apo jo. Përcaktues për burimin dhe legjitimitetin e të ardhurave është analizimi i burimit të krijimit dhe legjitimiteti i tyre që vërtetohet me dokumentacion justifikues për deklarin pranë organeve tatimore përkatëse dhe më tej me dokumentacion justifikues për pagimin e detyrimeve tatimore, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

3.27 Në lidhje me burimin e krijimit, subjekti i rivlerësimit nuk vërtetoi që toka bujqësore apo pemëtore mbi të cilën kishte të mbjella apo pemë, të ishte e tij, por e të gjithë anëtarëve të familjes bujqësore sipas bashkëpronësisë në tërësi të familjes bujqësore (Kodi Civil neni 207 e në vijim).

3.28 Mungesa e dokumentacionit justifikues për vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit se kujt i përket kjo tokë bujqësore, bën që Komisioni mos të pranojë pretendimet e subjektit të rivlerësimit që të gjitha të ardhurat e krijuara nga kjo pronë, të jenë të subjektit të rivlerësimit, duke pasur parasysh këtu dhe faktin se subjekti i rivlerësimit nuk provojë se këto të ardhura ishin të ligjshme.

3.29 Gjithashtu, në lidhje me legjitimitetin e të ardhurave të krijuara nga frytet e kësaj pasurie tokë, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion për të vërtetuar se këto të ardhura personale të tij ishin deklaruar pranë organeve tatimore dhe nëse ishin paguar detyrimet respektive tatimore mbi të ardhurat personale të krijuara nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria.

3.30 Për më tepër, mandatarkëtimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat e siguruar nga bujqësia dhe bletaria për vitet 2010 – 2015, nuk janë provë e plotë për të vërtetuar këto të ardhura dhe, për më tej, është dokumentacioni i mbajtur nga nëna e subjektit të rivlerësimit, i cili nuk vetëton se këto të ardhura janë arkëtuar prej saj.

3.31 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar një kujdes të veçantë në lidhje me deklarin pranë organeve tatimore apo dokumentimin e të ardhurave personale sipas ligjit, për të vërtetuar se ato nuk vijnë nga veprimtari të paligjshme, duke pasur parasysh faktin se ka qenë subjekt i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ku qëllimin e tij është përcaktimi i rregullave për deklarin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publike, për familjaret e tyre dhe për personat e lidhur me ta.

3.32 Gjithashtu, para se të hynte në fuqi ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, ka qenë në zbatim ligji nr. 7903, datë 8.3.1995, “Për deklarin e pasurive të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik”, në bazë të të cilit subjekti në pozicionin e gjyqtarit brenda tri muajve nga shpallja e ligji (shpallur më 20.3.1995), duhet të paraqiste për vete dhe për familjen e tij, dëshmi zyrtare të të ardhurave që i janë nënshtruar tatimit mbi të ardhurat personale të vitit të

³⁵ Referojuni ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

fundit, që prej hyrjes në fuqi të ligjit. Pra, ligji që në vitin 1995 ka parashikuar se subjekti duhet të paraqiste dëshmi zyrtare për të ardhurat që i janë nënshtruar tatimit mbi të ardhurat me qëllim që të kontrollohej ligjshmëria e tyre.

3.33 Referuar analizës më lart, subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të të ardhurave, duke mos vërtetuar tokën në pronësi/përdorim, si dhe nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues pagimin e tatimit mbi të ardhurat e krijuara nga aksesoret dhe frytet e tokës bujqësore, pemëtarisë dhe bletarisë.

3.34 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këto të ardhura për periudhën 1993 – 2015, në shumën 13.500.000 lekë duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 3 e nenit D të Aneksit të kushtetutës dhe neni 33, pika 5, gërma “b” e ligjit nr. 84/2016.

4. Apartament me sip. 106.44 m², ndodhur në adresën: Rr. “I.T”, Tiranë

4.1 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka në pronësi një shtëpi banimi (apartament³⁷) me sipërfaqe funksionale 97.7 m², me sipërfaqe të përbashkët 104.44 m², ndodhur në adresën: Rr. “I. T”, Tiranë. Vlera e apartamentit në shumën 88.300 euro, në bashkëpronësi me familjen.

4.2 Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar të ardhurat e siguruara gjatë viteve 1994 – 2010 nga puna, ferma bujqësore dhe bletaria në vlerën 85.000 euro (11.756.500 lekë) dhe 3.300 euro (464.000 lekë) me të ardhurat e vitit 2014.

4.3 Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar se është bërë kalimi i pronësisë së banesës, prenotuar me kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. **** kol., datë 8.2.2010, në emër të shtetasve Hysen dhe F. S. Në DPV-në e vitit 2010, kur është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes nr. **** rep., nr. **** kol., datë 8.2.2010, subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi për këtë pasuri. Mënyra e fitimit: me kontratën e shitblerjes nr. **** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2015.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

4.4 ZVRPP-ja Tiranë³⁸, konfirmon se në emër të shtetasve Hysen dhe F. S është e regjistruar pasuria nr. ****, apartament me sip. 97.70 m², ndodhur në z. k. ****, në bashkëpronësi, blerë me kontratën e shitjes me vlerë 88.300 euro, bashkëngjitur kontratë shitjeje dhe kopje e kartelës së pasurisë.

³⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (Aneks nr. 4/4)

- Vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ** datë 8.1.2016, ku figuron i regjistruar apartamenti i banimit nr. *, me sip. 97.7 m², në katin e tretë të godinës me * kate, në Rr. “I.T”, shkalla *, në pronësi të shtetasve Hysen Saliko dhe F. S me nr. pasurie ****, si edhe harta treguese.
- Kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 28.12.2015, me palë shitëse shoqërinë “G&P” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasit Hysen dhe F. S Për blerjen e apartamentit me sip. 97.7 m², nr. pasurie ***, në shumën 88.300 euro. Kopje kartashi ID.
- Kontratë sipërmarrje datë 8.2.2010, me palë sipërmarrëse shoqërinë “G&P” sh.p.k. dhe palë porositëse shtetasin Hysen Saliko, për një ambient shërbimi me sip. 106.44 m², i ndodhur në katin e tretë të ndërtimit AP: **, shkalla *, me vlerë 88.300 euro dhe planimetri e apartamentit të banimit.

³⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2019.

4.5 OSHEE-ja³⁹, informon se në emër të z. Hysen Saliko rezulton një kontratë e regjistruar në instancën e Tiranës, me adresë: Rr. “I. T”, me datë hapje 15.3.2011. Konsumi me energji elektrike rezulton që të ketë filluar të faturohet në emër të shtetasit Hysen Salikos në prill të vitit 2011.

4.6 Në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar prenotim shtëpi banimi, ndodhur në Rr. “I. T”, me sip. 106.44 m², sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.2.2010. Në DPV-në e vitit 2010, subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi për këtë pasuri.

4.7 Në datën 8.2.2010, subjekti nënshkruan një kontratë sipërmarrje me nr. *** rep., nr. ***kol., me shoqërinë “G&P” sh.p.k., për blerjen e pasurisë, apartament me sip 106.44 m². Në kontratën e sipërmarrjes, në nenin 3, çmimi i kontratës dhe mënyra e pagesës, është parashikuar se: *“Palët bien dakord që çmimi i ambientit të shërbimit objekt kontrate, të jetë 88.300 euro. Porositësi do paguajë: vlerën 50.000 euro, me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes; vlerën 20.000 euro, brenda datës 31.3.2010; dhe vlerën 18.300 euro, në datën 31.5.2010, me marrjen e çelësave”*.

4.8 Në kontratën e sipërmarrjes rezulton se pagesa për apartamentin është shlyer e plotë deri në datën 31.5.2010. Në kontratën e shitblerjes me nr. **** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2015, është parashikuar se: *“Apartamenti është shitur kundrejt shumës 88.300 euro likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. **** kol., datë 8.2.2010”*.

4.9 Subjekti ka deklaruar në këtë DPV shumën prej 85.000 euro e ka likuiduar deri më 31.12.2010.

4.10 Në DPV-në e vitit 2010 në rubrikën për detyrimet financiare ndaj personave juridik, subjekti ka deklaruar si të mbetur pa shlyer shumën prej 3.300 euro, kështu i cili do paguhet në momentin e kalimit të pronësisë.

4.11 Në DPV-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar se ka shlyer detyrimin prej 3.300 euro ndaj shoqërisë “G&P” sh.p.k., nga e cila shuma 400.000 lekë (2.840 euro) shlyer nga kursimet në vite dhe shuma 64.400 lekë (460 euro) nga kursimet e vitit 2014.

4.12 Ndërkohë që gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar⁴⁰ se: *“Ashtu sikundër ka deklaruar edhe në deklaratën e vetëdeklarimit, në datën 8.2.2010 ka lidhur kontratën e porosisë (sipërmarrjen) për banesën që tashmë e ka në pronësi me sipërfaqe banimi 97,7 m² (me sipërfaqe të përgjithshme së bashku me ambientet e shërbimit 106,44 m²), kundrejt vlerës 88.300 euro. Pagesa është kryer me disa këste, vërtetuar me mandatpagesa për çdo pagesë të kryer, me burim nga kursimet në vite, sa më poshtë vijon:*

- kësti i parë prej 50.000 Euro është paguar në datën e lidhjes së kontratës, datë 8.2.2010;
- në datën 22.3.2010 kam bërë pagesën e një kësti në shumën 7.000 euro;
- në datën 30.3.2010 kam bërë pagesën e një kësti në shumën 10.000 euro;
- në datën 5.4.2010 kam bërë pagesën e një kësti në shumën 3.000 euro;
- në datën 17.5.2010 kam bërë pagesën e një kësti në shumën 5.000 euro, vërtetuar kjo me mandatpagesën e kësaj date. Ky këst është shlyer nga një hua që i ka marrë mikut të tij (dhe kumbarit të nipit) Xh. Xh në datën 17.5.2010 dhe që ia ka kthyer në datën 16.11.2010 (shlyerja e huas është bërë nga të ardhurat e vitit 2010).

³⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2019.

⁴⁰ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 19.11.2019.

- në datën 28.5.2010 ka bërë pagesën e një kësti në shumën 4.000 euro, vërtetuar kjo me mandatpagesën e kësaj date. Ky këst është shlyer nga shitja e bletëve në prill të vitit 2010 (450.000 lekë) dhe diferenca nga kursimet ndër vite;
- në datën 2.7.2010 ka bërë pagesën e një kësti në shumën 3.000 euro;
- në datën 9.7.2010 ka bërë pagesën e një kësti në shumën 3.000 euro;
- kësti i fundit në shumën 3.300 euro është paguar në datën 28.12.2014.”

4.13 Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të deklarimeve të tij gjatë hetimit, ka depozituar mandatarkëtimet për pagesat e deklaruara të kryera me përshkrimin “*likuidim kësti për blerje apartamenti*”.

Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria nga viti 1993 – 2010

4.14 Subjekti i rivlerësimit ka provuar që bashkëshortja është e siguar si e vetëpunësuar në bujqësi, me vërtetimin (për të vetëpunësuar në bujqësi) nr. *** prot., datë 7.10.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, Agjencia Kolonjë, sipas të cilës vërtetohet se shtetasja L.Xh. S ish-banore e komunës M, figuron si e vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 1993, në regjistrin themeltar të të vetëpunësuarve në bujqësi me nr. ****, dhe se ka paguar rregullisht kontributet për periudhën 1993 – 2012.

4.15 Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor shoqërues në lidhje me të ardhurat *neto* të përfituar nga bujqësia dhe blegtoria gjatë viteve 1994 – 2010, por nga viti 2003 deri në vitin 2010 ka deklaruar në DPV-të vjetore si shumë të përfituar 6.250.000 lekë.

4.16 Komisioni, pasi kreu analizën financiare për vitet 1993 – 2010, duke marrë në konsideratë pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur dhe referuar kësaj analize, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, për vitet 1993 – 2002, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009 dhe 2010, në shumën totale prej 10.191.152 lekësh.

Në lidhje me arkëtimin në Bankën Kombëtare Tregtare të shumës prej 30.000 euro për llogari të shoqërisë “G&B” sh.p.k

4.17 Më tej, në lidhje me pagesat për këtë apartament, nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, ILDKPKI-ja ka administruar shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2017, e cila konfirmon se ka raportime për një transaksion bankar të kryer nga subjekti i rivlerësimit në datë 8.2.2010, në Bankën Kombëtare Tregtare me vlerë 30.000 euro, me përshkrimin: “*Hysen Saliko pagesë kësti blerje apartamenti. Burimi i të ardhurave , kursime të ndryshme.*”

4.18 Ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në datën 8.2.2010, të njëjtën datë me transaksionin e mësipërm, ka paguar *cash* pranë arkës së shoqërisë këstin e parë prej 50.000 euro, dhe nuk ka deklaruar se ka kryer dhe një pagesë me bankë prej 30.000 euro, siç dhe rezulton nga shkresa e DPPP-së.

4.19 Lidhur me këtë informacion subjektit iu kërkuan shpjegime, ku në përgjigje ka mohuar të ketë kryer këtë veprim bankar, duke shpjeguar se: “*Është lehtësisht e dukshme që nuk është firma ime në këtë transaksion. Nëse do ta kisha kryer me bankë këtë pagesë nuk kisha pse të mos e deklaroj*”.

4.20 Komisioni, më tej i kërkoi informacion Bankës Kombëtare Tregtare mbi këtë transaksion bankar. BKT-ja⁴¹ ka informuar se bazuar në të dhënat e sistemit kompjuterik rezulton një pagesë e kryer më 8.2.2010 me nr. reference ***TDCF****, në vlerën 30.000 euro me përfitues subjektin “G&P” sh.p.k., me NIPTI K****O dhe nr. llogarie ****. Banka referon se ky veprim është kryer nga shtetasi Hysen T.S, i datëlindjes 5.2.1959. BKT-ja i ka bashkëlidhur përgjigjes, transaksionin bankar “mandatarkëtim” i shumës 30.000 euro, ku përshkruhet veprimi i kryer, shuma dhe emri i personit që kryen veprimin, Hysen T. S me nr. ID Z****. Sipas mandatarkëtimin, subjekti ka deklaruar se burimi i të ardhurave janë kursime të ndryshme. Bashkëlidhur mandatarkëtimin është kopja e pasaportës së subjektit të rivlerësimit.

4.21 Shoqëria “G&P” sh.p.k.⁴², ka informuar se të gjitha pagesat e kryera nga z. Hysen Saliko, në lidhje me blerjen e pasurisë së sipërpërmendur janë kryer nëpërmjet pagesës *cash* sipas mandatarkëtimeve, ku kopje të të cilave janë dorëzuar edhe pranë zyrës noteriale ku është përpiluar kontrata e shitblerjes.

4.22 Komisioni i ka kërkuar subjektin të japë shpjegime dhe të dokumentojë në lidhje me këtë transaksion bankar⁴³ dhe në përgjigje subjekti ka mohuar kryerjen prej tij të pagesës prej 30.000 euro në BKT.

4.23 Subjekti pretendon se pagesa në emër të tij në bankë është derdhur nga një punonjës i shoqërisë “G&P” sh.p.k., mbështetur ky pretendim në deklaratën noteriale me nr. *** rep., nr, *** kol., datë 9.3.2020, ku përfaqësuesi ligjor i shoqërisë pohon në mënyrë të qartë mënyrën e pagesës me bankë. Subjekti ka argumentuar se nuk ka kuptim që nëse do të ishte kryer prej tij, pse do ta fshihte pagesën e bërë me bankë, ku sipas parashikimeve në kontratë në datën 8.2.2010, duhet të paguheshin 50.000 euro, pra, mund të kishte shtuar vetëm shumën prej 20.000 euro, të diferencës. Gjithashtu, subjekti pretendon se në vitin 2010 nuk mund të blinte një apartament afër pallatit me shigjeta me një çmim edhe 30.000 euro më të shtrenjtë, sepse ky çmim do ishte i ekzagjeruar për zonën, si dhe punimet e këtij pallati nuk e justifikojnë këtë çmim.

4.24 Subjekti ka depozituar në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 22.4.2020, kallëzim penal ndaj shoqërisë “G&P” sh.p.k., dhe Bankës Kombëtare Tregtare sepse pretendon që me veprimet e tyre të paligjshme i kanë shkaktuar një dëm të madh duke “falsifikuar” nënshkrimin e tij dhe duke pasqyruar të dhëna të pavërteta.

4.25 Gjithashtu, për të mbështetur pretendimet e tij subjekti ka depozituar dhe një “aktekspertim grafik”, me nr. ***, datë 21.4.2020, hartuar nga një ekspert kriminalistik i licencuar. Subjekti i ka kërkuar ekspertit të bëjë verifikimin e nënshkrimeve të tij tek: *A. “formular mandatarkëtim” plotësuar me dorë, datë 8.2.210, në BKT dega b; B. dokumenti i dytë është një dokument përgatitur në kompjuter nga banka, format A5, në të cilën përshkruhet trasaksioni bankar, shuma e arkëtuar, i cili përmban me shkrim dore emrin mbiemrin dhe nënshkrimin e z. Hysen Saliko.*

4.26 Në bazë të kërkesave caktuar nga subjekti, eksperti pas ekzaminimit grafik ka arritur në përfundimin se: firmat në emër të shtetasit Hysen Saliko, në dokumentin bankar ku është bërë pagesa prej 30.000 euro, janë pa asnjë dyshim, produkte të imitimeve dhe sajimeve grafike; të

⁴¹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.3.2020.

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 24.2.2020.

⁴³ E-mail i datës 8.5.2020, në lidhje me pyetësin e Komisionit të datës 5.3.2020.

gjitha plotësimet me shkrim dore në dokumentin e shqyrtuara janë shkruar nga personi që ka plotësuar me shkrim dore 2 mandatarkëtimet me vulat e shoqërisë “G&P” sh.p.k., pikërisht me nr. ***, për shumën 7.000 euro dhe nr. ***, për shumën 10.000 euro, të cilat eksperti i kishte në ekzaminim me cilësinë e modeleve të krahasimit.

4.27 Më tej, subjekti me shpjegimet e datës 13.5.2020, ka depozituar vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 8.5.2020, sipas të cilës ky institucion ka vendosur “mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin e depozituar nga subjekti për BKT-në dhe shoqërinë “G&P” sh.p.k., me pretendimin se vepra penale e pretenduar nga kallëzuesi është parashkruar. Subjekti për këtë vendim ka depozituar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhoma penale.

4.28 Shuma prej 30.000 euro, është përfshirë në analizën financiare të vitit 2010, në zërin e shpenzimeve, duke qenë se është vërtetuar transaksioni bankar nga subjekti i rivlerësimit të shoqëria “G&P” sh.p.k.

4.29 Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, lidhur me:

- i. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor shoqërues në lidhje me të ardhurat *neto* të përfituar nga bujqësia dhe blegtoria gjatë viteve 1993 – 2010, referuar analizës financiare për periudhën 1993 – 2010, duket se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, për vitet 1993-2002, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009 dhe 2010, në shumën totale prej 10.191.152 lekë.
- ii. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të viti 2017 dhe në DPV-në e vitit 2010 pagesën prej 30.000 euro kryer me anë të transfertës bankare në datën 8.2.2010 firmës së ndërtimit “G&P” sh.p.k., me përshkrim pagesë kësti apartamenti.

4.30 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se:

Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria, subjekti deklaroi se:

4.31 Komisioni ndonëse pranon faktin se: subjekti i rivlerësimit ka provuar që bashkëshortja është e siguar si e vetëpunësuar në bujqësi, me vërtetimin (për të vetëpunësuar në bujqësi) nr. *** prot., datë 7.10.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, Agjencia Kolonjë, sipas të cilës vërtetohet se L.Xh.S ish-banore e komunës Mollas, figuron si e vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 1993, në regjistrin themeltar të të vetëpunësuarve në bujqësi me nr.****; ka paguar rregullisht kontributet për periudhën 1993 – 2012; në përfundim nuk i njeh në tërësi të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite. Gjatë të gjithë kësaj periudhe familja e subjektit ka siguruar të ardhura të ligjshme nga 29 dynym tokë bujqësore, nga mbarështimi i një parku me bletë, si dhe nga shitja e prodhimit të pemëtarisë së përbërë nga rreth 400 rrënjë mollë. Të ardhurat janë përshkruar në mënyrë të detajuar nga subjekti dhe të konfirmuara edhe nga deklaratat e kryepleqve të fshatit, prej aktit të ekspertimit, prej përgjigjes së kthyer Komisionit prej Kryetarit të Shoqatës së Bletërritësve të Shqipërisë, si dhe të gjithë dokumentacionin provues ka vënë në dispozicion bashkëngjitur këtij materiali.

4.32 Në rast se për këtë periudhë nuk njihen të ardhurat nga ferma bujqësore, atëherë duhet të përlllogaritet paga që do të përfitonte bashkëshortja nga një sigurim minimal⁴⁴, e cila sipas pagesë minimale në vend për këtë përdhë 10-vjeçare paga e saj do të ishte në shumën 626.616 lekë.

Në lidhje me arkëtimin në “Bankën Kombëtare Tregtare” të shumës prej 30.000 euro për llogari të shoqërisë “G&B” sh.p.k., subjekti deklaron se:

“[...] Mohoj kategorikisht dhe deklaroj me përgjegjësinë time të plotë se kjo pagesë nuk është bërë prej meje. Sikundër ka argumentuar edhe Komisioni, lidhur me këtë informacion më është kërkuar që të jap shpjegime dhe në përgjigjen e dhënë e kam mohuar të ketë kryer këtë veprim bankar, duke shpjeguar se është lehtësisht e dukshme që nuk është firma ime në këtë transaksion. Nëse do ta kisha kryer me bankë këtë pagesë nuk kisha pse të mos e deklaroja”.

4.33 Subjekti, për të provuar se kjo pagesë nuk është bërë prej tij, ka paraqitur si provë në Komision edhe deklaratën noteriale të lëshuar nga administrator i shoqërisë dhe njëherazi edhe vërtetimin e lëshuar nga shoqëria, por që nuk janë marrë parasysh nga Komisioni. Gjithashtu, shoqëria “G&P” sh.p.k.⁴⁵, ka informuar Komisionin se të gjitha pagesat e kryera nga z. Hysen Saliko, në lidhje me blerjen e pasurisë së sipërpërmendur janë kryer nëpërmjet pagesës *cash* sipas mandatarkëtimeve, ku kopje të tyre janë dorëzuar edhe pranë zyrës noteriale, ku është përpiluar kontrata e shitblerjes.

4.34 Pavarësisht shkresës së lëshuar nga shoqëria “G&P” sh.p.k. dhe deklaratës noteriale⁴⁶ të lëshuar nga administratori, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime dhe të dokumentojë, në lidhje me këtë transaksion bankar dhe në përgjigje subjekti ka mohuar kryerjen prej tij të pagesës prej 30.000 euro, në BKT.

4.35 Subjekti, sikundër ka sqaruar edhe në përgjigjen drejtuar Komisionit, pagesa është derdhur në emër të tij në bankë, nga një punonjës i shoqërisë “G&P” sh.p.k. Këtë pretendim e ka provuar edhe me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. **** kol., datë 9.3.2020, deklaratë ku përfaqësuesi ligjor i shoqërisë pohon në mënyrë të qartë mënyrën e pagesës me bankë. Nuk ka kuptim nëse do të ishte kryer nga subjekti kjo pagesë, pse duhet të fshihej pagesa e bërë nëpërmjet rrugës bankare, sipas parashikimeve në kontratë në datën 8.2.2010 duhet të paguheshin 50.000 euro, pra, mund të kishte shtuar vetëm shumën prej 20.000 euro, të diferencës. Gjithashtu, në përgjigjet e tij subjekti ka sqaruar se në vitin 2010, nuk mund të blinte një apartament në një zonë periferike të Tiranës me një çmim 118.300 euro me sipërfaqe funksionale rreth 97 m², pra, 30.000 euro më të shtrenjtë nga sa është përcaktuar në kontratë, pasi një çmim i tillë jo vetëm që do të ish i ekzagjeruar për zonën, por edhe punimet dhe për më tepër vendndodhja e apartamentit nuk e justifikojn këtë çmim.

4.36 Dhe së fundi, punonjësi i shoqërisë “G&P” sh.p.k., z. B. K me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol.,⁴⁷ datë 13.7.2020, provon faktin se kjo pagesë në emër të subjektit është kryer nga punonjës i shoqërisë (B. K).

⁴⁴Për më tepër shihni shkresën kthim-përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.7.2020, të ISSh-së.

⁴⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2020.

⁴⁶Për më tepër shihni deklaratën noteriale nr. ****, datë 9.3.2020.

⁴⁷Për më tepër shihni deklaratën noteriale me nr. ****/, datë 13.7.2020.

4.37 Subjekti në vazhdim nënvizon faktin se vlera e pronës është 88.300 euro dhe kaq duhet të jetë edhe shpenzimi i llogaritur, ku kjo shumë është paguar 85.000 euro në vitin 2010 dhe 3.300 euro në vitin 2014.

4.38 Fakti që kjo vlerë është ajo e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes dhe atë të shitjes, provohet edhe me çmimin e shitjeve të apartamenteve simotra në pallatin ku subjekti ka blerë apartamentin. Në disa kontrata të fqinjëve duket qartë që çmimi i përcaktuar në këto kontrata është afërsisht sa gjysma e çmimit të paguar nga subjekti. Bashkëngjitur dokumentacioni: (1) me kontratën e shitjes së pasurisë⁴⁸ nr. ***, datë 5.11.2013, të lidhur para Noteres M. R. Sh midis palës blerëse S dhe A. Q dhe palës shitëse shoqëria “G&P” sh.p.k. provohet se për një sipërfaqe prej 118,5 m² vlera e blerjes është 55.103 euro (465 euro/m²); (2) me kontratën e shitjes së pasurisë⁴⁹ nr. ***, datë 11.11.2011, të lidhur para Noteres M. R. Sh midis palës blerëses D.L dhe palës shitëse provohet se për një sipërfaqe prej 57 m² vlera e blerjes është 24.366 euro (427,5 euro/m²); (3) me kontratën e shitjes së pasurisë⁵⁰ nr. ****, datë 24.11.2011, të lidhur para Noteres M. R. Sh midis palës blerësit Sh. K dhe palës shitëse shoqëria “G&P” sh.p.k. provohet se për një sipërfaqe prej 118,5 m² vlera e blerjes është 55.103 euro (465 euro/m²); (4) me kontratën e shitjes së pasurisë⁵¹ nr. ****, datë 20.1.2011, të lidhur para Noteres M. R. Sh midis palës blerësit S. Z dhe palës shitëse shoqëria “G&P” sh.p.k. provohet se për një sipërfaqe prej 96.6 m² vlera e blerjes është 77.280 euro (776 euro/m²); (5) me kontratën e shitjes së pasurisë⁵² nr. ***, datë 14.12.2010, të lidhur para Noteres M. R. Sh midis palës blerësit E. I dhe palës shitëse shoqëria “G&P” sh.p.k. provohet se për një sipërfaqe prej 96,6 m² vlera e blerjes është 40.455 euro (418,8 euro/m²); (6) me kontratën e shitjes së pasurisë⁵³ nr. ****, datë 7.2.2010, të lidhur para Noteres M. R. Sh midis palës blerësit V.A dhe palës shitëse shoqëria “G&P” sh.p.k. provohet se për një sipërfaqe prej 134 m² vlera e blerjes është 56.500 euro (421,6 euro/m²); (7) me kontratën e shitjes së pasurisë⁵⁴ me kusht nr. ****, datë 19.2.2012, të lidhur para Noteres M. R. Sh midis palës blerësit K.M dhe palës shitëse shoqëria “G&P” sh.p.k. provohet se për një sipërfaqe prej 115 m² vlera e blerjes është 78.000 euro (678,2 euro/m²). *Në këtë kontratë ku çmimi është më i lartë se çmimet e kontratave më sipër ka ardhur se banesa është shitur dy vjet më vonë dhe ka pasur rritje të çmimit, por dhe të pranimit prej shitësit që blerësi do të paguante 43.000 euro pas 8 muajsh.*

4.39 Pra, sikurse rezulton edhe nga këto shtatë kontrata të paraqitura si provë në asnjë rast nuk kemi një çmim të paktën të barabartë me çmimin e apartamentit që ka blerë subjekti.

4.40 Rezulton se vlera (çmimi) e/i blerjes së apartamentit nga subjekti është 88.300 euro. Sipërfaqja e kësaj prone është 106,44. Çmimi: 830 euro/m². Ndërkohë që nëse do të pranonim se nga subjekti përveç shumës prej 88.300 (85.000+3.300) euro është paguar edhe shuma e derdhur në BKT prej 30.000 euro do të bënte që vlera e apartamentit do të jetë 118.300 euro, ndërsa çmimi sipas kësaj vlere do të rezultonte me 1.227 euro/ m².

⁴⁸Për më tepër shihni kontratën e shitjes nr. ***, datë 5.11.2013, fotokopje bashkëngjitur këtij materiali.

⁴⁹Për më tepër shihni kontratën e shitjes nr. ***, datë 11.11.2011, fotokopje bashkëngjitur këtij materiali.

⁵⁰Për më tepër shihni kontratën e shitjes nr. ****, datë 24.11.2011, fotokopje bashkëngjitur këtij materiali.

⁵¹Për më tepër shihni kontratën e shitjes nr. ***, datë 20.1.2011, fotokopje bashkëngjitur këtij materiali.

⁵²Për më tepër shihni kontratën e shitjes nr. ****, datë 14.12.2010, fotokopje bashkëngjitur këtij materiali.

⁵³Për më tepër shihni kontratën e shitjes nr. ****, datë 7.2.2010, fotokopje bashkëngjitur këtij materiali.

⁵⁴Për më tepër shihni kontratën e shitjes nr. ****, datë 19.2.2012, fotokopje bashkëngjitur këtij materiali.

4.41 Të pranosh se subjekti ka blerë një apartament me çmim 1.227 euro/ m², ndërkohë që në 7 (shtatë) kontratat e mësipërme të paraqitur si provë prej subjektit çmimi mesatar është 506,8 euro/ m² (7 apartamente me sipërfaqe të përgjithshme 736,2 m² dhe me vlerë totale 386.807 euro (386.807: 736,2), është një absurditet.

4.42 Subjekti shprehet se do të pranonte me kënaqësi që Komisioni të ngrinte dyshime rreth vërtetësisë së çmimit të paguar prej tij, në rast se do të kishte lidhur kontratë me çmim preferencial (sikundër ka pasur Komisioni në shumë vendimmarrje të saj kur ka pranuar si çmim atë të shënuar në kontratë), por jo në rastin e subjektit që jo vetëm nuk e ka përfituar pronën me çmim të tillë, por përkundrazi me një çmim më shumë se dyfishi i kontratave të tjera të lidhura në këtë pallat për komshinjtë e mi. Në të tilla kushte, subjekti nuk kishte përse të fshihte një veprim që lë gjurmë.

4.43 Sipas arsytimit të Komisionit, rezulton që subjekti të ketë blerë një apartament 2,5 herë më shtrenjtë se ajo që kanë blerë fqinjët (1.227:506,8=2,42), nga 7 kontratat e mësipërme, 4 janë në të njëjtën shkallë me subjektin.

4.44 Në analizë të rrethanave të mësipërme në referim edhe të nenit 690 të Kodit Civil⁵⁵, Komisioni duhet që të paraqesë në analizën financiare si vlerë blerjeje të pronës së subjektit vlerën 88.300 euro. Për rrjedhojë, për vitin 2010 si vlerë e paguar nga subjekti duhet që pasqyrohet ajo që në fakt është paguar prej tij, konkretisht vlera 85.000 euro.

4.45 Si konkluzion shuma prej 30.000 euro, nuk duhet të përfshihet në analizën financiare të vitit 2010, në zërin e shpenzimeve, për shkak se ky transaksioni bankar nuk është kryer nga subjekti i rivlerësimit të shoqëria “G&P” sh.p.k., por nga kjo e fundit për llogari të vet.

4.46 Gjithashtu, subjekti ka kërkuar kryerjen e një “aktekspertimi grafik”. Aktekspertimi nr.***, datë 21.04.2020⁵⁶, i hartuar nga një ekspert kriminalistik i licencuar është i depozituar në Komisionit. Në këtë akt provohet që subjekti i ka kërkuar ekspertit të bëjë verifikimin e nënshkrimeve të tij tek A. “Formular mandatarkëtimi” plotësuar me dorë, datë 8.2.2010, në BKT dega b. B. dokumenti i detyrë është një dokument përgatitur në kompjuter nga banka, format A5, në të cilën përshkruhet transaksioni bankar, shuma e arkëtuar, i cili përmban me shkrim dore emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e z. Hysen Saliko.

4.47 Nëpërmjet këtij aktekspertimi provohet në mënyrë të qartë ajo që subjekti ka sqaruar në përgjigjen e dhënë për këtë pyetje, pra, arkëtimi në BKT i shumës 30.000 euro nuk është bërë prej tij. Subjekti nuk ka qenë për asnjë moment në BKT dhe jo më të ketë bërë arkëtim. Po kështu, aktekspertimi provon edhe pohimin e bërë nga administratori i shoqërisë “G&P” sh.p.k., Komuna D, se ka qenë punonjësi i kësaj shoqërie, i cili ka bërë arkëtimin e shumës 30.000 euro në BKT, dhe më saktësisht ka qenë punonjësi që është paraqitur në BKT ai që ka bërë arkëtimin në llogarinë e shoqërisë dhe që ka përpiluar edhe mandatet objekt ekspertimi, si dhe shënimin në kopje të pasaportës bashkëngjitur. Për këtë arsye u kërkua që në bazë të neneve 49 dhe 52 të ligjit nr. 86/2016 të thirret në cilësinë e dëshmitarit administratori i shoqërisë që ka lëshuar edhe deklaratën noteriale edhe vërtetimin me anë të së cilit pranon se pagesat nga subjekti janë bërë në arkën e Shoqërisë dhe me para në dorë, *cash*.

⁵⁵Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara në ligj.

⁵⁶Për më tepër shihni aktekspertimin nr. ***, datë 21.4.2020, hartuar nga një ekspert kriminalistik i licencuar.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

4.48 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

4.49 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë burimet e krijimit që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti në deklaratën *Vetting*, për shkak se: (i) në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti deklaroi se si burim për blerjen e këtij apartamenti kanë shërbyer të ardhurat e siguruara gjatë viteve 1994 – 2010 nga puna, ferma bujqësore dhe bletaria në vlerën 85.000 euro; (ii) ndërsa në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti deklaroi se ka pakësuar gjendjen e parave *cash* e grumbulluar gjatë viteve, deri në 31.12.2010, për të bërë pagesën e banesës së pronotuar (85 000 euro x 138,311 = 11,756.500 lekë, këmbyer në datën 5.2.2010; (iii) ndërkohë që gjatë hetimit administrativ, ka ndryshuar deklarin në lidhje me burimin, pra, ka shtuar një burim të ri, duke shpjeguar se pagesat për këtë apartament nuk janë kryer sipas kontratës së sipërmarrjes, ku ndër të tjera ka deklaruar se : *[...] në datën 17.5.2010 kam bërë pagesën e një kësti në shumën 5.000 euro, vërtetuar kjo me mandatpagesën e kësaj date. Ky këst është shlyer nga një hua që i ka marrë mikut të tij (dhe kumbarit të nipit) Xh. Xh në datën 17.5.2010 dhe që ia ka kthyer në datën 16.11.2010 (shlyerja e huas është bërë nga të ardhurat e vitit 2010)[...]*.

4.50 Referuar deklaratës *Vetting* të vitit 2017 dhe DPV-së të vitit 2010, rezulton se subjekti me deklarinimin e tij ka konfirmuar se pagesa prej 85.000 euro është kryer në datën 8.2.2010, në momentin e nënshkrimit të kontratës, nga të ardhurat e krijuara nga bujqësia, bletaria dhe kursimet nga paga në shumën 85.000 euro, duke u bazuar dhe në deklarinimin e subjektit në DPV-në e vitit 2010, i cili deklaroi se shuma 85.000 euro është këmbyer në lekë në datën 5.2.2010. Pra, sipas këtij deklarimi, subjekti e kishte të disponueshme shumën prej 85.000 euro në datën 5.2.2010.

4.51 Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime kontradiktore në lidhje me mënyrën dhe kohën e pagesës së shumës 85.000 euro në vitin 2010, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 33, pika 5, gërma “a” e ligjit nr. 84/2016.

4.52 Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria, për vitet 1993 – 2010, në shumën 10.191.152 lekë, po t'i referohemi analizës së të ardhurave në pikën 3 nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për këtë periudhë në shumën 10.191.152 lekë, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 3 e nenit D të Aneksit të kushtetutës dhe neni 33, pika 5, gërma “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me arkëtimin në BKT të shumës prej 30.000 euro, për llogari të shoqërisë “G&B” sh.p.k.

4.53 Subjekti i rivlerësimit ka paguar për llogari të shoqërisë “G&P” sh.p.k. edhe shumën 30.000 euro, për shlyerje kësti apartamenti, përveç shumës prej 85.000 euro, të deklaruar si të likuiduar

cash brenda vitit 2010. Ky fakt bazohet në shkresën e administruar nga BKT-ja⁵⁷, që vërteton se subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesën më 8.2.2010 me nr. reference ***TDCF***, në vlerën 30.000 euro me përfitues, verifikuar nga banka me kopjen e pasaportës së subjektit dhe nga DPPP-ja⁵⁸, siç është raportuar nga banka se subjekti i rivlerësimit ka depozituar më 8.2.2010, shumën 30.000 euro në Bankën Kombëtare Tregtare me vlerë 30.000 euro dhe përshkrim “Hysen Saliko pagesë kësti blerje apartamenti. Burimi i të ardhurave, kursime të ndryshme”.

4.54 Në lidhje me pretendimin se nuk ka qenë subjekti në bankë që ka kryer arkëtimin prej 30.000 euro dhe se firma në mandatarkëtim nuk është e tija, Komisioni vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, përderisa bazuar në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, Banka Kombëtare Tregtare, sipas nenit 3 të tij, është subjekt që i nënshtrohet këtij ligji. Një nga detyrimet kryesore të bankës, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 4, të këtij ligji dhe në kuadër të ushtrimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit, është identifikimi i klientit (të përhershëm apo rastësor, Person Fizik, juridik apo organizime ligjore) dhe verifikimi i identitetit të tij nëpërmjet dokumenteve, të dhënave apo informacioneve të marra nga burime të besueshme dhe të pavarura.

4.55 Në lidhje me pretendimin se kjo shumë është arkëtuar nga punonjësi i shoqërisë “G&P” sh.p.k., pasi subjekti ka arkëtuar shumën prej 50.000 euro *cash* në shoqëri, Komisioni vlerëson se edhe ky pretendim nuk qëndron, pasi referuar po ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, ligj të cilit i nënshtrohet BKT-ja dhe pikës 1/1, të nenit 4/1 të këtij ligji parashikohet se: “*Subjektet/bankat verifikojnë se çdo person që pretendon të veprojë në emër të klientit të tyre është i autorizuar për veprimet e kërkuara, si dhe të identifikojë e të verifikojë identitetin e personit të autorizuar*”. Pra, edhe në këtë rast, nëse do të kishte qenë punonjësi i shoqërisë, në momentin e arkëtimit në bankë, do të ishte identifikuar si person i autorizuar për veprimin e kërkuar dhe do të kishte firmosur mandatarkëtimin.

4.56 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se deklarimet e subjektit të rivlerësimit se nuk ka qenë ai personi që ka depozituar shumën prej 30.000 euro, për llogari të shoqërisë “G&B” sh.p.k., në BKT, janë jo të besueshme.

Në lidhje me provat e paraqitura nga subjekti për të provuar pagesat *cash* pranë arkës së shoqërisë

4.57 Më tej, nëse analizojmë mandatarkëtimet e paraqitura nga subjekti në cilësinë e provës për të provuar ekzekutimin e pagesave, Komisioni vlerëson se duhen marrë me rezervë për të provuar pagesat e kryera, për shkak se:

4.58 Referuar nenit 9 të ligjit nr. 7661, datë 19.1.1993, “Për kontabilitetin”, i cili parashikon, ndër të tjera, se çdo dokument kontabël mbështetet në një dokument justifikues (fillestar)⁵⁹ dhe “kërkesat e formës dhe të vlefshmërisë së dokumenteve justifikuese për t’u pranuar për regjistrime

⁵⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 4.3.2020.

⁵⁸ Shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2017, e cila konfirmon se ka raportime për një transaksion bankar të kryer nga subjekti i rivlerësimit në datën 8.2.2010, në Bankën Kombëtare Tregtare me vlerë 30.000 euro dhe përshkrim “Hysen Saliko pagesë kësti blerje apartamenti. Burimi i të ardhurave, kursime të ndryshme”.

⁵⁹ Si është fatura, fletëhyrja, fletëdalja, mandatarkëtimi etj.

në kontabilitet përcaktohen me regjimet kontabël⁶⁰”. Referuar “Sistemit kontabël të përgjithshëm”³, pika 2.2, “Rregullat e përgatitjes së dokumenteve justifikuese”, dokumenti justifikues bazë përgatitet në kohën kur kryhet veprimi dhe çdo dokument duhet të përmbajë:

- a. emërtimin e dokumentit, numrin rendor (ose serial), si dhe datën;
- b. emërtimin e ndërmarrjes dhe të njësisë organizative brenda saj, që lëshon dokumentin, formën juridike dhe adresën e ndërmarrjes;
- c. tregimin e personit ose të njësisë administrative që urdhëron kryerjen e veprimit, të personit që ekzekuton veprimin, si dhe në varësi të organizimit të lëvizjeve të vlerave dhe të veprimeve financiare, tregimin dhe firmën e personit që merr në ngarkim vlerat materiale apo monetare (f. 12 e planit kontabël të përgjithshëm);
- d. përshkrimin e përmbajtjes së objektit të veprimit apo të ngjarjes tjetër dhe, në varësi të natyrës së këtyre të fundit, treguesit sasiore dhe treguesit e vlerave;
- e. veprimet për shitjen e sendeve, orendive, punimet dhe shërbimet e kryera për një veprimtari ekonomike, profesionale apo administrative dokumentohen në çdo rast me faturë.

Të gjitha sa më sipër janë rikonfirmuar me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

4.59 Bazuar në sa më lart, në kundërshtim me rregullat e plotësimit të dokumentit financiar, mandatpagesave të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, si dokument justifikues për pagesën e kësteve të këtij apartamenti në Tiranë, u mungon adresa e shoqërisë (selia), në një nga mandatet viti është 2009 dhe numrat serialë nuk kanë rendin e duhur, referuar datave të mandatarkëtimeve.

4.60 Më konkretisht, mandatarkëtimet nr. *** serial, datë 17.5.2010 dhe nr. *** serial, datë 28.5.2010, krijojnë bindjen se janë të parregullta, pasi nga numri serial i tyre, referuar datave të lëshimit, tregojnë që janë lëshuar me një renditje të parregullt dhe nuk krijohet bindja se shoqëria mund të lëshonte një mandatarkëtim me nr. *** serial, në datën 28.5.2010, ndërkohë që mandatarkëtimi i datës së mëparshme 17.5.2010 ka numrin rendor ***.

4.61 Më tej, në verifikim vetëm me sy të tri mandatarkëtimeve të dorëzuara nga subjekti, respektivisht: (1) nr. ****, datë 8.2.2010, arkëtuar shuma 50.000 euro; (2) nr. ***, datë 5.4.2010, arkëtuar shuma 3.000 euro; dhe (3) nr. ****, datë 1.7.2010, arkëtuar shuma 3.000 euro, kanë edhe vulën e noterit publik, që tregon se kanë qenë bashkëlidhur kontratës së shitjes firmosur midis palëve, sipas deklarimit të shoqërisë “G&P” sh.p.k.

4.62 Ndërkohë që mandatarkëtimet e tjera të depozituara nga subjekti: nr. ***, datë 3.7.2017; nr. ***, datë 17.5.2010; nr. ****, datë 28.5.2010; nr. ****, datë 22.3.2010; nr. ****, datë 30.3.2009, duken të pabesueshme se i janë arkëtuar shoqërisë sipas deklarimit të subjektit.

4.63 Pretendimi i subjektit se likuidimi në shoqërinë “G&P” sh.p.k. është kryer me arkëtime *cash* pranë arkës së shoqërisë, sipas mandateve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, është i pavërtetë. Zhvendosja në data e deklarimit të pagesave të apartamentit nga subjekti i rivlerësimit sipas mandateve të paraqitura është bërë me qëllim që të justifikojë burimin e krijimit të tyre nga burime të tjera, përveç atyre të deklaruara në DPV-në e vitit 2010.

⁶⁰ Referuar nenit 2 të ligjit nr. 7661, datë 19.1.1993, regjimet kontabël miratohen nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bazuar në germën “a”, të nenit 3, të ligjit nr. 7661, datë 19.1.1993, Këshilli i Ministrave miraton sistemin kontabël të përgjithshëm.

4.64 Komisioni vlerëson se për at kohë sa subjekti nuk provoi se “Banka Kombëtare Tregtare” ka qenë në shkelje të detyrimeve të sanksionuara në legjislacionin e mësipërm, për identifikimin e klientit, konsiderohet e provuar se subjekti i rivlerësimit ka depozituar shumën prej 30.000 euro, në datën 8.2.2010, në “Bankën Kombëtare Tregtare” me përshkrimin “Hysen Saliko pagesë kësti blerje apartamenti. Burimi i të ardhurave , kursime të ndryshme”.

4.65 Në lidhje me provën e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, aktekspertimi grafik nr.***, datë 21.4.2020⁶¹, hartuar nga një ekspert kriminalistik i licensuar për të provuar që nuk ka qenë firma e tij, Komisioni vlerëson se konkluzioni i aktekspertimit grafik i shërben një procesi penal, por jo atij administrativ. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur provë të plotë shkresore, në rastin konkret një vendim të formës së prerë nga gjykatat për të vërtetuar pretendimin e tij, Komisioni mund të vendosë, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bazuar në bindjen e tij të brendshme, sipas nenit 51 të ligjit nr. 84/2016.

4.66 Në lidhje me pretendimin e subjektit se çmimi prej 118.300 euro ose 1.227 euro/m² i apartamentit është absurditet, Komisioni vlerëson se ky pretendim është i drejtë, duke pasur parasysh zhvillimin e zonës në të cilën është blerë apartamenti në vitin e blerjes (2010) dhe kontratat e ngjashme që solli subjekti në të njëjtën godinë, 7 kontratat që kanë çmimin mesatar është 506.8 euro/m² (7 apartamente me sip. të përgjithshme 736.2 m² dhe me vlerë totale 386.807 euro, 386.807: 736.2).

4.67 Referuar vlerësimit sa më lart, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pagesat e kryera për blerjen e këtij apartamenti dhe ka shtrembëruar faktet me qëllimin e vetëm që të justifikonte burimin e krijimit të tyre, duke qenë se rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të kryer pagesën prej 80.000 euro, në datën 8.2.2010.

4.68 Në konkluzion , Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, ka bërë deklaram të rremë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e këtyre të ardhurave, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 5 e nenit D të Aneksit të kushtetutës dhe neni 33, pika 5, gërma “a” “b” dhe “ç”, e ligjit nr. 84/2016.

5. Dy garazhe të ndodhur në katin e dytë nëntokë të godinës **-katëshe, me sip. 15.8 m²/secili

5.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë⁶² “garazhe” me sip. 15.8 m²/secili, nr***G** dhe nr. ****-G**, z. k. ****, në katin e dytë nëntokë të godinës 9-katëshe. Vlera: 6.000 euro të dy. Pjesa takuese: në pronësi me familjen.

⁶¹Për më tepër shihni aktekspertimin nr. ***, datë 21.4.2020, hartuar nga një ekspert kriminalistik i licensuar.

⁶² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 8. l. 2016, ku figuron i regjistruar garazhi nr. **, me sip. 15.8 m², në katin e dytë nëntokë të godinës me * kate, në Rr. “I. T”, me nr. pasurie ****-G**, në pronësi të shtetasve Hysen dhe F. S, si dhe harta treguese e regjistrimit (Aneks nr. 4/5); vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. **, datë 8. l. 2016, ku figuron i regjistruar garazhi nr. **, me sip. 15.8 m², në katin e dytë nëntokë të godinës me * kate, në Rr. “I. T”, me nr. pasurie ***-G**, në pronësi të shtetasve Hysen dhe F. S, si dhe harta treguese e regjistrimit (Aneks nr. 4/5); kontratë shitje pasurie të paluajtshme me nr. *** rep., nr. **** kol., datë 28.12.2015, me palës shitëse shoqërinë “G&P” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasit Hysen dhe F. S. Për blerjen e apartamentit me sip. 97.7 m², nr. pasurie ****, në shumën 88.300 euro, shumë e cila është

5.2 Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga kursimet e vitit 2015.

5.3 Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga kursimet e këtij viti dhe mënyrë e fitimit me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.12.2015.

5.4 ZVRPP-ja Tiranë⁶³ konfirmon se në emër të shtetasve Hysen dhe F. S janë regjistruar pasuritë garazhe: nr. ***-G***, me sip. 15.8 m², z. k. **** dhe nr. ***-G**, me sip. 15.8 m², z. k. **, në bashkëpronësi. Këto pasuri janë blerë me kontratën e shitjes për vlerën totale 6.000 euro. Bashkëngjitur gjendet kontratë shitjeje dhe kopje e kartelës së pasurive.

5.5 Burimi i krijimit për këtë pasuri, deklaruar në deklaratën *Vetting*, përputhet me deklarinimin e subjektit në DPV-në e vitit 2015, vit kur janë blerë dy garazhet.

5.6 Nga aktet e depozituara nga subjekti rezulton se ndërmjet shoqërisë “G&P” sh.p.k. dhe subjektit është nënshkruar kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. **** kol., datë 28.12.2015, për blerjen e dy garazheve dhe apartamentit, të sipërtrajtuar. Në kontratë parashikohet se shuma prej 6.000 euro do të kalojë nëpërmjet numrit të llogarisë së noterit në bankë dhe më pas në numrin e llogarisë së shoqërisë.

5.7 Bashkëlidhur kontratës rezulton një dokument i “Raiffeisen Bank” me përshkrimin “depozitim për të tretë”, ku në datën 28.12.2015, z. F. S ka derdhur shumën prej 6.000 euro, në favor të noterës M. Sh, me përshkrim të veprimit “kalim sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.2.2015.”

5.8 Nga analiza financiare për vitin 2015 (referuar tabelës përmbledhëse Aneks 1), duket se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e dy garazheve, në shumën 872.420 lekë.

5.9 Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e dy garazheve në shumën 872.420 lekë, referuar analizës për vitin 2015.

5.10 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se Komisioni nuk ka llogaritur të ardhurat nga bujqësia për vitin 2015, në shumën 1.000.000 lekë dhe se këto të ardhura janë deklaruar ndër vite dhe janë të ligjshme nga burim i ligjshëm dhe, si të tilla, duhet të përfshihen në tabelën e të ardhurave (shihni më poshtë kur të marren në analizë të ardhurat nga bujqësia dhe bletaria).

5.11 Subjekti shprehet se Komisioni ka gabuar për përlllogaritjen e shpenzimeve për jetesë edhe për vitin 2015, pasi në këtë vit edhe pse i është referuar përlllogaritjes së shpenzimeve sipas formulës së ILDKPKI-së, norma e shpenzimit për 4 frymë është në shumën 881.520 lekë, ndërkohë që nga Komisioni këto shpenzime janë llogaritur në mënyrë të gabuar, në shumën 897.104 lekë. Këto shpenzime, për një vit për familjen e subjektit me 4 frymë, për këtë periudhë, duhet të

likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ****, datë 8.2.2010. Për blerjen e garazhit me sip. 15.8 m², nr. pasurie ***-G**, në shumën 3.000 euro dhe të garazhit me sip. 15.8 m², nr. pasurie ***-G**, në shumën 3.000 euro, shuma totale prej 6.000 euro do t'i kalojë palës shitëse përmes llogarisë së noterit. Bashkëlidhur vërtetimi nga dokumenti hipotekor dhe harta treguese e apartamentit dhe garazheve në pronësi të firmës, kopje kartash ID (Aneks 4,4); mandat depozitimi për të tretë datë 28.12.2015, në “Raiffeisen Bank”, ku transferohet shuma 6.000 euro nga shtetasi F. S te Personi Fizik M. Sh me përshkrimin kalim sipas kontratës nr. **, datë 28.2.2015 (Aneks 4/4).

⁶³ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2019.

llogariten në shumën 881.520 lekë/vit. Subjekti sqaron se për këto dy vjet figuron i ndarë nga djali I. S, fakt që pranohet edhe nga Komisioni, i cili nuk ka llogaritur të ardhurat e tij në tabelën financiare.

5.12 Gjithashtu, subjekti shprehet se po kështu, nga Komisioni janë përlllogaritur gabim edhe shpenzimet për udhëtime për vitin 2015. Në DVP ka deklaruar si shpenzime për pushime shumën prej 400.000 lekësh, në të cilën janë përfshirë edhe shpenzimet për udhëtimet, ndërkohë që nga Komisioni shpenzimet për udhëtime janë llogaritur dy herë duke i rritur këto shpenzime me vlerën 203.722 lekë, vlerë kjo që duhet të zbritet nga shpenzimet e përgjithshme për jetesë, në masën 203.722 lekë. Subjekti sqaron se duke përfshirë edhe korrigjimin e bërë për shpenzimet për jetesë nga shuma 897.104 në shumën 881.520 lekë në vit, efekti në bilanc do të ndryshojë me 219.306 lekë.

5.13 Pas pasqyrimin të konstatimeve të mësipërme, në fund të vitit 2015 bilanci financiar rezulton me +346.886 lekë (shihni më poshtë tabelën përmbledhëse për periudhën 2015-2016).

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

5.14 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

5.15 Referuar konkluzionit mbi të ardhurat nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria për periudhën 1993 – 2015, të cilat nuk janë konsideruar si të ardhura të ligjshme, sipas analizës financiare të kryer për vitin 2015, kohë kur janë paguar dy garazhet me vlerë 6.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për vitin 2015 për të blerë pasuritë dhe për të kryer shpenzimet në shumën 872.420 lekë.

5.16 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për vitin 2015, për të blerë pasuritë dhe për të kryer shpenzimet, me një balancë negative prej 872.420 lekësh, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 33, pika 5, gërma “b” e ligjit nr. 84/2016.

6. Automjet tip “V- B”

6.1 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjetin⁶⁴ tip “V.B”, viti i prodhimit 2002. Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

6.2 Burim krijimi: të ardhurat e siguruara gjatë vitit 2008.

⁶⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (Aneks nr. 4/3) dosja e automjetit me targa TR *** R, nga DPSHTRr-ja, ku bashkëngjitur është prokurë e posaçme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.7.2008 ,me të cilën shtetasja B. M autorizon shtetasit Hysen dhe I, S të kryejnë shitjen, zhdoganimin dhe të kenë në përdorim automjetin në pronësi të saj tip “V. B”; kontratë shitblerjeje automjeti me nr. **** rep., nr. **** kol., datë 25.8.2008, më palë blerëse shtetasin Hysen Saliko dhe palë shitëse shtetasen B.M, për shitjen e automjetit tip “V. B”, viti i prodhimit 2002, nr. shasie...****, në shumën 500.000 lekë. Deklaratë zhdoganimi datë 23.8.2008 për automjetin e sipërcituar në pronësi të shtetas B. M.

6.3 Në DPV-në e vitit 2008, me të ardhurat e siguruar gjatë vitit 2008 nga pagat dhe të ardhurat e tjera. Mënyra e fitimit: blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.8.2008.

6.4 DPSHTRr-ja⁶⁵ konfirmon se subjekti ka në pronësi automjetin me targa TR *** R, të tipit “V. B”.

6.5 Nga aktet e depozituara nga DPSHTRr-ja, rezulton kontrata e shitblerjes së automjetit me nr. **** rep., nr. **** kol., datë 28.8.2008, sipas së cilës subjekti blen automjetin e përshkruar më sipër në çmimin 500.000 lekë. Palët deklarojnë se janë likuiduar në mes tyre dhe se nuk kanë më asnjë lloj detyrimi. Bashkëlidhur kontratës rezulton një prokurë e posaçme me nr. *** rep., nr. **** kol., datë 28.7.2008, sipas së cilës prokurëlëshuesja B. M autorizon shtetasit Hysen dhe I. S (djali i subjektit): (i) që ta përfaqësojnë që të dy bashkërisht apo veçmas për të nënshkruar në emër dhe llogari të saj kontratën e shitblerjes, me një çmim që ta gjykojnë të arsyeshëm përfaqësuesit; (ii) për të bërë zhdoganimin e automjetit; (iii) për ta përdorur sipas ligjit. Përfaqësuesi deklaroi se e ka marrë në dorëzim automjetin në fjalë, përfundimisht pa të drejtë kthimi dhe se për çfarëdolloj problemi ligjor që mund të dalë mban personalisht përgjegjësi ligjore. Znj. B. M, vetëm për këtë problem, deklaroi se i jep tagër të plotë veprimi përfaqësuesit dhe veprimet e tij i konsideron të mirëqena njëlloj sikur t’i kishte kryer personalisht i përfaqësuari.

6.6 Në dosjen e automjetit rezulton dokumenti deklarativ doganorë e datës 23.8.2008, sipas së cilës, për zhdoganim, është paguar shuma prej 197.506 lekësh. Nga aktet e dosjes të depozituara nga subjekti, duket e paqartë nëse kjo shumë i shtohet çmimit të blerjes së automjetit prej 500.000 lekësh.

6.7 Subjekti u pyet në lidhje me shtetasen B.M, i cili shpjegoi⁶⁶ se personalisht nuk ka asnjë njohje personale dhe, për më tepër, të ketë ndonjë marrëdhënie, përveç faktit si shitëse e automjetit të blerë prej tij në datën 25.8.2008. Me të ka pasur njohje djali i tij I. S, i cili e ka pasur mike dhe, si rrjedhojë ia ka lënë djalit për t’ia shitur duke i dhënë edhe ofertën e shitjes prej 500.000 lekësh me gjithë shpenzimet doganore. Nisur nga fakti që për vlerën e ofruar, si dhe duke e parë si automjet me shpenzime ekonomike dhe me çmim të arsyeshëm, e blenë për vete.

6.8 Subjekti u pyet për mënyrën e kryerjes së pagesës dhe për çmimin e shitblerjes së automjetit, nëse përfshihej edhe pagesa doganore. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar⁶⁷ se për blerjen e automjetit në vitin 2008, pagesa është bërë *cash*, në shumën prej 500.000 lekësh, ku përfshihen edhe detyrimet doganore.

6.9 Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se nga analiza financiare e kryer për vitin 2008, duket se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e automjetit, në shumën 628.850 lekë.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

6.10 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat

⁶⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.2.2019.

⁶⁶ Me përgjigjet e pyetësorit të datës 17.2.2020.

⁶⁷ Me përgjigjet e pyetësorit të datës 30.4.2020.

periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

6.11 Referuar konkluzionit mbi të ardhurat nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria për periudhën 1993 – 2015, të cilat nuk janë konsideruar si të ardhura të ligjshme për efekt të ligjit nr. 84/2016, sipas analizës financiare të kryer për vitin 2008, kohë kur është blerë automjeti, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për vitin 2008 për të blerë pasuritë dhe për të kryer shpenzimet në shumën 628.850 lekë.

6.12 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për vitin 2008 për të blerë pasuritë dhe për të kryer shpenzimet, me një balancë negative prej 628.850 lekësh, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 33, pika 5, gërma “b” e ligjit nr. 84/2016.

7. Llogari rrjedhëse depozituar në “Credins Bank”, në emër të shtetasve L dhe M.S(nëna dhe bashkëshortja e subjektit)

7.1 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogari rrjedhëse⁶⁸ të depozituar në “Credins Bank”, në depozitën me nr. llogarie *****, në emër të shtetasve L dhe M.S, nga të ardhurat e siguruara nga pemëtaria dhe bletaria gjatë vitit 2016, me gjendje në shumën 1.575.136 lekë.

7.2 Si burim krijimi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat e siguruara nga pemëtaria, toka dhe bletaria gjatë vitit 2016.

7.3 Në deklarimin e vitit 2016, subjekti ka deklaruar këto të ardhura të siguruara nga pemëtaria, toka dhe bletaria gjatë vitit 2016.

7.4 “Credins Bank”⁶⁹ konfirmon se shtetaset L dhe M.S kanë pasur depozitë dyemërore me gjendje në shumën 1.575.382 lekë, në vitin 2016.

7.5 Deklarimi i subjektit përputhet në deklaratën *Vetting* për burimin e krijimit të kësaj depozite krahasuar me deklaratimet periodike vjetore.

Tabela referuar faturave të shitjeve të produkteve bujqësore dhe arkëtimet në vitin 2016.

	Shuma e faturuar (lekë)	Arkëtuar në llogari bankare (lekë)
D. P sh.p.k.	1 302 540	1 295 000
T. T. K sh.p.k.	279 900	279 900
Shuma totale	1 582 440	1 574 900

7.6 Nga hetimi i kryer dhe dokumentacioni i administruar në dosje, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka provuar me dokumentacion ligjor shitjen e produkteve në shumën 1.582.440 lekë për vitin 2016, por nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar që këto të ardhura i përkisnin vetëm familjes së tij. Duket se të ardhurat janë deklaruar në DPV dhe në

⁶⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (Aneks nr. 4/6) vërtetim nr. *** prot., datë 29.12.2016, me anë të të cilit konfirmohet se shtetaset L dhe M. S janë kliente të “Credins Bank” dhe kanë llogari aktive me gjendje 1.575.136 lekë, në datën 29.12.2016.

⁶⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2019.

deklaratën *Vetting* si të ardhura *neto*. Gjithashtu, duket se subjekti ka deklaruar shitje të produkteve dhe arkëtuar me bankë edhe gjatë viteve 2017 dhe 2018.

7.7 Për vitin 2016, sipas dokumentacionit të depozituar nga subjekti, rezulton se nëna e tij ushtron aktivitet bujqësor të ligjshëm dhe referuar faturave tatimore për shitjet e produkteve bujqësore, të ardhurat janë përfituar prej saj dhe jo nga subjekti.

7.8 Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se faturat tatimore për shitjet e produkteve bujqësore dhe të ardhurat janë përfituar nga nëna e subjektit, znj. M.S dhe jo nga subjekti dhe, për rrjedhojë, subjekti nuk ka provuar të ketë përfituar të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti bujqësor i nënës.

7.9 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se nga certifikata familjare rezulton se nëna e subjektit M. S është kryefamiljare, pra, në referim edhe të nenit 224 të Kodit Civil⁷⁰, është kryetare e familjes bujqësore dhe, si e tillë, si në të gjitha DPV-të, ashtu edhe në deklaratën *Vetting* është përfshirë në familjen e subjektit. Për rrjedhojë, si të ardhurat ashtu edhe shpenzimet janë llogaritur së bashku. Në bazë të nenit 222 të Kodit Civil⁷¹, pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore u përket në tërësi anëtarëve të saj. Kjo ka qenë edhe arsyeja që pajisja me NIPT është bërë nga nëna në cilësinë e kryefamiljares.

7.10 Subjekti shprehet më tej se nëna si kryefamiljare, njëherazi edhe si kryetare e familjes bujqësore ka bërë administrimin e të gjithë pasurisë së fituar nga familja dhe duke qenë se në zonën e tyre pranohet fakti se buxheti i familjes mbahet nga kryefamiljari, nuk mendon se duhet të vihet në diskutim mënyra e gjenerimit të të ardhurave në emër të tij. Është provuar se të gjitha të ardhurat e familjes, të kursyera për periudhën 1993 – 2010, janë përdorur nga familja, konkretisht shuma prej 11.756.500 lekësh është përdoruar për blerjen e banesës në pronësi të shtetasve H dhe F. S dhe shuma prej 500.000 lekësh për blerjen e automjetit tip “V”, pa qenë nevoja që midis anëtarëve të familjes të kryhet ndonjë veprim.

7.11 Por, subjekti shprehet se pavarësisht këtyre parashikimeve dhe prezumimeve ligjore, nëna e tij, nëpërmjet deklaratës noteriale⁷² me nr. *** rep., nr. 170 kol., datë 25.6.2020, ka deklaruar se të gjitha të ardhurat që janë siguruar nga ferma bujqësore kanë kaluar në llogari të djalit. Në këtë deklaratë nëna pranon faktin se nuk ka asnjë pretendim me këto të ardhura. Gjithsesi shuma prej 1.574.440 lekësh pasuri ndodhet ende në depozitë bankare në emër të saj dhe të bashkëshortes së subjektit L. S.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

7.12 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të

⁷⁰Familja bujqësore përfaqësohet në marrëdhëniet pasurore me të tretët nga kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët e saj.

⁷¹Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

⁷²Për më tepër shihni deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.6.2020, të lëshuar nga znj. M. S

administruara sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

7.13 Nëse është i vërtetë pretendimi i subjektit se nëna si kryefamiljare, njëherazi edhe si kryetare e familjes bujqësore, ka bërë administrimin e të gjithë pasurisë së fituar nga familja, atëherë këto fitime duhet të shpërndahen për të gjithë anëtarët e familjes bujqësore, në rastin konkret 7 anëtarë, sipas dispozitave të nenit 222 e vijues të Kodit Civil, i cili parashikon se: *“Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara kanë kontribuuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore”*.

7.14 Sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, ligjvënësi e njohu bashkëpronësinë mbi tokën bujqësore për të gjithë anëtarët e familjeve shqiptare që banonin dhe jetonin në fshat apo në ferma bujqësore, por që ishin në përbërje të familjes bujqësore. Personat që kishin lindur para datës 1.8.1991, kishin të drejtë të përfitonin nga dispozitat e ligjit, për t’u bërë bashkëpronarë të tokës bujqësore dhe që do të përfitonin pas shpërbërjes së kooperativave dhe fermave bujqësore. Numri i anëtarëve të gjallë të familjeve bujqësore dhe, rrjedhimisht, numri i personave që do të ishin bashkëpronarë mbi tokën bujqësore, ishte një numër i përcaktuar me miratimin e ligjit “Për tokën” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”⁷³.

7.15 Në analizë literale të këtyre normave konstatohet se natyra e bashkëpronësisë së familjes bujqësore në këtë rast, referuar edhe nenit 222 të Kodit Civil të vitit 1994, nuk mund të ndryshojë siç pretendon subjekti që ka në përdorim për qëllimet e tij pothuajse të gjithë sipërfaqen e përfituar me AMTP-në. Bashkëpronësia në tërësi e familjes bujqësore, për sa kohë nuk është pjesëtuar sipas rregullave të nenit 207 të Kodit Civil, secili prej anëtarëve tërheq të drejta dhe detyrime ndaj kësaj prone pasurie.

7.16 Më tej, nëna si përfaqësuese e familjes bujqësore nuk ka të drejta mbi dhurimin e të ardhurave nga frytet e kësaj prone vetëm por subjektin, por të gjithë anëtarët e familjes bujqësore duhet të shprehen mbi dhurimin e këtyre të ardhurave për subjektin, duke qenë se janë të ardhura të përfituara nga toka në bashkëpronësi, për më tepër që subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues që investimet/shpenzimet për pemëtari dhe bletari ishin kryer prej tij.

7.17 Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar të ardhurat nga bletaria dhe pemëtaria, të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj depozite dyemërore edhe pse këto të ardhura sipas faturave tatimore janë përfituar vetëm nga nëna e subjektit të rivlerësimit, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 33, pika 5, gërma “b” e ligjit nr. 84/2016

8. Apartament me sip. 86.89 m², në Blv. “Gj. F”, Tiranë

⁷³ Referuar ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për Tokën”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 7501”) dhe akteve në zbatim të tij, konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriterin e ndarjes së tokës bujqësore”, në pikën 2 parashikohet se: *“ Në të gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje, sipas numrit të frymëve, të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991 ”*. Më tej, po në të njëjtin vendim parashikohet se: *“ [...] në numrin e frymëve të familjes anëtare të kooperativës bujqësore.... do të përjashtohen anëtarët e familjes që në momentin e ndarjes së tokës janë në marrëdhënie pune të përhershme në sektorin shtetëror ose privat [...] ”*

8.1 Në deklaratën *Vetting*, personi tjetër i lidhur/djali i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se ka në pronësi një apartament⁷⁴ me sip. 86.89 m², nr. pasurie *****, z.k. ***, shk. *, k. *, ap. **, godinë *-katëshe, në Blv. “Gj. F” Tiranë. Vlera: 53.000 euro. Pjesa takuese: 100 % në pronësi të z. I.S.

8.2 Si burim krijimi djali i subjektit deklaron të ardhurat dhe kursimet e veta dhe të prindërve (familjes) gjatë viteve 2010 — 2014, në shumat 30.000 euro dhe 23.000 euro, sipas kontratës së huas së lidhur me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.2.2014, me huadhënës Xh. Xh.

8.3 Në DPV-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyer me bankë me të ardhurat nga kursimet në vite 30.000 euro dhe 23.000 euro paguar po me bankë prej huadhënësit Xh. Xh, sipas kontratës së huas lidhur ndërmjet shtetasve I.S dhe Xh .Xh, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.2.2014, fituar me kontratën noteriale të noterisë Tiranë nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 21.2.2014 dhe regjistruar me nr. *** hipotekor, datë 4.3.2014.

8.4 ZVRPP-ja Tiranë⁷⁵, konfirmon pasurinë apartament me sip. 87.89 m², nr. *****, vol. **, z.k. 8220, regjistruar në emër të shtetasit I. S.

8.5 OSHEE-ja⁷⁶ informon se në emër të z. I. S rezulton një kontratë e regjistruar në instancën e Tiranës. Faturimi me energji ka filluar në gusht të vitit 2014.

8.6 Në lidhje me burimin e krijimit, deklarimi i subjektit përputhet me DPV-në e vitit 2014 dhe me deklaratën *Vetting*, ku shpjegohet se burim krijimi për këtë pasuri janë kursimet familjare 2010 – 2014 dhe huaja e marrë te z. Xh. Xh.

8.7 Në dosjen e subjektit rezulton kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.2.2014, me palë shitëse shtetasit L dhe O.L dhe palë blerëse shtetasin I.S, për blerjen e apartamentit me sip. 86.89 m², nr. pasurie *****, z. k. *****, në “Rr . K”. Çmimi i blerjes është përcaktuar 53.000 euro, likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale, në rrugë bankare, pa asnjë pretendim nga palët kontraktuese. Bashkëlidhur kontratës gjendet vërtetim nga dokumenti

⁷⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetim nga dokumenti hipotekor me nr. **, datë 4.3.2014, për apartamentin me sip. 86.89 m², me nr. pasurie *****, i regjistruar në emër të shtetasit I.S dhe bashkëngjitur harta treguese (Aneks nr. 4. 9); kontratë shitje pasuri e paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.2.2014, me palë shitëse shtetasit L dhe O. L dhe palë blerëse shtetasit I.S, për blerjen e apartamentit me sip. 86.89 m², nr. pasurie *****, z. k. ***, në Rrugën e K. Çmimi i blerjes 53.000 euro; mandatpagesë në “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 21.2.2014, me të cilin shtetasi Xh. Xh kryen pagesën në shumën 23.000 euro, në favor të shtetasit L. L për llogari të shtetasit I. S; kontratë huaje nr. *** rep., nr. ** kol., datë 21.2.2014 me palë huadhënës shtetasin Xh. Xh dhe palë huamarrëse shtetasin I.S, për dhënie hua të shumës 23.000 euro, me afat 18 muaj, pa kamatë ose interes; formular i deklarimit vjetor individual i të ardhurave për vitin 2014 të realizuara nga shtetasi Xh. Xh; vërtetim nga shoqëria “A. D & D” datë 28.10.2016, ku konfirmohet se shtetasi Xh. Xh punon në pozicionin administrator dhe për vitin 2014; formular i deklarimit vjetor individual i të ardhurave për vitin 2013 të realizuara nga shtetasi Xh. Xh ku rezulton se shuma e të ardhurave *bruto* vjetore është 32.276.740 lekë; vendim datë 9.4.2013 i ortakut të vetëm, shtetasit Xh. Xh, për shoqërinë “B. D. D” sh.p.k., për shpërndarje dividendi për vitin 2012, në shumën 30.287.869 lekë. Bashkëlidhur mandatpagesë në “Raiffeisen Bank” për tatimin mbi dividendin për vitin 2012 në shumën 3.028.787 lekë; mandat datë 3.11.2014 në “Raiffeisen Bank” me përfitues shtetasin Xh.Xh dhe dërgues shtetasin Hysen Saliko për kthimin e huas sipas kontratës nr. ***** prot., datë 21.2.2014, në shumën 2.000.000 lekë; deklaratë datë 28.12.2014, nga shtetasi Xh. Xh, i cili deklaron se shtetasi I.S nuk ka më detyrime ndaj tij. Shlyer *cash* pjesa e mbetur e huas në shumën 8.715 euro, në datën 28.12.2014; përgjigje e ZVRPP-së Kolonjë datë 18.10.2016 sipas të cilit rezulton se shtetasi Hysen Saliko ka pasur në pronësi një godinë (magazinë ish-lavanteri gruri) z.k. ***** e regjistruar në hipotekë me nr. ***, datë 9.2.1996, në vlerën 1.085 lekë dhe e rivlerësuar në datën 21.2.2012, në vlerën 2.299.440 lekë. Kjo pasuri në datën 30.10.2014 është shitur për shumën 2.000.000 lekë nga ky shtetas me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol. (Aneks nr. 4/ 1); kontratë shitje pasurie të paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.10.2014, me palë shitëse shtetasin Hysen Saliko dhe palë blerëse shtetasin E. E, për shitjen e godinës së llojit magazinë (ish-lavanteri gruri), z. k. ***, me vendndodhje në Q. Kolonjë, e regjistruar me nr. ****, datë 9.2.1996, në shumën 2.000.000 lekë, e kaluar me mandatarkëtimin në llogarinë bankare në datën 30.10.2014. Bashkëlidhur vërtetim nga dokumenti hipotekor dhe plan rievimi për pasurinë e sipërcituar. Depozitim për të tretë me mandat në “Raiffeisen Bank” datë 30.10.2014 nga blerësi E. V në shumën 2.000.000 lekë, në llogari të noterës. Pagesë e brendshme në “Raiffeisen Bank” datë 30.10.2014, për kalimin e shumës 2.000.000 lekë nga znj. F. L (notere) në llogari të z. Hysen Saliko (Aneks nr. 4,8).

⁷⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2019.

⁷⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2019.

hipotekor, harta treguese, kopje kartele për pasurinë e sipërcituar, në emër të shitësit dhe kopje e kartës ID për palët.

8.8 Subjekti i ka bashkëlidhur kontratës: (i) mandatpagesën e “Credins Bank”, të datës 21.2.2014, me të cilin shtetasi I.S kalon shumë prej 30.000 euro në favor të shtetasit L. L, për kontratën me nr. *** rep., nr. *** kol; dhe (ii) mandatpagesën e “Intesa Sanpaolo Bank”, të datës 21.2.2014, sipas të cilit shtetasi Xh. Xh ka bërë depozitim *cash* shumë prej 23.000 euro, me përshkrim “pagesë për llogari të I. S, sipas kontratës së huas nr. *** rep., nr. **kol., datë 21.2.2014, pagesë për kontratë blerje”.

8.9 Në lidhje me huan në shumë prej 23.000 euro, z. I. S, djali i subjektit ka nënshkruar kontratë huaje me nr. ** rep., nr. ** kol., datë 21.2.2014 më palë huadhënëse shtetasin Xh.Xh për huan në shumë 23.000 euro, me afat 18 muaj, pa kamatë ose interes. Bashkëlidhur kontratës gjendet mandatpagesa në “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 21.2.2014, sipërcituar për kalimin e shumë 23.000 euro nga shtetasi Xh. Xh te shtetasi L. L.

8.10 Komisioni, bazuar në nenin 34/2 të ligjit nr. 84/2016, i kërkoi subjektit dokumentacion për të provuar të ardhurat e ligjshme të huadhënësit Xh. Xh dhe ka administruar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti për të vërtetuar të ardhurat e huadhënësit.⁷⁷

8.11 Komisioni ka hetuar në lidhje me burimin e ligjshëm për huadhënësin, me të cilin z. I. S, djali i subjektit, ka nënshkruar një kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.2.2014, më palë huadhënës shtetasin Xh. Xh, në shumë 23.000 euro, nga ku rezultoi se:

8.12 DRT-ja Tiranë⁷⁸ konfirmon se shtetasi Xh.Xh rezulton i regjistruar si punëmarrës: për periudhën dhjetor 2011 – maj 2017 në shoqërinë “B.D.D” sh.p.k., me NIPT K***K; për periudhën dhjetor 2011 – maj 2017 në shoqërinë “A. D & D” sh.p.k., me NIPT K***C dhe për periudhën maj 2012 – shkurt 2017, në shoqërinë “F & D.D” sh.p.k., me NIPT L***Q. Ky shtetas është subjekt i deklaramit të të ardhurave personale.

8.13 DRT-ja Durrës⁷⁹ konfirmon se shtetasi Xh. Xh rezulton i regjistruar si administrator në shoqërinë “B. D. D” sh.p.k., me NIPT K***K, me aktivitet tregti me shumicë e artikujve të tjerë

⁷⁷Formulari i deklaramit vjetor individual i të ardhurave (DIVA) për vitin 2014, të realizuara nga shtetasi Xh. Xh, ku rezulton se shuma e të ardhurave *bruto* vjetore është 25.986.381 lekë; vërtetim nga shoqërisë “A. D & D” datë 28.10.2016, ku konfirmohet se shtetasi Xh. Xh punon në pozicionin administrator dhe për vitin 2014 ka përfituar paga *neto* vjetore në shumë 1.440.000 lekë; formulari i deklaramit vjetor individual i të ardhurave për vitin 2013, të realizuara nga shtetasi Xh. Xh, ku rezulton se shuma e të ardhurave *bruto* vjetore është 32.276.740 lekë; vendim datë 9.4.2013 i ortakut të vetëm, shtetasit Xh. Xh, për shoqërinë “B. D D” sh.p.k., për shpërndarje dividendi për vitin 2012, në shumë 30.287.869 lekë. Bashkëlidhur gjendet mandatpagesa në “Raiffeisen Bank” për tatimin mbi dividentin për vitin 2012, në shumë 3.028.787 lekë; mandat datë 3.11.2014 në “Raiffeisen Bank”, me përfitues shtetasin Xh. Xh dhe dërgues shtetasin Hysen Saliko për kthimin e huas sipas kontratës nr. *** prot., datë 21.2.2014, në shumë 2.000.000 lekë; deklaratë datë 28.12.2014 nga shtetasi Xh.Xh, i cili deklaron se shtetasi I.S nuk ka më detyrime ndaj tij. Shlyer *cash* pjesa e mbetur e huas në shumë 8.715 euro, në datën 28.12.2014. Bashkëngjitur gjendet kopje e kartës ID të huadhënësit; shkresë datë 18.10.2016, nga ZVRPP-ja Kolonjë ku rezulton se shtetasi Hysen Saliko ka pasur në pronësi një godinë (magazinë ish-lavanteri gruri) në z.k. ***, e regjistruar në hipotekë me nr. ****, datë 9.2.1996, në vlerën 1.085 lekë dhe e rivlerësuar më 21.2.2012, në vlerën 2.299.440 lekë. Kjo pasuri, në datën 30.10.2014 është shitur për shumë 2.000.000 lekë nga ky shtetas me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol.; kontratë shitje pasurie e paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.10.2014, me palë shitëse shtetasin Hysen Saliko dhe palë blerëse shtetasin E. E., për shitjen e godinës të llojit magazinë (ish- lavanteri gruri), z. k. ***, Q, Kolonjë, e regjistruar me nr. ***, datë 9.2.1996, në shumë 2.000.000 lekë, e kaluar me mandatarëkëtimin në llogarinë bankare në datën 30.10.2014. Bashkëlidhur gjendet vërtetimi nga dokumenti hipotekor dhe plan rievimi për pasurinë e sipërcituar. Depozitim për të tretë, me mandate, në “Raiffeisen Bank” datë 30.10.2014, nga blerësi E. V. në shumë 2.000.000 lekë, në llogari të noterës. Pagesë e brendshme në “Raiffeisen Bank”, datë 30.10.2014, për kalimin e shumë 2.000.000 lekë nga znj. F. L(notere) në llogari të z. Hysen Saliko (Aneks nr. 4,8).

⁷⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

⁷⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

dhe e artikujve të përzierë, e cila është çregjistruar në datën 24.3.2016. Në vitet 2006 – 2008, të ardhurat janë regjistruar jashtë sistemit në Kavajë. Në vitet 2009 – 2013, kjo shoqëri ka të ardhura në shumën totale 472.619.325 lekë dhe fitim në shumën totale 59.945.201 lekë. Detyrimet në kohë reale janë 0 lekë dhe tatimpaguesi nuk ka dividend të paguar. Bashkëlidhur gjenden pasqyrat financiare të periudhës 2008 – 2015.

8.14 DRT-ja Durrës me shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2017, konfirmon se sipas të dhënave të sistemit C@ts shtetasi M. Xh rezulton i regjistruar si administrator, në shoqërinë “B.D. D” sh.p.k., me NIPT K****K. Ky shtetas ka realizuar të ardhura *bruto* nga vetëpunësimi për periudhën 2011 – 2015, në shumën totale prej 1.474.000 lekësh.

8.15 ISSh-ja⁸⁰ ka konfirmuar se shtetasi Xh.Xh rezulton të ketë përfituar të ardhura të deklaruara për periudhën janar 2012 – prill 2017, nga shoqëria B.D.D sh.p.k., nga shoqëria “A.D & D” sh.p.k., me NIPT K***C dhe nga shoqëria “F & D. D” sh.p.k., me NIPT L***Q..

8.16 Në lidhje me hudhënësin z. Xh. Xh, nga analizimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti dhe nga analizimi i të dhënave të ardhura nga institucionet publike, duket se huadhënësi ka pasur burime të ligjshme për huan e dhënë.

8.17 Komisioni analizoi gjithashtu, në lidhje me mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për shlyerjen e huas në shumën 23.000 euro. Subjekti ka depozituar dokumentacion mbështetës dhe ka deklaruar se është shlyer vlera 2.000.000 lekë (14.285 euro) nga shitja e magazinës në pronësi të z. Hysen Saliko me kontratën nr. ***rep., nr. *** kol., datë 30.10.2014 dhe diferenca prej 1.220.000 (8.715 euro) lekësh nga kursimet e familjes dhe të prindërve gjatë vitit 2014.

8.18 Referuar të dhënave të ardhura nga ZVRPP-ja Kolonjë⁸¹ ka rezultuar se shtetasi Hysen Saliko ka pasur në pronësi një godinë (magazinë ish-lavanteri gruri) z.k. ***, e regjistruar në hipotekë me nr. ***, datë 9.2.1996, në vlerën 1.085 lekë dhe e rivlerësuar në datën 21.2.2012, me vlerën 2.299.440 lekë. Kjo pasuri, në datën 30.10.2014 është shitur sipas kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. ***rep., nr. *** kol., datë 30.10.2014, për shumën 2.000.000 lekë, e kaluar me mandatarëkim në llogarinë bankare më 30.10.2014⁸².

8.19 Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 2011– 2014, e cila është paraqitur në tabelën, si vijon:

⁸⁰ Me shkresën nr. **** prot., datë 30.6.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

⁸¹ Datë 18.10.2016.

⁸² Bashkëlidhur vërtetim nga dokumenti hipotekor dhe plan riveçimi për pasurinë e sipërcituar. Depozitim për të tretë me mandat në “Raiffeisen Bank”, datë 30.10.2014, nga blerësi E. V në shumën 2.000.000 lekë, në llogari të noteres. Pagesë e brendshme në “Raiffeisen Bank”, datë 30.10.2014, për kalimin e shumës 2.000.000 lekë nga noterja F. L, në llogari të z. Hysen Saliko.

Pershkrimi	2011	2012	2013	2014
PASURI	1 715 616	1 355 609	1 875 054	2 278 239
Apartament ne emer te Ibrahim Saliko				7 425 830
DIFERENCE LIKUIDITETI (DIF. LIK. - LIKUIDITETE VITI PARAARDHES)	1 715 616	1 355 609	1 875 054	-5 147 591
LIKUIDITETE (FUND VITI Dok.)	1 739 678	3 095 287	4 970 341	-177 250
Gjendje cash	1 600 000	3 200 000	4 800 000	
SR: Llog page RBAL	31 549	8 908	54 629	357
SR: Llog page Credins	4 590	4 590	4 590	4 590
SR: Tirana Bank llog page	2 289	9 177	608	619
B/sh: Llog page Credins	0	17 548	257 600	81 532
Ibrahim Saliko: Credins llog page	101 250	500	500	-110 432
Ibrahim Saliko: ISP llog page	0	-145 436	-147 586	-153 915
DETYRIME	-	-	-	-458 073
Detyrim firmes se ndertimit per apartamentin ne Tirane				-458 073
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	1 715 616	1 355 609	1 875 054	2 736 312
TE ARDHURA dokumentuar	1 617 280	1 943 392	2 413 650	4 342 782
Te ardhura Subjekti	1 430 572	1 355 467	1 396 591	1 468 222
Te ardhura b/shortja	-	52 644	222 292	234 432
Te ardhurat Ibrahim Saliko	101 250	446 403	702 633	540 160
Te ardhura nga pensionet	85 458	88 878	92 134	99 968
Te ardhura nga shitja e magazinës në Qinam (dk 30.10.2014)				2 000 000
SHPENZIME	1 296 065	1 134 800	1 363 626	2 594 270
Shpenzime jetese	683 100	705 120	705 120	1 099 990
Shpenzime udhetimi	490 965	274 550	404 506	102 280
Shpenzim mobilimi i apt te djalit				1 300 000
Pagese license avokatie I. Saliko 10/09/2013			112 000	
Shpenzime mobilimi apartamenti i SR	70 000	80 000	90 000	40 000
Shpenzime transporti sipas pyetesorit	48 000	48 000	48 000	48 000
Shpenzime legalizimi per magazinën ne Qinam		23 130		
Shpenzime rikonstruksioni i shtepise ne Qinam	4 000	4 000	4 000	4 000
Rezultati financiar	-1 394 401	-547 017	-825 030	-987 801

8.20 Referuar analizës financiare të kryer për periudhën 2011– 2014, të paraqitur në tabelën e mësipërme, duket se subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme, në shumën 3.754.249 lekë.

8.21 Shpenzimet e mobilimit të apartamentit të djalit të subjektit, z. I. S, janë deklaruar në shumën totale 1.300.000 lekë, i cili ka deklaruar se *si burim ka shërbyer dhurata që prindërit e bashkëshortes kanë bërë për dasmën e vajzës së tyre.*

8.22 Subjektit iu kërkua dokumentacion mbështetës mbi burimin e ligjshëm të dhuratës martesore të deklaruar nga personi i lidhur.

8.23 Nga analizimi i akteve te depozituara nga subjekti ka rezultuar se: (i) nëna e znj. S.N (bashkëshortja e djalit të subjektit) ka qenë kryesisht në asistencë sociale për periudhën 1994 – 2000 dhe nga viti 2001 e në vijim; (ii) babai ka qenë i trajtuar me ndihmë ekonomike në periudhën mars 2011– dhjetor 2013.

8.24 Nga analizimi i llogarisë bankare në emër të znj. M. N(nëna e bashkëshortes së djalit të subjektit) në “ProCredit Bank” ka rezultuar një depozitë në shumën 619.000 lekë, e mbyllur në gusht të vitit 2013. Gjithashtu, rezultojnë pagesa mujore të ndihmës ekonomike në llogarinë bankare të z. V.N.

8.25 Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se: (i) duket se prindërit e bashkëshortes

së djalit të subjektit të rivlerësimit kanë mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për vlerat monetare të dhuruara vajzës së tyre, si burim për mobilimin e shtëpisë në shumën 1.600.000 lekë; (ii) referuar analizës financiare të kryer për periudhën 2011– 2014, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme, në shumën 3.754.249 lekë, duke marrë në konsideratë pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

8.26 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera deklaroi se prindërit e bashkëshortes së djalit, me rastin e martesës së vajzës së tyre i kanë dhënë si pajë shumën prej 1.600.000 lekësh (shpenzime për mobilimin). Nga kjo shumë, sikundër është deklaruar edhe në deklaratën periodike dhe në deklaratën *Vetting*, nga djali i subjektit shuma prej 1.300.000 lekësh është përdorur për mobilimin e shtëpisë. Në këtë shumë përfshihet edhe blerja e dhomës së gjumit të porositur prej dhuruesve dhe në këtë rast nuk do të kishte kuptim zbatimi i nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

8.27 Po kështu, kjo shumë e dhënë si “pajë”, sikurse kanë deklaruar edhe prindërit e bashkëshortes së djalit, është siguruar si nga kursimet e familjes, ashtu edhe nga dhuratat e mbledhura nga të afërmit (xhaxhallarë, halla, teze, dajallarë kushërinj etj.) me rastin e martesës së saj. Subjekti shprehet se: *“... në traditën e familjeve shqiptare është që në raste martesash të bëjnë dhurata të gjithë të afërmit. Kjo traditë e shqiptarit nuk është vetëm për raste dasmash, por edhe në raste vdekjesh dhe sigurisht që me rastin e martesës së mbesës apo të afërmit të bëjnë dhuratë, sikurse ka ndodhur edhe në rastin e nuses së djalit tim. Nënvizoj faktin se shuma prej 1.600.000 lekësh nuk është ndonjë shumë e madhe që të mos përballohet nga një familje sado me gjendje të vështirë ekonomike që të jetë.*

Përveç dokumentacionit që ju kam vënë në dispozicion, se sikundër ju kam sqaruar edhe më parë në përgjigjet e dhëna, vlen të përmend faktin që babai i nuses së djalit ka një profesion që siguron të ardhura të konsiderueshme. Ky fakt është konfirmuar edhe në deklaratën e lëshuar prej tij dhe që jua kam vënë në dispozicion. Ai edhe pse në pension pleqërie, ende është aktiv dhe punon si montator i enëve nën presion, pasi për shkak të aftësive të tij, vazhdon të kërkohet nga shumë subjekte që ndërtojnë HEC në vendin tonë dhe që sigurisht është paguar edhe në të zezë (kjo jo për faj të tij).

*Gjithsesi dua të sqaroj se në momentin që u martua djali, unë jo vetëm se nuk mund të dija që pas disa vjetësh do të kryhej procedura *Vetting*, por dhe nuk do të ishte as e logjikshme dhe as e moralshme që t’i kërkoja nuses së djalit se ku i gjeti babai yt lekët që të ka dhënë si pajë. Sigurisht që edhe po ta dija që do bëhej *Vettingu* përsëri nuk mund t’i kërkoja llogari nuses së djalit për mënyrën se si i kishte përfituar babai i saj paratë. Ju garantoj se këtë jo që nuk mund ta bëja, por nuk besoj se ka ndonjë prind që do ta bënte një gjë të tillë.*

Por, pavarësisht nga sa theksuam më sipër, ndryshe nga sa arsyeton Komisioni, në Komision kam depozituar një sërë dokumentesh me të cilat provohet se prindërit e bashkëshortes kanë pasur mundësi për të bërë këtë dhuratë. Është provuar se për këtë periudhë prindërit kanë pasur të ardhura të ligjshme, të cilat justifikojnë këtë vlerë. Konkretisht, babai i S ka punuar si montator i enëve nën presion edhe pse ka qenë në pension. Ai, si mjeshtër i rrallë i kësaj pune, është marrë nga firma të ndryshme për ndërtimin e HEC duke bërë pagesën në bankë. Për këtë ju kemi paraqitur edhe dokumentacionin përkatës të bankës ku janë bërë kalimet për pagat e siguruara. Nga ky dokumentacion rezulton se për vitin 2005 është kaluar në bankë shuma prej 228.489 lekësh,

në vitin 2006 shuma 449.509 lekë, gjatë vitit 2011 shuma 71.512 lekë. Kështu ka rezultuar se në vitin 2009 kanë pasur depozitë në shumën 528.617 lekë. Në vitin 2012 kanë pasur depozitë në shumën 462.931 lekë. Po kështu gjatë vitit 2013 depozita dhe kalimet e pagës nga shoqëritë ku ka punuar kapin shumën prej 1.011.518 lekësh. Gjatë vitit 2014 përveç pensionit të babait të saj i ka kaluar edhe shuma e pagës prej 167.202 lekësh.

*Po kështu, për periudhën 2005 – 2011 nga shoqëria ‘E’ sh.p.k. ai është paguar cash në shumën 516.000 lekë. Ky fakt provohet edhe me vërtetimin nr. *** prot., datë 24.6.2020⁸³, të lëshuar nga kjo shoqëri. Po kështu, për periudhën 2011 – 2013 ka punuar pranë shoqërisë I.R.Z. sh.p.k. dhe është paguar në shumën 1.320.000 lekë.*

*Gjithashtu sikundër provohet edhe me deklaratën noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.10.2016⁸⁴, si dhe të deklaratës noteriale nr.*** rep., nr. ***kol., datë 12.7.2020⁸⁵, të lëshuar prej prindërve të saj, provohet se pjesë e shumës së bërë dhuratë kanë qenë edhe dhuratat e bëra me rastin e dasmës, si dhe dhurata e tezes së djalit në shumën 3.500 USD.*

Sa më lart, kanë qenë shpjegime, të cilat i kam marrë nga prindërit e bashkëshortes së djalit tim madhor, të ndarë nga certifikata ime familjare, në kuadrin e bashkëpunimit me Komisionin, me qëllim sqarimin e çështjeve të ngritura, por për vërtetësinë e deklarimeve dhe shpjegimeve nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi subjekti, pasi prindërit e bashkëshortes së djalit tim madhor nuk janë subjekte të ligjit nr. 84/2016.

Sipas pikës 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” “person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit.

Sipas pikës 14, të nenit 3, të ligjit të sipërcituar “persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.”

8.28 Në rastin konkret, prindërit e bashkëshortes së djalit madhor, i cili nuk është në gjendje familjare me subjektin e rivlerësimit, të cilët nga ana e tyre nuk janë në një certifikatë të gjendjes familjare me djalin e subjektit, nuk mund të cilësohen si “persona të lidhur” me subjektin e rivlerësimit apo si “persona të tjerë të lidhur” me të. Prindërit e bashkëshortes së djalit madhor nuk përfshihen në rrethin e personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, rreth i cili është përcaktuar në mënyrë enumerative në nenin 3/13 të ligjit nr. 84/2016.

⁸³ Për më tepër, shihni vërtetimin e lëshuar nga administratori i shoqërisë “E” sh.p.k., me nr. *** prot., datë 24.6.2020 dhe vërtetimin e datës 14.7.2020, të lëshuar nga administratori i shoqërisë I.B.Z., të cilët do t’i gjeni bashkëngjitur këtij raport.

⁸⁴ Për më tepër, shihni deklaratën noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.10.2016, të cilin e gjeni bashkëngjitur këtij raport.

⁸⁵ Për më tepër, shihni deklaratën noteriale me nr. ***rep., nr. *** kol., datë 12.7.2020, të cilin e gjeni bashkëngjitur këtij raport.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

8.29 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

8.30 Djali i subjektit të rivlerësimit/z. I.S, në momentin e blerjes së apartamentit në vitin 2014 konsiderohet person i lidhur me subjektin e rivlerësimit, pasi ka qenë në përbërjen familjare të tij së bashku me bashkëshorten⁸⁶. Subjekti i rivlerësimit, në DPV-në e vitit 2014, deklaroi se ka blerë një banesë në emër të djalit I. S, me vlerë 53.000 euro dhe me pjesë takuese së bashku me familjen. Te seksioni i të ardhurave ka deklaruar të ardhura të sjella nga bashkëshortja e djalit në shumën 1.600.000 lekë.

8.31 Fakti që kjo pasuri është krijuar gjatë kohës që djali i subjektit ka qenë në një familje me subjektin, sipas certifikatës familjare, duhet t'i nënshtrohet hetimit administrativ për të ardhurat që kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie.

8.32 Referuar analizës financiare të kryer për periudhën 2011 – 2014, të paraqitur në tabelën e mësipërme, subjekti i rivlerësimit edhe pas prapësimeve të tij në përgjigje të barrës së provës rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme në shumën - 3.754.249 lekë⁸⁷, në kohën e blerjes së këtij apartamenti në vitin 2014.

8.33 Në konkluzion të sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion ligjor për vitin 2014, kohë kur është blerë dhe mobiluar apartamenti, me një balancë negative në shumën 3.754.249 lekë, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 33, pika 5, gërma “b” e ligjit nr. 84/2016.

9 Banesë në përdorim në Rr. “Xh. Gj”, Vlorë

9.1 Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka banesë në përdorim⁸⁸ me sip. 74.7 m², me adresë: Rr. “Xh. Gj”, lagjja “** N”, p. **, k. **, Vlorë, në pronësi të shtetasit D.H, e përdorur pa kundërshpërblim.

9.2 Në dosjen e ILDKPKI-së rezultoi një deklaratë noteriale me nr. ** rep., nr. ** kol., datë 10.1.2017, lëshuar nga shtetasi D.H, pronari i apartamentit me sip. 74.7 m², të ndodhur në pallatin nr. **, me nr. pasurie ****, z. k. **, vol. **, f. **, nga ZVRPP-ja Vlorë. Deklaruesi ka parashtruar në akt se është pronar i apartamentit me nr. pasurie **, në Vlorë, të cilin ia ka dhënë në përdorim shtetasit Hysen Saliko, për periudhën 8.11.2016 – fundkorrik 2017. Ky apartament është privatizuar në vitin 1993, sipas ligjit për privatizimit dhe nuk përdoret nga pronari për shkak se jeton në Tiranë. Shtetasi Hysen Saliko do të mbartte detyrimin për të paguar vetëm shpenzimet e konsumit të energjisë elektrike dhe të ujit, të përdorur për nevojat personale. Bashkëlidhur

⁸⁶ Referuar DPV-së së vitit 2014, f. 2.

⁸⁷ Referojuni arsyetimit ligjor në pikën 3 të këtij vendimi “Të ardhurat nga bujqësia, bletaria dhe pemëtaria”, konkluzioni i trupit gjykues.

⁸⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën, deklaratë noteriale nr. ** rep., nr. **kol., datë 10.1.2017.

certifikata e pronësisë nr. **** e apartamentit me nr. pasurie ***, në Vlorë, në pronësi të shtetasve D. H dhe M. H dhe kopje karte identiteti të deklaruesit.

9.3 Sipas deklaratës noteriale, lëshuar nga z. D. H, ka rezultuar se ka filluar ta përdorë këtë pasuri vetëm më 8.11.2016, deri në korrik të vitit 2017. Subjekti, në pyetësor, deklaroi se ka banuar në këtë adresë në periudhën janar 2012 – nëntor 2016.

9.4 Gjithashtu, nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se z. D. H ka ushtruar aktivitet privat, i regjistruar si Person Fizik me objekt veprimtarie “aktivitet juridik”, ku në vitin 2015, e ka regjistruar si vend të ushtrimit të aktivitetit në adresën: Rr. “Xh. Gj”, lagjja “** N”, p.***, k. **, Vlorë. Ky aktivitet është çregjistruar në datën 27.5.2015.

9.5 Komisioni hetoi për konfliktin e interesit në lidhje me shtetasin D. H duke i kërkuar informacion Gjykatës së Apelit Vlorë, nëse ky shtetas ka pasur procese gjyqësore personale, ku në përbërje të trupës gjyqësore ka qenë subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Saliko.

9.6 Gjykata e Apelit Vlorë⁸⁹ ka informuar se shtetasi D. H ka pasur çështje gjyqësore civile personale, por nuk ka rezultuar që subjekti Hysen Saliko të ketë gjykuar këto çështje.

9.7 Gjykata e Apelit Vlorë⁹⁰ ka informuar se nga verifikimi në arkiv, deri më 25.5.2010 (kohë në të cilën është emëruar gjyqtari Hysen Saliko), rezultoi vetëm vendimi nr. ***, datë 2.8.2010 (kryesues Hysen Saliko), ku përfaqësuesi i të dyshuarit S. N, ka qenë avokati D. A.

9.8 Nga vendimi i depozituar nga Gjykata e Apelit Vlorë, rezulton se z. D. A (nuk është e qartë nëse bëhet fjalë për të njëjtin person/avokat sepse Komisioni ka kërkuar informacion për shtetasin D. H) ka qenë përfaqësuesi ligjor i z. S.N, akuzuar për veprat penale “vrasje me dashje” dhe “plagosje e rëndë me dashje” me objekt të kërkesës: “1. vlerësimin e ligjshëm të ndalimit të shtetasit S. N; dhe 2. caktimin e masës së sigurimit arrest me burg”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë kishte vendosur: “1. pranimin e kërkesës; 2. vlerësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë në ngarkim të shtetasit S.N; dhe 3. caktimin e masës së sigurimit arrest me burg”. Ndaj këtij vendimi, kishte paraqitur apel i ndaluarit S. N. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. **, datë 2.8.2010, ka vendosur miratimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

9.9 Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoj subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se duket se subjekti ka vepruar në kundërshtim me kodin e etikës së gjyqtarit, duke përdorur shtëpinë e një avokati, pa kundërshtim.

9.10 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera deklaroi se: “... sikundër kam deklaruar edhe në deklaratën e vetëdeklarimit, por edhe në pyetësorin elektronik standard dhe në përgjigje të e-mail-it të datës 4.3.2019, kam përdorur së bashku me kolegun tim A. C në periudhën janar 2012 – nëntor 2016, 1 - 2 ditë/javë banesën e shtetasit D. A (që është vjehëri i kolegut A. C). Nënvizoj faktin se pasuria është lënë në përdorim prej pronarit pa kundërshtim për shkak se në të flinte edhe dhëndri i tij dhe se unë kam fjetur aty me ftesë të kolegut, me të cilin udhëtonim së bashku nga Tirana për në Vlorë. Ka qenë dhëndri

⁸⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2020.

⁹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2020.

i tij, z. A. C që më ka ftuar që të flemë së bashku, pasi edhe rrugën Tiranë-Vlorë e bënim së bashku. E kush nuk do ta bënte këtë për një koleg, për sa kohë që në banesë banonte vetëm ai? Po kështu, këtë banesë kam vazhduar ta përdor i vetëm 1 - 2 ditë/javë edhe për periudhën nëntor 2016 - qershor 2017. Për këtë kam pranuar ta përdor pa kundërshtim. Kaq do e bëja edhe unë për një koleg nëse do kisha banesë në Vlorë që nuk e përdorte familja ime. Sqaroj gjatë se kësaj periudhe për periudhën 15 korrik-31 gusht të çdo viti nuk e kemi përdorur për asnjë ditë këtë banesë.

Me avokatin jam njohur vetëm pas datës 10 janar të vitit 2012 kur kemi shkuar për të banuar në banesën e tij dhe që nga datë deri më sot nuk kam zhvilluar asnjë proces gjyqësor ku shtetasi D. H (i njohur si avokat me emrin D. A të jetë palë ose avokat).

*Vendimi që i referohet Komisioni, ku shtetasi D.H ka qenë përfaqësues ligjor i z. S.N, akuzuar për veprën penale “vrasje me dashje”, dhe “plagosje e rëndë me dashje” me objekt të kërkesës: “1. Vlerësimin e ligjshëm të ndalimit të shtetasit S.N; dhe 2. Caktimin e masës së sigurimit arrest me burg”. Ka rezultuar e provuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, kishte vendosur: “1. Pranimin e kërkesës; 2. vlerësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë në ngarkim të shtetasit S. N; dhe 3. caktimin e masës së sigurimit arrest me burg”. Ndaj këtij vendimi kishte paraqitur apel i ndaluarit S.N dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, të datës 2.8.2010, ka vendosur miratimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

Nisur nga rrethanat e mësipërme i parashtroj Komisionit se në rastin konkret jo vetëm që nuk ka konflikt interesi, por as veprim që vjen në kundërshtim me Kodin e Etikës. Së pari, unë kam filluar të jetoj në banesën e tij nga janari i vitit 2012 e në vazhdim. Në momentin e shqyrtimit të çështjes së veçantë penale unë nuk kam pasur njohje me avokatin, njohja ka filluar për shkak se kolegu im ishte dhëndri i tij. Së dyti, edhe vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit ndonëse vjen me ankimin e klientit të avokatit është lënë në fuqi, duke mos u pranuar ankimi i tij. Pra, nuk gjendemi para një konflikti faktik të interesit, pasi interesi faktik i zyrtarit nuk rezulton se ka ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi shtetërore në kuptim të germës ‘a’, të pikës 4, të nenit 3, të ligjit. Parimi i interesit të supozuar të gjyqtarit, që mund të ngrejë dyshime për ekzistencën e një konflikti në dukje të interesit, nuk ka ndodhur dhe as ka pasur mundësi të ndodhë, pasi vendimi gjyqësor nuk ka asnjë ndikim mbi interesat e supozuara të gjyqtarit dhe se nuk rezulton ndonjë lidhje mes interesit të supozuar dhe vendimmarrjes gjyqësore konkrete, e tillë që ajo, për këtë shkak dhe vetëm për të, të jetë e padrejtë. Po kështu, nuk gjendemi përpara një konflikti të mundshëm të interesit, sepse interesi i supozuar nuk ekziston tashmë dhe as nuk ekziston mundësia që në të ardhmen të vihet në diskutim shfaqja ose jo e një interesi faktik ose konflikti në dukje, pasi tashmë jo vetëm që nuk jetoj më, por dhe se vetë shtetasi D. H nuk e ushtron këtë aktivitet që prej vitit 2015.

Gjithashtu, bazuar në nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në Kodin e Etikës Gjyqësore, në rregullin 12 të tij, në momentin e shqyrtimit të kërkesës së veçantë penale nuk ekzistonte asnjë shkak për të deklaruar dorëheqjen nga gjykimi i çështjes. Gjithashtu, sipas Kodit të Etikës, me vendimmarrjen time në këtë rast, vërtetohet që nuk kam qenë i influencuar në ushtrimin e detyrës”.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

9.11 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

9.12 Mes subjektit të rivlerësimit dhe avokatit D. A provohet ekzistenca e lidhjes së interesit, në kuptim të përkufizimit të dhënë në pikën 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, si pasojë e përdorimit pa kundërshtim të apartamentit në Vlorë, në pronësi të z. D. A, ku dhe subjekti deklaroi se e ka përdorur për periudhën 2012 – 2016. Komisioni, i ndodhur në këto rrethana, vlerëson se fakti që ka një lidhje interesi, bën që të identifikohet nëse subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit me avokatin D.A.

9.13 Nga shqyrtimi në tërësi i marrëdhënies së interesit, rezultoi se: (i) nuk është para një konflikti faktik të interesit, pasi interesi faktik i zyrtarit nuk rezultoi se ka ndikuar apo mund të ndikojë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë shtetërore në kuptim germës “a”, të pikës 4, të nenit 3, të ligjit mbi Konfliktin e Interesit; (ii) parimi i interesit të supozuar të gjyqtarit, që mund të ngrejë dyshime për ekzistencën e një konflikti në dukje të interesit, nuk ka ndodhur dhe as ka pasur mundësi të ndodhë, pasi vendimet gjyqësore nuk kanë asnjë ndikim mbi interesat e supozuara të gjyqtarit dhe se nuk rezultoi ndonjë lidhje mes interesit të supozuar dhe vendimmarrjes gjyqësore konkrete, e cila ka qenë në vitin 2010 ndërkohë që gjyqtari ka filluar përdorimin e apartamentit në vitin 2012.

9.14 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se fakti që pronari i apartamentit, që subjekti i rivlerësimit përdorte pa kundërshtim, ishte avokat i dhomës së avokatisë Vlorë dhe ndiqte çështje në Gjykatën e Apelit Vlorë, ku subjekti ushtronte detyrën, konsiderohet si konflikt në dukje interesi, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 3, paragrafi 4, shkronja “b” e ligjit “Mbi parandalimin e Konfliktit të Interesit”.

10 Gjetje të tjera

10.1 Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se referuar përgjigjes së depozituar nga Urdhri i Infermierit të Shqipërisë⁹¹, rezultoi se shtetasi Hysen Saliko ka qenë i punësuar me kohë të pjesshme, në këtë institucion, me kontratë që nga data 25.10.2009 deri në vitin 2011. Në të njëjtën kohë, subjekti ka qenë i punësuar si inspektor në KLD, si dhe më pas gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, që nga data 25.10.2010.

10.2 Kontrata e punësimit të subjektit në këtë institucion, sipas të cilit rezultoi një aktmarrëveshje (për punësim të jashtëm) e datës 25.10.2009 dhe referuar kësaj aktmarrëveshjeje z. Hysen Saliko, në cilësinë e konsulentit juridik do të kryente detyra si dhënie konsulence, trajnime dhe seminare të stafit të UISH-it, në bazë, qarqe dhe rrethe. Kontrata nënshkruhet për një afat maksimal prej 2 vitesh.

⁹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2020.

10.3 Në lidhje me punësimin te Urdhri i Infermierit, subjekti ka shpjeguar se⁹²: “Sqaroj se me këtë institucion në datën 25.10.2009 kam lidhur një marrëveshje për të dhënë disa orë në javë trajnime për stafin e institucionit në qendër dhe rrethe të shtunë dhe të diel. Sipas marrëveshjes që ka filluar të implementohet në muajin nëntor të vitit 2009 (kohë kur kam qenë inspektor në KLD) dhe ka vazhduar deri në datën 22.7.2011, kohë kur i jam drejtuar UISH-it me kërkesën për ndërprerjen e marrëveshjes së lidhur. Gjatë kësaj periudhe kam kryer trajnime dhe seminare të ndryshme si në Tiranë, ashtu edhe në shumë qarqe të Shqipërisë, në lidhje me legjislacionin penal (tema mbi mjekimin e pakujdesshëm, dhënien e mjeteve për ndërprerjen e shtatzënisë, mosdhënia e ndihmës etj.), tema në të cilat jam ndalur kryesisht në penalizimin e infermierëve në rastet e mospërmbushjes së detyrës funksionale. Po kështu, kam kryer trajnime në lidhje me ligjet nr. 9178/2007 dhe 10171/2010. Në çdo rast kam përmbushur marrëveshjen sipas kërkesës së bërë nga stafi i UISH-it”. Pas përfundimit të punësimit nga subjekti te Urdhri i Infermierit, këtë punësim e ka fituar djali, z. I. S.

10.4 Nga faktet e analizuara, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit se subjekti ka ofruar edhe konsulencë juridike pranë Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë, që bie ndesh me detyrën e gjyqtarit.

10.5 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se: “Mësimdhënia dhe trajnimi në kohën që e kam kryer nuk ka qenë e ndaluar për pozicionin e punës që unë kam pasur. Kështu nga nëntori i vitit 2009 deri më 25.5.2010 kam qenë Inspektor i KLD-së dhe pas kësaj date kam qenë gjyqtar Apeli. Unë kam dhënë mësim dhe mësimdhënia nuk ishte një funksion i ndaluar nga ligji dhe njëherazi gjatë kësaj periudhe nuk kërkohej që të merrej leje nga KLD-ja, por, pavarësisht kësaj kam vënë në dijeni zëvendëskryetarin. Rregullat për lejimin e mësimdhënies u parashikuan me vendimin e KLD-së nr. 278/2, datë 19.7.2011. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, unë kam ndërprerë menjëherë mësimdhënien duke paraqitur kërkesë në UISH, në datën 22.7.2011, duke zgjidhur marrëveshjen e lidhur dhe duke mos kërkuar që të pajisem me leje nga KLD-ja. Ndërprerjen e kam bërë edhe për shkak të ngarkesës në punë. Në pikën 2 të këtij vendimi parashikohet se: ‘2.1.Gjyqtari është i lirë të kryejë ato veprimtari që përbëjnë shprehje të lirive themelore, siç janë liria për të shprehur mendimin me shkrim dhe me gojë, në mënyrë publike, bashkëpunim me gazetatat, revistat, enciklopeditë, punime shkencore ose pjesëmarrjes si folës në seminare, konferenca, takime studimore ose veprimtari të ngjashme, që nuk nënkuptojnë punësim të mirëfilltë. Kjo vlen dhe në fushën e veprimtarisë ndërkombëtare për institucione ose organe ndërkombëtare, ku Shqipëria është anëtare. Gjithashtu, gjyqtarët gëzojnë lirinë e pjesëmarrjes në veprimtari vullnetare, vetëm ose në bashkëpunim me shoqata private, organizata jofitimprurëse apo fondacione, nëse ata nuk janë të punësuar në këto organizma dhe nuk përfshihen në menaxhimin e tyre apo të aseteve të tyre. 2.2. Në çdo rast, duke marrë në konsideratë specifikat e këtij funksioni, gjyqtari duhet të vlerësojë pajtueshmërinë e çdo veprimtarie, duke pasur parasysh faktin që ato kryhen pa cenuar nevojat e shërbimit’. Në rastin tim kryerja e veprimtarisë ka qenë në përputhje me parashikimin e bërë në vendimin nr. 278/2, datë 19.7.2011, të KLD-së.

⁹² Në përgjigjet e pyetësorit të datës 4.2.2020.

Mësimdhënia nga ana ime është bërë edhe në respektim të parashikimit të bërë në pikën 5.1, të vendimit nr. 278/2, datë 19.7.2011, të KLD-së. Në këtë pikë parashikohet se: ‘Gjyqtarët mund të përfshihen në procesin e mësimdhënies brenda limit kohor javor deri në 6 (gjashtë) orë akademike brenda orarit zyrtar duke marrë për bazë vendbanimin, vendin e ushtrimit të detyrës dhe vendin e veprimtarisë akademike. Në çdo rast, gjyqtari nuk mund të përfshihet në më shumë se 2 institucione të arsimit të lartë në 1 vit akademik.’⁹³

Ndërkohë që në lidhje me mospasyrimin e këtyre pagesave, ju deklaroj me përgjegjësi që ka qenë veçse harresë nga ana ime, pasi këto të ardhura janë marrë me bankë dhe janë paguar rregullisht për trajnimet e kryera në fundjavë stafit infermier dhe jo për dhënie konsulence juridike, veprimtari kjo e papajtueshme me statusin e gjyqtarit apo inspektorit të KLD-së.”

Subjekti, për këtë gabim njerëzor dhe krejt të paqëllimshëm të kryer në deklaratat e tij të para, që nuk cenon as ligjshmërinë e burimit të këtyre të ardhurave dhe as shumën e tyre, ka dhënë shpjegime me shkrim në korrespondencën me Komisionin. Konkretisht, në shpjegimet me shkrim, të dërguara Komision në datën 4.2.2020, nisur prej tij me e-mail-in e datës 10.2.2020, lidhur me këtë konstatim subjekti ka pranuar gabimin njerëzor dhe krejtësisht të paqëllimtë të tij dhe shprehet se është një harresë, pasi nuk kishte pse të mos e bënte për sa kohë ajo vetëm pozitivisht do të ndikonte në të ardhurat dhe, për rrjedhojë, edhe në bilancin financiar.

Arsyetimi ligjor në lidhje me provat dhe ligjin e zbatueshëm

10.6 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) provat shkresore të administruara sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

10.7 Pretendimi i subjektit se ka dhënë mësim dhe mësimdhënia nuk ishte një funksion i ndaluar nga ligji dhe njëherazi gjatë kësaj periudhe nuk kërkohej që të merrej leje nga KLD-ja, nuk qëndron, pasi referuar provave të administruara gjatë hetimit, rezulton se objekti i aktmarrëveshjes ka qenë dhënia e konsulencës ligjore, përkundrejt pagesës.

10.8 Fakti që subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar një aktmarrëveshje me Urdhrin e Infermierit të Shqipërisë, si i punësuar për konsulencë juridike, kundrejt pagesës nga data 25.10.2009 deri në vitin 2011, është në kundërshtim me nenin 143 të Kushtetutës, i cili parashikon se: “[...] *Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë [...] veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës [...]*”.

10.9 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjatë angazhimit për dhënie e konsulencës juridike për urdhrin e infermierit, përkundrejt pagesës, ndërkohë që ishte gjyqtar, nuk është në përputhje me nenin 143 të Kushtetutës, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016

Konkluzioni për rivlerësimin e pasurisë

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë pasuritë e tij sipas pikave 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të përmendura në këtë vendim, referuar paragrafit 3, të nenit D, të Aneksit të

⁹³ Ndryshuar me vendimin nr. 43, datë 29.4.2015, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 278/2, datë 19.7.2011, “Për veprimtarinë akademike të gjyqtarëve”, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Kushtetutës, si dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, gërmat “a”, “b”, “ç”, “d” të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Subjekti ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurive, në kuptim të gërmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e konfliktit të ineteresit duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 3, paragrafi 4, shkronja “b” e ligjit “Mbi parandalimin e Konfliktit të Interesit” dhe sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, gërmat “d” të ligjit nr. 84/2016.

Të gjitha konkluzionet e marra së bashku përbëjnë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të pa përshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës, për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *, datë 8.1.2019, raportin e Grupit të Punës nr. ***, datë 2.11.2017, ku ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, z. Hysen Saliko, për vazhdimin e detyrës së gjyqtarit.

2. Pavarësisht këtij konstatimi, Komisioni ka hetuar në lidhje me pastërtinë e figurës, duke i kërkuar informacion Prokurorisë së Përgjithshme për procedime të iniciuara ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Hysen Saliko, e cila informon se: “... në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda⁹⁴ Tiranë, në regjistrin elektronik të njoftimit të veprave penale të kësaj prokurorie, nuk rezulton që në emër të shtetasit Hysen T. Saliko, të jetë regjistruar ndonjë procedim penal”.

3. Ndaj subjektit është regjistruar kallëzim me nr. ***, viti 2017, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit. Nga verifikimi i akteve të materialit kallëzues rezulton se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, është regjistruar materiali i kallëzimit penal nr. ***, datë 6.9.2018, nga shtetasi M. I, për veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç. Pas kryerjes së veprimeve verifikuese, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, më 19.9.2018, në bazë të gërmës “ç” të nenit 290 dhe nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018.

4. Gjithashtu, Prokuroria e Durrësit⁹⁵ informon se në këtë Prokurori është depozituar materiali kallëzues i shtetasit A. Q, i paraqitur pranë Prokurorisë për Krime të Rënda, e cila në referim të nenit 78 të Kodit të Procedurës Penale, e ka përcjellë për kompetencë në këtë prokurori material i

⁹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2019.

⁹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.2.2019.

regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale nr. ***, datë 21.12.2018. Bashkë me subjektin e rivlerësimit janë kallëzuar nga shtetasi A. Q, për veprën penale “shpërdorim detyre” dhe disa subjekte të tjera rivlerësimi për vendimmarrje të tyre, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor dhe të Apelit Vlorë si dhe Gjykatën e Lartë. Pas hetimit të kryer nga Prokuroria e Durrësit, bazuar në germën “ç” të neneve 290.1 dhe 291.1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale është vendosur mosfillimi i procedimit penal për materialin e kallëzuar nga shtetasi A. Q, regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale nr. ***, datë 21.12.2018.

5. Referuar paragrafit 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, është parashikuar se: *“Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënues ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikë së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose se pse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet”*. Duke analizuar për sa më sipër, Komisioni konstaton se gjykata ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

6. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe të integritetit të subjektit të rivlerësimit, z. Hysen Saliko, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ, i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

7. Gjatë hetimit administrativ Komisioni nuk ka pasur të dhëna apo *indicie* nga cilido burim i ligjshëm në lidhje me kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti i përgatitur nga Grupi i Punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor

1. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor , si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së.

3. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit: aftësitë profesionale; aftësitë organizative; etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

4. Referuar raportit konstatohet se në lidhje me:

Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore - subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Saliko, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Përgjithësisht përdor parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës, në vendimet përfundimtare i referohet detyrave të gjykatave më të larta në rigjykimin e çështjes. Evidenton rastet kur për zgjidhjen e çështjes i referohet ligjit të veçantë apo akteve nënligjore, evidenton rastet e efektit të vendimit penal mbi atë civil;

Arsyetimi ligjor - subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Saliko, ka aftësi në drejtim të arsyetimit ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme, respekton rregullat e drejtshkrimit në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe përdor rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe.

Aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë – subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Saliko, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Vlorë, duke punuar në fushën e së drejtës penale dhe civile, pasi kjo gjykatë nuk ka qenë e organizuar në dhoma të veçanta gjykimi. Subjekti ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim gjithsej 989 çështje (për periudhën 2014 – 2016) dhe ka përfunduar si relator 972 çështje dhe ka mbartur në vitin e fundit të detyrës 7 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 96.2 %. Gjithashtu ka deklaruar se për periudhën 2014 – mars 2016 ka marrë 50 % të ngarkesës, për shkak se ka qenë anëtar i KLD-së. Aneksi 1 i Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, konstatohet se ngarkesa e tij ka qenë mbi standardin sasior.

Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore – subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Saliko, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Dosjet penale të vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej tij, bazuar në nenin 426 të të Kodit të Procedurës Penale.

Aftësia për të administruar dosjet – nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se aktet themelore përgjithësisht janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Në këto pesë dosje janë konstatuar edhe disa mangësi, që janë të njëjta, që tregon se bëhet fjalë edhe për metodologji pune. Kështu, në katër dosjet gjyqësore të vëzhguara nuk ka akte që dokumentojnë caktimin e seancës së parë gjyqësore, relatimi i gjyqtarit bëhet verbal dhe përmbledhet me një frazë të përgjithshme në procesverbal.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Hysen Saliko. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Saliko, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara

konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Hysen Saliko, për të cilin në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara, nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve, por as edhe për anëtarët e trupit gjykues. Në aktet e vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – në aktet e vëzhguara është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Në asnjë rast nuk rezultoi që të dështonte ndonjë seancë, për shkak të mungesës së një anëtari të trupit gjykues apo moskoordinimit midis relatorit dhe anëtarëve të trupit gjykues, në lidhje me organizimin dhe planifikimin e punës. Si rezultat, bashkëpunimi mes gjyqtarit Hysen Saliko me anëtarët e trupit gjykues rezultoi të ketë qenë korrekt. Rezultoi se gjyqtari, në kuadër të angazhimit profesional, i ka kushtuar një vëmendje të konsiderueshme edhe ngritjes profesionale në nivel akademik. Kështu, gjyqtari Hysen Saliko ka ndjekur studimet pasuniversitare në Fakultetin e Drejtësisë, në Departamentin e së Drejtës Civile, në vitet 2006 – 2009, ku është diplomuar *Master* pas mbrojtjes së mikrotezës me temë “Regjimet pasurore martesore”. Rezultoi gjithashtu, se që prej datës 5.2.2014 e në vijim, gjyqtari është në vazhdim të programit të studimeve të Doktoraturës, pranë Departamentit të së Drejtës Civile, të Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës. Gjyqtari Hysen Saliko ka ushtruar edhe detyrën e anëtarit të KLD-së, i zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.

Në përfundim të raportit nga KLGj-ja, sipas të dhënave nga burime arkivore në regjistrin e procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Hysen Saliko përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: raportit për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga KLGj-ja dhe në dokumentacionin bashkëlidhur tij; kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së.

Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLGj-ja, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni vlerëson se subjekti ka aftësitë kualifikuese për vlerësimin profesional.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

Denoncimet e publikut të depozituara në Komision

Në Komision janë administruar këto denoncime nga publiku, për subjektin e rivlerësimit, z. Hysen Saliko, si vijon:

1. Denoncim nr. * prot., datë 12.2.2019, depozituar nga z. Ll. Xh**

1.1 Denoncuesi pretendon se para pak kohësh ka bërë një kontratë paraprake për shitjen e banesës në O, me një qytetar nga Fieri. Kontrata parashikonte që pasi z. Ll. Xh të legalizonte dhe hipotekonte shtëpinë do të lidhte kontratën përfundimtare me qytetarin. Personi që do të blinte shtëpinë i ka dhënë një kapar prej 20.000 euro. Nëse shtetasi tërhiqej, do t'i jepte dyfishin, 40.000 euro.

1.2 Për disa muaj është marrë me letrat e shtëpisë, ku ka nxjerrë hipotekën dhe në këtë moment ka kontaktuar me blerësin. Por, blerësi i bëri një padi në gjykatë, ku kërkonte mbrapsht lekët e kaparit, plus penalitetet.

1.3 Procesi u zhvillua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, si dhe në Gjykatën e Apelit Vlorë. Në Gjykatën e Apelit janë zhvilluar disa seanca dhe në datën 29.1.2019, z. Ll. Xh nuk shkoi në gjyq. Bashkëshortja e tij dorëzon një raport mjekësor, për z. Ll. Xh, në mënyrë që gjyqi të shtyhet. Në fillim të shkurtit, z. Ll.Xh shkon në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe kërkon një vendim të hershëm të shkallës së parë, si dhe merr dosjen nga sekretarja dhe shikon një vendim të zbardhur të datës 29.1.2019, të 3 gjyqtarëve të Apelit Vlorë. Vendimi kishte numër regjistri themeltar dhe mungonin vetëm firmat. Qytetari e fotokopjon vendimin dhe pretendon se procesi është bërë fals, pasi seanca e datës 29.1.2019, nuk ishte zhvilluar dhe se gjithçka ka qenë e paramenduar.

1.4 Pas kësaj që ndodhi, denoncuesi takon edhe kryetarin e trupit gjykues, z. Hysen Saliko, i cili pranon që vendimi që ka në dorë qytetari, janë shënimet e tij. Pra, ka marrë vendim pa mbaruar gjyqi. Denoncuesi shton se subjekti Hysen Saliko i ka deklaruar se *do të shkojë në burg ai që ta ka dhënë*, ndërsa i përsërit disa herë që në seancën e ardhshme do të jetë një tjetër trup gjykues. Qytetari i kërkon vendimin, por gjyqtari nuk ia jep duke i thënë se “është imi”.

1.5 Në vijim rezulton se 3 gjyqtarët që kishin bërë vendimin, pa mbaruar gjyqi, kanë dhënë dorëheqjen. Gjykimi vijon me një tjetër trup gjykues, por nuk zhvillohet për shkak se një anëtar i trupit gjykues mungonte.

1.6 Denoncuesi ka depozituar procesverbalin e seancës së datës 29.1.2019, sipas të cilit bashkëshortja e z. Ll Xh, kishte depozituar një raport mjekësor për mosparaqitjen e tij, për këtë shkak seanca ishte shtyrë. Seanca tjetër ishte planifikuar të bëhej në datën 13.2.2019.

1.7 Gjithashtu, denoncuesi ka depozituar vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, të datës 29.1.2019, me trup gjykues të përbërë nga relator Hysen Saliko, dhe 2 anëtarët e tjerë K. Gj dhe S. D, i arsyetuar i përbërë nga 10 faqe. Në vendim rezulton palë ndërgjyqëse paditës Q. T dhe i paditur Ll.Xh, me objekt “zgjidhje e kontratës së kaparit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.12.2012, midis paditësit Q. T dhe të paditurit Ll. Xh, etj.”. Vendimi është i arsyetuar dhe trupi gjykues në

përfundim ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. ***, datë 18.9.2017.

1.8 Duke mos iu referuar vendimmarrjes përfundimtare të trupit gjykues, rezulton se gjykata ka marrë vendim përpara se të mbliidhet trupi gjykues dhe të kryer shqyrtimin gjyqësor të çështjes.

1.9 Ky fakt, i cili u bë edhe publik në media nga emisioni investigativ “Fiks Fare”, cenon parimin e një gjykate të pavarur dhe të paanshme dhe subjektin e rivlerësimit, i cili kishte hartuar një akt të tillë.

1.10 Referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e provave të paraqitura nga denoncuesi se vendimi i gjykatës me kryesues z. Hysen Saliko është marrë para se të kryhej shqyrtimi gjyqësor i çështjes.

1.11 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të rezultateve të hetimit kryesisht, deklaroi se: *“Siç është konstatuar, nga ana ime si gjyqtari relator, i caktuar me short elektronik, bazuar në nenin 460/2 të Kodit të Procedurës Civile, është caktuar data dhe ora e zhvillimit të gjykimit dhe njoftimi i palëve për datën dhe orën e zhvillimit kryhet nëpërmjet shpalljes publike, e cila me urdhër të relatorit bëhet nga sekretarja e caktuar pranë tij.*

Ditën dhe orën e caktuar për zhvillimin e seancës gjyqësore, në datën 29.1.2019, bazuar në nenin 461 dhe 464 të Kodit të Procedurës Civile, unë me cilësinë e relatorit, pasi kam verifikuar paraqitjen e palëve, kam konstatuar se ankuesi z. Ll. Xh nuk është paraqitur, por është paraqitur bashkëshortja e tij, znj. S. Xh, e cila ka dorëzuar një raport mjekësor për bashkëshortin e saj, palën ankuese z. Ll. Xh. Për shkak të mungesës së ankuesit, Gjykata e Apelit, e kryesuar nga unë, relator Hysen Saliko, ka marrë vendim për shtyrjen e seancës gjyqësore për në datën 13.2.2019, ora 10:30.

Në eventualitet të paraqitjes së palëve, gjykimi do të vijonte me relacionin e çështjes nga relatori. Me qëllim që të relatojë çështjen, relatori njeh dosjen paraprakisht, ky është edhe qëllimi i ligjit, i cili në nenin 459 të tij, parashikon që Gjykata e Apelit nuk shqyrton shkaqe të tjera përveç atyre të parashtruara në ankimin me shkrim dhe mbi bazën e akteve të dosjes përgatit relacionin, të cilin duhet t’ua bëjë me dije dy anëtarëve të tjerë të trupit gjykues ditën dhe orën e seancës gjyqësore, sipas parashikimeve të nenit 464 të Kodit të Procedurës Civile.

Pra, përgatitja e një relacioni për çështjen, është detyrë e relatorit të çështjes dhe ky relacion bëhet me shkrim ose me shënime të pjesshme, ose në mënyrë të përmbledhur, në varësi të natyrës së punës së gjyqtarit respektiv. Ligji procedural civil nuk ka parashikuar formë konkrete, për pasojë është në autonominë e gjyqtarit mënyra e përgatitjes së relacionit. Neni 464 i Kodit të Procedurës Civile ka parashikuar detyrimin e relatorit të përgatisë një relacion, dhe në rastin konkret, unë në cilësinë e relatorit, pasi jam njohur me dosjen që më është caktuar me short elektronik për gjykim, kam përgatitur relacionin përkatës. Ky relacion nuk përbën ‘vendim gjyqësor’, nuk përmban nënshkrimin e relatorit apo të ndonjë anëtari të trupit gjykues, për pasojë nuk përbën akt procedural. Do të përbënte akt procedural, nëse Kodi i Procedurës Civile do të përcaktonte formën që duhet të kishte. Në rastin konkret, parashikohet vetëm detyrimi i relatorit të relatojë çështjen, kurse forma e relacionit është në vlerësim të gjyqtarit.

Në lidhje me këtë veprim timin, jam përpjekur t'ia shpjegoj palës ankuese, kur është paraqitur në sallën e gjykimeve dhe ka pretenduar se vendimi ishte paravendosur. I kam shpjeguar ankuesit z. Ll. Xh se publikimi i këtij relacioni, nëpërmjet shumëfishimit të tij apo fotokopjes prej një sekretareje gjyqësore është i ndaluar. Akti i përgatitur nga gjyqtari relator nuk është akt procedural, por janë shënime për përgatitjen e çështjes nga relatori, për pasojë nuk mund të publikohet apo shpërndahej në çfarëdo mënyre. Shpjegimet që i kam dhënë ankuesit, se akti i marrë prej tij, i përkiste relatorit, pasi ishte opinion i tij dhe jo vendim gjyqësor, kanë qenë në përputhje me detyrimin ligjor për ndalimin e publikimit të opinioneve gjyqësore pa marrë ato formën e një vendimi gjyqësor. Në lidhje me këto pengesa i jam referuar nenit 7 të ligjit nr. 96/2016 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', si dhe Kodit të Etikës së Gjyqtarit. Kjo shkelje, publikimi i opinionit të relatorit, nuk është kryer nga unë si relator i çështjes, që kam pasur për shqyrtim çështjen, por siç ankuesi ka pranuar publikisht, e ka marrë nëpërmjet një sekretareje gjyqësore në Gjykatën e Apelit.

Vlerësoj se përgatitja e relacionit të çështjes nga relatori është një veprim në përmbushje të rregullt të detyrës, pasi parashikohet në nenin 464 të Kodit të Procedurës Civile. Në përgatitjen e relacionit për çështjen nuk kam cenuar parimin e pavarësisë dhe të paanshmërisë, duke qenë se ky akt nuk duhet të ishte bërë publik, pasi i përkiste fazës së përgatitjes së çështjes, në zbatim të detyrimit të parashikuar në nenin 464 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjithashtu ju vë në dijeni se denoncuesi, z. Ll. Xh, ka paraqitur kallëzim penal për kryerjen e veprës penale 'shpërdorim detyre' të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ndaj relatorit dhe anëtarëve të trupit gjykues. Në lidhje me kallëzimin e tij, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë është vendosur 'mosfillim i procedimit penal nr. ***, datë 15.3.2019'.

Denoncuesi, z. Ll.Xh ka ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë vendimin e mësipërm dhe kjo gjykatë me vendimin nr. ****, datë 17.6.2019 ka vendosur: 'rrezimin e kërkesës së ankuesit Ll. Xh kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal me nr. ***, datë 15.3.2019, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si të pabazuar në prova dhe në ligj.'

Denoncuesi, z. Ll.Xh, ka ankimuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 1.10.2019 ka vendosur 'lënien në fuqi të vendimit nr. ****, datë 17.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë'.

Kundër këtij vendimi nuk është ushtruar rekurs, fakt i vërtetuar nga vërtetimi i datës 30.6.2020, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë⁹⁶.

Pra, veprimet e kryera prej meje në cilësinë e relatorit të çështjes civile që i përkiste subjektit denoncues z. Ll. Xh janë verifikuar nga prokuroria dhe më tej gjykatat kompetente dhe nuk janë gjetur elemente të veprës penale 'shpërdorim i detyrës', të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal".

Vlerësimi i Komisionit

1.12 Referuar denoncimit të paraqitur, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, Komisioni vlerëson se në këndvështrimin e situatës faktike, ku i padituri gabimisht ka marrë nga sekretaria gjyqësore një dokument, i cili është emërtuar "vendim"

⁹⁶Shihni vërtetimin e datës 30.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

për çështjen ku ishte palë e paditur në vendimin 29.1.2019, me arsyetim dhe dispozitivin ku trupi gjykues ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. ***, datë 18.9.2017, pra, në disfavor të paditësit, pikërisht ditën që do të zhvillohej seanca gjyqësore për çështjen në fjalë, por që u shty në datën 13.2.2019, ora 10:30, ky dokument dhe pse jo vendim përfundimtar duhet të analizohet në drejtim të ligjit të zbatueshëm dhe efektit që kjo gjetje ka në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

1.13 Në cilësinë e relatorit të çështjes, subjekti i rivlerësimit duhet të kujdeset për rregullshmërinë dhe saktësinë e dokumentacionit të dosjes gjyqësore. Fakti që në dosjen gjyqësore të çështjes në fjalë, subjekti i rivlerësimit administron një dokument, që në formë dhe përmbajtje është i njëjtë me vendimin përfundimtar, sipas kërkesave të nenit 126 të Kodit të Procedurës Civile, tregon se ky është një gabim i cili tregon se subjekti nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur për të administruar dosjen gjyqësore, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 174, të ligjit nr. 96/2016.

1.14 Gjithsesi, fakt i rëndësishëm në këtë rast është marrja e këtij dokumenti nga pala e paditur, i cili ka konstatuar se ka një vendim në lidhje me çështjen e tij, ndërkohë që nuk kishte zhvilluar seancën gjyqësore. Me të drejtë shtetasi ka denoncuar këtë rast në Gjykatën e Apelit Vlorë, në media dhe në Komision.

1.15 Në analizë të situatës konkrete, si pasojë e mosadministrimit të mirë të dosjes gjyqësore, duke administruar në dosje një dokument, i cili në formë dhe përmbajtje duket si vendim përfundimtar, në kohën kur akoma nuk ishte zhvilluar seanca gjyqësore, për pasojë duket se subjekti i rivlerësimit nuk është i paanshëm në gjykimin e kësaj çështje.

1.16 Subjekti i rivlerësimit bashkë me dy anëtarët e tjerë të trupit gjykues kanë dhënë dorëheqjen si rezultat i kësaj situatë, gjithsesi e parë në sytë e palës së paditur, kjo situatë cenon besimin te drejtësia.

1.17 Në konkluzion të analizës më lart, Komisioni arrin në përfundimin se pikërisht kjo rrethanë e krijuar, me pasoja të rënda për të paditurin, por edhe për faktin e bërjes publike të kësaj çështjeje ka cenuar besimin e të paditurit te subjekti i rivlerësimit, i cili përfaqëson dhënien e drejtësisë.

2. Denoncim nr. **** prot., datë 10.4.2020, depozituar nga “Raiffeisen Bank” sh.a.

2.1 “Raiffeisen Bank” sh.a., ka depozituar denoncim për tri subjekte rivlerësimi ndërmjet të cilëve edhe për subjektin Hysen Saliko, i cili ka qenë anëtarë (jo relator) i trupit gjykues në një çështje gjyqësore civile të shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Vlorë. Denoncuesi pretendon se në gjykimin e shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Vlorë është ndeshur me shkelje të Kodit të Procedurës Civile, shkelje të së drejtës themelore procedurale për t’u informuar për zhvillimin e procesit gjyqësor, ku është palë duke i mohuar kështu të drejtën për të parashtruar argumentet e saj të mbrojtjes.

2.2 “Raiffeisen Bank” ka qenë palë në një proces gjyqësor, ku ankues ka qenë shtetasi K.B dhe znj. E. L (përfaqësuesja e punonjësve të shoqërisë “E” sh.p.k.), si dhe kreditori “P.O” sh.p.k., përfaqësuar nga znj. O. B.

2.3 Objekti i ankimit “kundërshtim i vendimit të ndërmjetëm nr. *** regj. them., datë 13.6.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lidhur me mosmiratimin e planit të riorganizimit

të shoqërisë “E” sh.p.k.”, si dhe kundërshtimin e vendimit të ndërmjetëm nr. ** regj. them., datë 4.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së kreditorit duke pranuar kërkesën e z. K. B, përfaqësueses së punëtorëve të shoqërisë “E” sh.p.k., znj. E. L dhe shoqërisë “P.O” sh.p.k. për përcaktimin e vlerës së tregut të pasurive të shoqërisë “E” sh.p.k. në vlerën 2.226.822 euro”.

2.4 “Raiffeisen Bank”, për çdo gjykim ku është palë ndërgjyqëse, merr rregullisht listat e shpalljeve të gjykimeve pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Nga verifikimi i këtyre listave ka rezultuar se ky gjykim nuk është shpallur. Pra, në asnjë prej listave të shpalljeve nuk rezulton një proces me palët dhe objektin në fjalë.

2.5 Për këtë arsye, pas njohjes me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, ankuesi ka marrë procesverbalet e këtij gjykimi dhe pas analizimit të tyre pretendon se në listat e shpalljeve të gjykatës ka gabim dhe në vend të shpallet gjykimi në fjalë është shpallur një proces civil tjetër, ankim i vitit 2018, me kërkues “Raiffeisen Bank” sh.a. dhe objekt “shkarkim administratori falimenti”. Në këtë proces ankuesit nuk kanë pasur më interes në shkarkimin e administratorit pasi ishte avancuar për procesin e likuidimit dhe ankimi ka mbetur pa objekt.

2.6 Nga procesverbali i marrë në gjykatë rezulton se janë zhvilluar disa seanca në të cilat ka rezultuar sipas edhe procesverbaleve të seancave: (1) seanca e datës 3.12.2019 ka qenë afishuar në lista gabim me palën kërkuese “Raiffesien Bank” sh.a. dhe objekt “shkarkim administratori”. Në këtë seancë është ndryshuar trupi gjykues, duke pranuar dorëheqjen e gjyqtarës znj. K. Gj dhe për shkaqet e parashtruara më lart nuk kanë marrë pjesë; (2) seanca e datës 18.12.2019 ka qenë e afishuar në lista për zhvillimin në orën 8:45, ndërkohë në procesverbal rezulton të jetë zhvilluar në orën 11:38. Theksojmë që sërish palët kanë qenë të keqinformuara për palën kërkuese dhe objektin e saj, si dhe orari i gjyqimit është i gabuar/i pasaktë; (3) seanca e radhës e planifikuar në datën 19.12.2019, ora 9:36 nuk ka qenë e afishuar në listat e Gjykatës së Apelit, duke hequr kështu mundësinë për t’u informuar për këtë çështje civile; (4) po ashtu edhe seanca e radhës e planifikuar në datën 14.1.2020, ora 15:10, data kur është marrë dhe vendimi nuk ka qenë e publikuar në asnjë nga listat e afishuara nga Gjykata e Apelit Vlorë; (5) në përfundim, në seancën e datës 14.1.2020, gjykata me vendimin nr. ***ka vendosur: ndryshimin e vendimit të ndërmjetëm nr. *** regj. them. datë 13.6.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lidhur me mosmiratimin e planit të riorganizimit të shoqërisë “E” sh.p.k., duke miratuar planin e riorganizimit të saj, të paraqitur në datën 1.6.2010, nga debitori z. K. B; ndryshimin e vendimit të ndërmjetëm nr. *** regj. them., datë 4.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së kreditorit duke pranuar kërkesën e z. K. B, përfaqësueses së punëtorëve të shoqërisë “E” sh.p.k., znj. E.L dhe shoqërisë “P. O.” sh.p.k. Pranimin e vlerës së tregut sot të pasurive të shoqërisë “E” sh.p.k. në vlerën 2.226.822 euro.

2.7 Denoncuesi pretendon se gjykata ka gabuar disa herë:

i) Trupi gjykues ka gabuar në informimin e palëve për procesin gjyqësor nëpërmjet afishimit të listave dhe ka zhvilluar gjykim pa njoftuar (me anë të listave apo shpalljeve apo çfarëdo mjeti tjetër njoftimi të parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile) palë në “Raiffeisen Bank” sh.a. për këtë gjykim. Çështja për të cilët palët depozitojnë denoncim nuk ka kërkues “Raiffeisen Bank” sh.a. dhe objekti nuk është “shkarkim administratori”. Çështja civile e shqyrtuar nga ky trup gjykues është ankimi i z. K. B, etj., dhe me objekt “ankim për likuidimin e shoqërisë ‘E’ sh.p.k.

dhe ndryshimi i vlerës së pasurive të shoqërisë”. Denoncuesi pretendon se kjo del qartë edhe në vendimin e kësaj gjykate dhe në vendimmarrjen e tyre përfundimtare, ku kanë vendosur ndryshimin tërësisht të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor sa i takon likuidimit, duke riorganizuar shoqërinë, si dhe ndryshimin e vlerës së pasurisë duke e paraqitur 2-fish më shumë. Pra, vendimmarrja ka qenë plotësisht në favor të ankimuesve z. K B, etj. Informimi i palëve për çështjen është e drejtë thelbësore për të pasur një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

ii) Gjykata ka shkelur nenin 460 të Kodit të Procedurës Civile për afishimin të paktën 15 ditë para datës së gjykimit. Nga listat e shpalljeve të çështjes dhe procesverbaleve të gjykimit, rezulton se gjykata nuk e ka respektuar afatin 15-ditor të afishimit/publikimit të datave të seancave. Në seancat e planifikuara janë zhvilluar gjykime në datat 18.12.2019 dhe 19.12.2019. Në datën 18 dhjetor seanca është planifikuar në lista në orën 8:45, ndërkohë në procesverbale rezulton të jetë zhvilluar në orën 11:38 (përkon me një çështje tjetër me nr. ***, ku kanë qenë prezent për shqyrtimin e një çështjeje tjetër me relator P. A.) Këtu është hapur në kushtet e një shkeljeje të rendë të kryer nga trupi gjykues, pasi janë elementet e mashtrimit në procesverbalin dhe pasqyrimin e seancës. Nuk ka asnjë mundësi të zhvillohen 2 gjyqe njëkohësisht me pjesëmarrje nga i njëjti gjyqtar, P. A.

iii) Në këtë vendimmarrje ka shkelje të nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile. Sa i takon pikës së dytë të vendimmarrjes, për vlerën e pasurisë “linjë prodhimi e kartëpecetave”, ndeshen dy vendime të formës së prerë që janë dhënë midis të njëjtave palë, për të njëjtin shkak dhe me të njëjtin objekt, d.m.th. përbën “gjë të gjykuar”. Gjykata e Apelit del me një vendim të ndryshëm marrë më parë po nga kjo gjykatë. Pasuria “linjë prodhimi e kartëpecetave” me vendim të formës së prerë nr. ***, datë 7.11.2017 është vlerësuar me shumën 1.249.826 euro. Pjesë e këtij trupi gjykues ka qenë edhe gjyqtari P. A, ndërkohë me vendimin e sipërcituar, Gjykata e Apelit Vlorë ka marrë sërish në shqyrtim vlerën e kësaj pasurie duke e vlerësuar dyfish më të lartë në shumën 2.226.822 euro. Banka ka theksuar se pjesë e këtij trupi gjykues sërish ka qenë gjyqtari P. A.

2.8 Referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e provave të paraqitura nga denoncuesi se vendimi i gjykatës me anëtar z. Hysen Saliko ka shkelje të ndryshme procedurale.

2.9 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, në përgjigje të rezultateve të hetimit kryesisht, deklaroi se: *“Siç është konstatuar në çështjen konkrete kam qenë anëtar i trupit gjykues, jo relator. Bazuar në Rregulloren e funksionimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, regjistrimi i çështjeve në këtë gjykatë kryhet nga një sekretare regjistruese, nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e Kancelares së Gjykatës së Apelit Vlorë. Pas regjistrimit në regjistrin elektronik, të dhënat e hedhura në regjistr gjenerohen në çdo akt që mbart të dhëna për çështjen konkrete në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit. Pas regjistrimit në regjistrin elektronik, çështja shorohet elektronikisht dhe, më tej, i përcillet gjyqtarit relator.*

Praktika e përcjelljes së dosjes te gjyqtari relator është përgjegjësi e Kancelarit të Gjykatës së Apelit. Gjyqtari relator, në pavarësi të plotë, bazuar në nenin 460 të Kodit të Procedurës Civile cakton datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore. Sipas ankuesit, subjektit ‘Raiffeisen Bank’ sh.a, të dhënat e palëve dhe objektit të gjykimit janë hedhur gabim në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe kjo ka passjellë që ata të mos vijnë në dijëni të datës dhe orës së gjykimit. Siç e shpjegova më lart, hedhja e të dhënave të çështjeve në regjistrin elektronik të menaxhimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit Vlorë kryhet nga një sekretare

gjqësore e ngarkuar me këtë detyrë, nën mbikëqyrjen e Kancelares së Gjykatës së Apelit dhe në këtë veprimtari gjyqtarët, si relatori ashtu edhe anëtarët e trupit gjykues nuk kanë akses në asnjë fazë të regjistrimit apo gjykimit të çështjes.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit se nuk ka ardhur në dijeni të gjykimit, pasi shpallja e datës dhe orës së gjykimit është kryer në një afat më të shkurtër se 15 ditë, siç parashikon neni 460 i Kodit të Procedurës Civile, nga verifikimet e kryera prej meje, ky pretendim rezulton i pabazuar. Nga akti RIV i dosjes gjyqësore (të cilin e depozitoj), ku gjenerohen automatikisht veprimet e kryera në lidhje me çështjen, nga regjistrimi i saj deri në dorëzimin e saj, të përfunduar, rezulton që veprimi i planifikimit për gjykim të çështjes është pasqyruar në sistem nga sekretaria gjyqësore në datën 15.11.2019, për datën 3.12.2019, pra nga data e publikimit në sistemin elektronik të datës dhe orës së seancës gjyqësore deri në datën e caktuar është një afat më i gjatë se 15 ditë.

Gjithsesi vlen të theksohet që publikimi i datës dhe orës së zhvillimit të seancës gjyqësore në sistemin elektronik të administrimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit Vlorë nuk është detyrë e anëtarit të trupit gjykues, i cili nuk ka akses dhe nuk ka vendimmarrje në këtë fazë të përgatitjes për gjykim të çështjes. Po kështu, nuk është detyrim i anëtarit të trupit gjykues, procedura që ndiqet gjatë gjykimit dhe planifikimi i seancave gjyqësore, pasi kjo i përket relatorit për marrjen e masave për njoftimin e palëve dhe vijueshmërinë e gjykimit në orarin e caktuar.

Për sa i përket datave të seancave të tjera gjyqësore, nga akti RIV i dosjes gjyqësore, në të cilin gjenerohen automatikisht veprimet e kryera në lidhje me çështjen, nga regjistrimi i saj deri në dorëzimin e saj, të përfunduar, rezulton e kundërta e pretendimit të subjektit 'Raiffeisen Bank' sh.a. Çdo seancë gjyqësore është publikuar elektronikisht sipas vendimit të trupit gjykues dhe ka qenë e mundur marrja dijeni për gjykimin.

*Denoncuesi, subjekti 'Raiffeisen Bank' sh.a. ka ngritur pretendimin se në datën 18 dhjetor seanca është planifikuar në orën 8:45, ndërkohë që është zhvilluar në orën 11:38, në të njëjtën kohë me një çështje tjetër nr. *****, ku denoncuesi deklaroi se ka qenë prezent për shqyrtimin e një çështjeje tjetër me relator P. A. Denoncuesi është shprehur se ndodhemi në kushtet e një shkeljeje të rëndë të kryer nga trupi gjykues, pasi kemi elementet e mashtrimit në procesverbalin dhe pasqyrimin e seancës. Nuk ka asnjë mundësi të zhvillohen dy gjyqe njëkohësisht me pjesëmarrje nga i njëjti gjyqtar, P. A.*

Këto shprehje të denoncuesit subjekti 'Raiffeisen Bank' sh.a. përmbajnë rrethana të rreme, të thëna me dashje për të cenuar reputacionin e trupit gjykues, pasi siç pohon denoncuesi ka qenë i pranishëm në seancat gjyqësore të datës 18.12.2019, pra, është i qartë për veprimet procedurale të kryera në këtë datë në çështjet civile konkrete të cituara prej tij. Duke qenë se ka qenë i pranishëm, duhet të ketë konstatuar me qartësi se asnjë seancë gjyqësore nuk është zhvilluar nga gjyqtarët S. D. dhe P. A. në datën 18.12.2019, pasi në këtë datë kanë qenë në Gjykatën e Krimeve të Rënda Tiranë. Për këtë shkak gjykimet e planifikuara prej tyre janë shtyrë nga sekretaret gjyqësore përkatëse. Sa më sipër është pasqyruar në aktet procedurale të mbajtura në këtë datë. Pas marrjes së rezultateve të hetimit kam marrë informacion në lidhje me çështjet e cituara nga denoncuesi subjekti 'Raiffeisen Bank' sh.a., dhe ju vë në dispozicion aktet e cituara prej meje më lart.

Në lidhje me sa pretendon denoncuesi se është shkelur neni 451/a i Kodit të Procedurës Civile, sa i takon pikës së dytë të vendimmarrjes, për vlerën e pasurisë ‘linjë prodhimi e kartëpecetave’, vlerësoj se ky pretendim zgjidhet nëpërmjet rekursit, në rrugë gjyqësore. Pra, pretendimi i ngritur që lidhet me padi të gjykuar më parë apo me pretendime për proces të njëanshëm janë pretendime që shqyrtohen nga gjykatat më të larta”.

Komisioni, pasi shqyrtoi denoncimin dhe dëgjoi subjektin e rivlerësimit, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arriti në përfundimin se për ekonomi të procesit të rivlerësimit nuk është e nevojshme të hetohet më tej.

3. Denoncim nr. *** prot., datë 18.2.2019 dhe nr. *** prot., datë 22.2.2019 depozituar nga “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a.

3.1 “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a., ka pretenduar se nga një trup gjykues ku ka qenë anëtar edhe subjekti Hysen Saliko (jo kryesues) ka hasur pengesa dhe dëme monetare nga zvarritja e proceseve gjyqësore, si dhe nga vendimmarrja e paligjshme në tërësi. Konkretisht, denoncuesi i referohet çështjes civile me kërkues “L. K”, me objekt “pavlefshmëri e titullit ekzekutiv të kontratës së kredisë bankare nr. *** rep., datë 31.5.2011, kundërshtimin e veprimeve përbarimore, si dhe pezullimin e veprimeve përbarimore”.

3.2 Ka rezultuar se për një kredi të marrë në BKT nga kredimarrësi “L. K”, ky debitor, nuk ka shlyer detyrimet e tij sipas kontratës me bankën. Pas kërkesave të bankës për ekzekutim vullnetar të detyrimit, banka ka filluar procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm. Kontrata e kredisë bankare përbën titull ekzekutiv referuar nenit 510/d të Kodit të Procedurës Civile dhe në bazë të kësaj dispozite Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 3.7.2012, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për kontratën e kredisë bankare, dërguar për ekzekutim pranë zyrave të përbarimit. Është bërë ekzekutimi i detyrimit ku, në përfundim, banka ka marrë në pronësi pasuritë e paluajtshme të hipotekuar në interes të saj. Banka ka pretenduar se detyrimi i debitorit ishte më i madh se vlera e pasurisë së ekzekutuar prej saj. Për këtë shkak ka kërkuar pranë përbarimit ekzekutimin për pjesën e mbetur të detyrimit në shumën prej 71.097 euro. I padituri shoqëria ”L. K.” ka kërkuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv për diferencën e mbetur të detyrimit. Çështja ka shkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila me vendimin nr.***, datë 27.2.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadsisë së shoqërisë “L. K”.

3.3 Kundër vendimit nr. ***, datë 27.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, për ndryshimin e vendimit. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin e datës 6.12.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 27.2.2018 dhe pranimin e pjesshëm të padisë.

3.4 Denoncuesi, përveçse ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është në shkelje flagrante dhe abuzive të ligjit, denoncon se nuk i është vënë në dispozicion vendimi i zbardhur nga gjykata edhe pas 2 muajsh nga data e shpalljes së tij.

3.5 Nga aktet ka rezultuar se megjithëse vendimi është shpallur në datën 6.12.2018, ky vendim është dorëzuar në sekretari bashkë me dosjen përkatëse në datën 25.2.2019. Zbardhja e vendimit me kaq vonesë është në kundërshtim me nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“Gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsytuar në*

sekretari jo më vonë se njëzet ditë ose të shtyjë shpalljen e arsytuar të vendimit, deri në njëzet ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai del kundër”.

3.6 Referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të shpjeguar të kundërtën e provave të paraqitura nga denoncuesi se vendimi i gjykatës është në shkelje flagrante dhe abuzive të ligjit, si dhe vonesë në zbardhjen e vendimit.

3.7 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigjet të rezultateve të hetimit kryesisht, deklaroi se: *“Në lidhje me këtë denoncim, siç është konstatuar në këtë gjykim kam qenë anëtar i trupit gjykues. Në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile të cituar prej jush, parashikohet që arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës gjyqësore dhe jo nga anëtari i trupit gjykues, pozicion në të cilin kam qenë. Në këto kushte anëtari i trupit gjykues (sikundër në rastin konkret është subjekti) edhe nëse do të pranohet se dosja është zbardhur me vonesë, nuk mban asnjë përgjegjësi për zvarritje në zbardhjen e vendimit. Gjithashtu vlen të theksohet se përfundimi i çështjes ka përkuar me mbylljen e vitit, gjatë të cilit sekretaria gjyqësore kryen procedurën e mbartjes dhe reregjistrimit të dosjeve, si dhe ka një ndryshim të sekretareve gjyqësore, veprime që passjellin vonesa në dorëzimin e dosjeve në kryesekretari. Nuk është e qartë kur është dorëzuar dosja sekretares gjyqësore nga gjyqtarja relatores, pasi brenda afatit nga data 6.12.2018 kur është shpallur vendimi, deri në datën 25.2.2019 është përfshirë afati i dorëzimit të dosjes së arsytuar nga gjyqtari tek sekretarja gjyqësore, si dhe afati i administrimit dhe dorëzimit të dosjes nga sekretarja gjyqësore në kryesekretarinë e Gjykatës së Apelit, për pasojë nuk është përcaktuar saktë sa ka qenë vonesa në dorëzimin e vendimit të arsytuar”.*

Komisioni, pasi shqyrtoi denoncimin dhe dëgjoji subjektin e rivlerësimit, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arriti në përfundimin se për ekonomi të procesit të rivlerësimit nuk është e nevojshme të hetohet më tej.

4. Denoncim nr. ** prot., datë 31.10.2018, depozituar nga shtetasja R. I**

4.1 Denoncuesja ka depozituar denoncim për 6 subjekte rivlerësimi, prokurorë dhe gjyqtarë, duke pretenduar gjykim jo të drejtë të çështjes, manipulim dhe tjetërsim të provave të çështjes penale.

4.2 Nga denoncimi rezulton se shtetasja R. I ka qenë e përfshirë në një proces gjyqësor me ish-bashkëshortin e saj dhe familjen e tij, për ndarje pasurie. Gjykimi zhvillohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

4.3 Denoncuesja pretendon se i është drejtuar emisionit investigativ “Stop” në Tv Klan, i cili transmetoi rastin e ish-kreut të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, z. G. B, që kërkonte favore seksuale ndaj shtetasës, për ta favorizuar në një çështje gjyqësore që kishte në këtë gjykatë. Regjistrimi i transmetuar përmbante të dhëna të gjyqtarit në regjistrim audio, tashmë fakt i njohur botërisht. Një ditë pas transmetimit të këtij skandali, Këshilli i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një mbledhje urgjente dhe pezulloi nga detyra gjyqtarin G. B, duke ngritur edhe grup inspektimi për rastin.

4.4 Denoncuesja argumenton se kjo çështje gjyqësore kaloi fillimisht për hetim në Gjykatën e Krimeve të Rënda, por kjo e fundit shpalli moskompetencë dhe ia kaloi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për të mos pasur konflikt interesi me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

4.5 Kështu, prokurorja e Fierit E. H., e cila kryente hetimet, e pushoi çështjen në mënyrë flagrante duke bërë që ish-kreu i Gjykatës së Rrethit Gjyrokastër, G. B, të dalë i pafajshëm.

4.6 Nga ana tjetër, prokurorja e Fierit, E. H., pushoi çështjen në mënyrë flagrante, por gjyqtarja O. M. e prishi këtë vendim, duke kërkuar rikryerjen e një hetimi të thelluar.

4.7 Denoncuesja argumenton se nuk është thirrur asnjëherë në seancë gjyqësore për t'u dëgjuar pretendimet e saj. Prokurorët, sipas gjykimit të tyre, nuk e kanë vlerësuar si të arsyeshme dhe të nevojshme për hetimet e çështjes. Denoncuesja ka kundërshtuar vendimin që prokurorja mori për pushimin e kësaj çështjeje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Kjo çështje i ka rënë disa gjyqtarëve si çështje për të gjykuar, për të cilët denoncuesja ka kërkuar përjashtimin e tyre. Denoncuesja pretendon se bashkëpunonin haptazi dhe mbanin qëndrim të njëanshëm me palën tjetër.

4.8 Çështja u gjykua nga gjyqtarja M. Sh., e cila vendosi pushimin e gjykimit të çështjes penale, duke u marrë si justifikim një rast në një seancë që denoncuesja nuk u paraqit, pasi kishte depozituar në sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier një fletëthirrje, ku vërtetohej se në po të njëjtën ditë ishte në një gjykim tjetër në Gjirokastër. Pas këtij vendimi të gjyqtares M. Sh., denoncuesja i është drejtuar Gjykatës së Apelit Vlorë për kundërshtim të këtij vendimi. Gjykata e Apelit Vlorë, me kryesuese znj. I. B., vendosi prishjen e vendimit nr. ***, datë 26.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe kthimin e akteve për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë.

4.9 Gjyqtarja e re e çështjes vendosi “pranimin e kërkesës, prishjen e vendimit të datës 25.5.2017, të prokurores E. H, duke i urdhëruar vazhdimin e hetimeve të mëtejshme në lidhje me detyrat e caktuara. Veprimet hetimore të përfundojnë brenda afatit 60 ditor”. Pas rikthimit të çështjes për vazhdimin e hetimeve, prokurorja e çështjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, apeloj vendimin e gjyqtares.

4.10 Gjykata e Apelit Vlorë, ku subjekti Hysen Saliko është anëtar trupi (jo kryesues), ka vendosur të ndryshojë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke lënë përfundimisht në fuqi pushimin e procedimit penal për gjyqtarin G. B.

4.11 Sipas pretendimeve të denoncueses, nuk është bërë ekspertimi teknik i zërit të audios dhe nuk është thirrur asnjëherë që të dëshmojë, nuk u bë ekspertiza e shkrimit që ishte apo jo e z. G. B dhe asnjë veprim tjetër hetimor.

4.12 Referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të shpjeguar të kundërtën e provave të paraqitura nga denoncuesja se nuk është bërë ekspertimi teknik i zërit të audios, që nuk është thirrur asnjëherë për të dëshmuar dhesë nuk u bë ekspertiza e shkrimit që ishte apo jo e z. G. B dhe asnjë veprim tjetër hetimor.

4.13 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, në përgjigjet të rezultateve të hetimit kryesisht, deklaroi se: *“Në lidhje me denoncimin e znj. R. I, pas ardhjes në dijeni të rezultateve të hetimit kam verifikuar shkaqet e parashtruara në denoncimin e mësipërm dhe në vlerësimin tim gjejnë përgjigje në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Apelit. Gjatë shqyrtimit të ankimit të ankueses R.*

I, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se ripyetja e ankueses në lidhje me faktet e pretenduara prej saj, nuk ishte e nevojshme. Ndryshe nga sa ka pretenduar ankuesja ajo është pyetur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë, gjithashtu nga përmbajtja e kërkesës ankimore të paraqitur prej saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor nuk rezultojnë rrethana të ndryshme apo të reja. Pretendimi i denoncueses se zotëronte prova shkresore, të shkruara nga personi nën hetim nuk është vlerësuar si shkak për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal, pasi këto akte nuk janë paraqitur në organin procedues apo në gjykatë, si dhe nuk janë cituar apo dorëzuar në Gjykatën e Apelit, me qëllim që jo vetëm të vërtetohet ekzistenca e tyre, por dhe gjykata të vlerësonte lidhjen e tyre me çështjen konkrete.

Në lidhje me ekspertizën e zërit, një aktekspertim i tillë është kryer gjatë hetimit paraprak, por denoncuesja nuk ka qenë dakord me konkluzionin e aktekspertimit. Nga verifikimet e kryera nga prokuroria, nuk ka qenë e mundur për ekspertët kryerja e verifikimeve të tjera teknike në lidhje me regjistrimet e zërit të ofruara nga denoncuesja.

Në vendimin e pushimit të procedimit penal, nga prokuroria është pranuar fakti në të njëjtat rrethana siç është përshkruar nga ankuesja R. I, ndaj nga Gjykata e Apelit është gjetur i drejtë arsyetimi i prokurorisë se nuk ka qenë e nevojshme kryerja e hetimeve të tjera.

Pretendimet e denoncueses znj. R. I kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm nga Gjykata e Apelit dhe vlerësoj se pretendimet e saj përbëjnë objekt shqyrtimi gjyqësor nëpërmjet rekursit në Gjykatën e Lartë”.

Komisioni, pasi shqyrtoi denoncimin dhe dëgjoi subjektin e rivlerësimit, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arriti në përfundimin se për ekonomi të procesit të rivlerësimit nuk është e nevojshme të hetohet më tej.

5. Për denoncimet e tjera, të depozituara në Komision nga publiku, si vijon: (1) denoncim me nr. *** prot., datë 11.3.2019, depozituar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh. a., (OSHEE); (2) denoncim nr. *** prot., datë 4.5.2028, nga znj. L. A; (3) denoncim me nr. *** prot., datë 27.4.2018, depozituar nga z. E. Xh; (4) denoncim nr. *** prot., datë 6.3.2018, depozituar nga znj. D. K; (5) denoncim nr. *** prot., datë 27.6.2018, depozituar nga z. F. A; (6) denoncim nr. *** prot., datë 14.11.2018, depozituar nga z. G.T; (7) denoncim nr. *** prot., datë 12.6.2018, depozituar nga z. H. S; (8) denoncim nr. *** prot., datë 18.5.2018, depozituar nga z. L.B; (9) denoncim nr. ** prot., datë 16.1.2018, depozituar nga z. S. C; (10) denoncim nr. *** prot., datë 20.12.2017, depozituar nga z. V.M; (11) denoncim nr. *** prot., datë 1.10. 2019, depozituar nga z. K. M.

5.1 Komisioni i mori në shqyrtim këto 11 denoncimet e sipërtrajtuara dhe konstaton se nuk ka *indicie* dhe prova që të provohen faktet e pretenduara. Në denoncimet e paraqitura pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalía e fundit, faqja 60 nga 64, e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016.

Gjithashtu, Komisioni pasi hetoi lidhur me këto denoncime dhe pasi shqyrtoi në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në

Republikën e Shqipërisë”, arriti në përfundimin se 11 denoncimet nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Hysen Saliko, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 3.8.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore/Kundër

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha